LEK PERVIZI

ANTOLOGJI NE VARGJE

Mbresa poetike

nga nje jete e ndaluar

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

DORIAN


Lek Pervizi

ANTOLOGJI NE VARGJE

Mbresa poetike
nga një jetë e ndaluar

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

DORLAN
2



Portret i Autorit nga i biri Leonard, Pluk 1986

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

HYRJE

E shoh t'arsyeshme të shkruej dy fjalë për këtë vëllim kushtue krijiltarisë sime vjershtore me titull *Antologji në Vargje*. Në të përfshihën të gjithë poezitë që kam mundë me krijue gjatë jetës sime, të paraqituna në formë kronologjike sa kam pasë mundësi të përcaktoj. Ky përcaktim asht kryesish me periudha vitësh dhe jo me data specifike, siç veprojnë disa, për të përcaktue data faktike të qena apo të paqena si provë kohore. Krijimtaria kryesore imja në poezi asht ajo e burgjëve e kampëve të internimit. Duke qenë se mbajtja e si rrjedhim gjetja e shkrimëve të tilla përbante rrezik deri dhe jete, ato u shkruen dhe u mësuen përmendësh. Letrat u dogjën. Mbas 1990 me daljën në Belgjikë e fitimin e lirisë me të gjithë të drejta e saj, pata mundësinë t'i shkruej, në mos të gjitha, pjesën ma të mirë të tyne, që kam botue në tri gjuhë që zotëroja, shqip, italisht e frëngjisht. Ndërkohë krijimtaria ka vazhdue ma e lirshme dhe në stile të ndryshme, klasike ,vargje të lira dhe vjersha rapsodike ose kangë popullore, këto, një pjesë nga gjëndja e dënimëve ku janë marrë e trajtue edhe nga poetë popullorë të kohës. , të mbetun nanonimë. Pra kemi dy faza, atë të periudhës së diktaturës, 1944-1990, dhe atë pas 1990 deri më sot 2018, që pregatitet ky libër. Qëllimi i botimit asht vetëm si një dëshirë vetjake pa pretendime, për të shprehun atë duf ose prirje letrare qe na ishte ndalue e mohue me dënime pafund e krye. Përveç poezive kam pasë mundësi të botoj libra të tjerë që përbajnë arkivin e familjës. Ndërkohë gjithë botilmet e mia janë depozitue pranë Bibliotekës

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

Mbrtrore te Belgjikës, qoftë shqip apo në gjuhë të hueja. Puna kryesore imja në Belgjikë asht botimi i revistës me titull "Kuq e Zi", që nga tetori 1993 pandërtprerje, bëhën 25 vjet më 2018, me shpresë që të arrijmë këtë përvjetor po të na ruej Zoti shëndetin e mendjen.

Në këtë Antologji përfshihën këto vëllime me poezi

--Ankimi i Zanave
-- Fragmente poetike
–Petale Trëndafili
-- V allja e Yjëve
-- Tingëllime të Vona -

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

LEK PERVIZI



Aukimi i Zanave

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Vëllimi i parë

Ankimi i Zanave

Poezi të burgjëve e kampëve
1950-1990

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Vlerësime

I kam lexue me emocion poezitë e juaja. I admiroj dhe mendoj, me respekt të madh, se zto kanë cilësinë e poezive të Aragonit, të kohës së luftës.

Lord Amer

…. « tani nga Shqipëria aarrin një za që tregon « nga brenda » këtë periudhë tragjike : asht zani i një njeriu që ishte mbyllun dyzet vjet ne kampet e përqendrimit.

Antonella Brian

Poezite e Lek Pervizit hyjne ne radhen e veprave epokale te karakterit epiko-tragjik, ne kuptimin se ne ato poezi reflektohet gjithe drama e nje populli i detyruar te rrije nen zgjedhen e rande te nje nga diktaturat me t'egra t'Evropes komuniste. Ne qofte se Dante Alighieri shkrojti per një Ferr fantastik, Lek Pervizi, na jep vjershat e nje Ferri real tokesor qe perjetoi populli shqiptar gjate nje gjysme shekulli.

Anonim… "Are".

Para memorjes sime, para syve të mi të mjegulluar nga pikëzat e lotit, edhe dramat e Shekspirit zvetëniten, kur lexoj dëshmitë rrënqethëse, me vargje drithërurese nga poeti 80-vjeçar, që hedh mbi letrën e bardhë, tmerret që pa me sytë e tij! Në këtë libër, çuditërisht pothuajse në çdo poezi më endej përreth hapësires së kompjuterit "Ferri" i Dante Aligherit, e me vete bashkëbisedoja në heshtje me mikun tim Pervizin, duke e pyetur: E çka më shumë Ferri i Dantes?

K.Z

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Të gjithë atyre
që humbën jetën
në kushtet e terrorit
të diktaturës komuniste,
heroj, dëshmorë
e martirë të lirisë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Paraqitje

Një kangë e ndritun del nga errësina, Tingujt e shpresës luhatën mbi tmerrin.

Një britmë mes natës. Duhet me e shty, dhe era ta përhapë në hapësinën e botës, deri sa ajo të takojë një britmë tjetër që ta presë, apo një vesh që ta dëgjojë, një vesh të madh sa një zemër.

Atëherë britma gjen vendin e vet, ajo qetësohet dhe kthehet në një shushurimë, fllad i lehtë që mund të pllenohet përsëri. Fjalë të tilla janë si farna të kuqe të depozitueme në një tokë pjellore ku do të mbijnë gëmushe të zjarrta mbi shkretëtirë.

Kjo ashtë e gjithë kërkesa e Lek Pervizit e paraqitun këtu I Burgosun, ,ai u shkëput nga dhuna dhe ligësia e njerëzve.

Së pari u lirue nga britma, pastaj nga dashunia ndaj vendit tij, i ambël, ma i bukuri, se fundi duke gjetë paqën në nje vend mikpritës.

Ashte e vërtetë se gjëndësh i vetmuem në vuajtje, por Perëndia asht aty, dhe Virgjëra Marie, nëna e të gjithëve.

Toka asht e madhe, e banueme edhe nga njerëz të mire që të duen. Me u lexue, asht veç fillimi i shërimit. Diku fjala nis me jetue, ndoshta edhe duke lëvizë në zemrën ose në buzët e dikujt.

Kjo asht ajo që ne ia urojmë poezive të kësaj përmbledhje, ashtu siç asht e vërtetë që një poezi asht si një lutje, një kërkesë, të cilën mjafton ta dëgjosh dhe ta afrojsh që jeta të marrë flakë.

Paule De Smet, poete belge

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Dy fjalë nga autori

Ma në fund, të gjitha vjershat e kohës së dënimeve, që munda me shpëtue e me redaktue, arrita t'i bashkoj në një përmbledhje të vetme, të paraqitun në vellimin "Ankimi i Zanave", që mbetet dhe botimi i parë i jetës sime, në moshën shtatëdhjetëtrevjeçare, kur dihet se 45 vjetët e tjera i kalova nën përsekutimet, burgjet e kampet e konumizmit, i ndaluem për çdo shprehje të lirë fjale e memdimi, pa asnjë mundësi krijimtarie. Në kushtet e asaj jete shkëterrore ku na kishin pllakosë, poezia ishte ajo që bluhej e hartohej në mendjen si një duf e frymëzim i vetvetishëm, për të shprehun ma mirë përshtypjet e çastëve rënqethëse që po përjetonim. Ky fenomen ndodhte jo vetëm për mue, por edhe për të tjerë bashkëvuejtës, poetë të mirëfilltë apo rapsodë popullorë, që pësonin terrorin e diktaturës. Siç dihet. poezia asht shoqnuesja besnike e shqiptarit e frymëzuesja e vazhdueshme e tij. Vonesa e një botimi të plotë lidhet me vështirësitë e rindertimit me anë të kujtesës të të gjithë atyne vargjeve që ishin grumbullue në mendje gjatë gjithë kohës 45 vjeçare të qëndrimit në kushtet e burgjëve dhe kampëve, ku denimet përsëritëshin me kronologji ritmike, sipas planëve pesëvjeçare të shpalluna me bujë të madhe e që dubeshin realizue patjetër. Një ndër ato realizime ishte dhe "lufta e kjlasave", që zbatohej rreptësisht mbi kurrizin tonë me masa të vazhdueshme denimesh. Nga ana tjetër ishte e domosdoshme me tregue se si zhvillimi një kulture në kushtet e regjimit totalitar, nuk mund të përfytyrohej i lirë dhe aq ma pak realist, kur në njenën anë flitej e shkruhej për kopshte me lule e nga ana tjetër mbretnonte skëterra ma e zezë dhe terrori bante kërdinë në radhët e intelektualëve të patriotëve të familjeve të mëdha e të shtresave të tjera të popullit. Ndërkohë disa të

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

ashtuquejtun, shkrimtarë, të dalluem për një servilizëifl të neveritshëm, shpalosnin flamurin e "realizmit socialist", që ishte, asht e do të mbetet një njollë e turpshme në historinë e kulturës shqiptare. Mjerisht ka akoma të tillë që duke pasë qenë të lidhun pas qerres së diktaturës si bashkëpunëtorë të zellshëm të saj, rrahin gjoksin si disidentë e të përsekutuem, duke harrue se i përkisnin klanit të varrmihësve të kombit shqiptar. Këto vargje pra, paraqesin lakuriq të vërtetën e trishtë që dikush mundohej të mbulonte me shoshë. E shosha s'ka si me mbulue diellin e aq më pak të vërtetën. Një krijimtari e mirëfilltë duhet të jetë përçuese e gjithë çka ndodh e zhvillohet para syve të saj. Mund të quhet se ajo e ka përmbushë detyrën, vetëm atëherë kur arrin të dëshmojë për rrethanat e gjendjes së shtypjes shpirtnore, materiale e njerëzore që ushtrohet mbi popullin, veçanërisht kur ajo shtypje kryhet prej një diktature të urryeme. Shqiptarët provuen e duruen për një kohë të gjatë gjysmë shekullore një terror të paparë që nuk mund të mbetej pa u pasqyrue në veprat e shkrimtarëve të kohës. Por ata që ishin lejue e zyrtarizue në shërbim të diktaturës nuk mund ta kryenin atë detyrë, sepse ishin bashkëfajtorë në krimet dhe terrorin që ushtrohej. Oportunizmi e konformizmi tyne i kalonte kufijt e arësyes, sepse ata nuk mund të pretendojnë të mos kenë dijtë se ç'ndodhte përreth. Por nuk deshën. Kështu duke mohue vuejtjet e popullit tyne e gjakun e mija viktimave të pafajshme, ata mohonin vetveten. Vetëm kush e pësoi dhunën e persekutimin mbi kurriz e tij, me dënime, vrasje, burgje e internime, ishte në gjendje të përshkruente të vërtetën e hidhun që po përjetonte vendi. Shkrimtarëve të persekutuem u mbetet si detyrë të paraqesin në veprat e tyne dëshmitë e mbresat e asaj kohe të trishtë e të zymtë. Asaj detyre i përkasin edhe këto poezi që arrita t'i shpëtoj duke i ruejtun të ngulituna në kujtesë e që tani i kam radhitë me shkrim që të mbetën si një dokument i pashlyeshëm, si për bashkëkohësit ashtu edhe për pasardhësit. Njëkohësisht për të krijue urrejtjen e dënimin ndaj

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

çdo lloj diktature që kërkon me anë të dhunës e të krimit, t'i imponohet shoqnisë njerëzore e të mohojë e te shkelë të drejtat e njeriut , kudo që ato arrijnë të marrin pushtetin në dorë. Kaq për të përcatue se në ç'farë kushtësh u krijuen këto vjersha Si paraqitem sa i përket poezive të këtij vëllimi, duhët të shtojmë, se krahas kësaj krimtarie katakombash, e në ato kushte të mjerueshme, s'mund të rrija duer kryq edhe si piktor. Kështu fuiksova ato skica të gjendjës së mjerueshme të atij kampi mizor e disa potrete të njerëve që aty vuaanin. Pra puna e piltorit ecte parale me atë të poetit. Me vejn keq se mjaft vizatime kanë humbun e janë damtue, e kanë mbetë vetëm ato që janë paraqitë e bat ë njoftun, nepërmjet shtypit, televisionit e konferenca e aktivitete të rastit. U detyrova të përmend vizatimet, sepse ato flasin direkt visualisht ngjarjr për të cilat shkuhën libra të tanë. Në rastin e antologjisë I kemi dhanë përparëss poezisë, si përçuese situatash dhe emocionësh nëpërjet fjalës së vargëzueme, poezisë.Uroj që lëxuesi të nxierrë përfundimet kuptimplote që përmbajnë në vetvete kto poezi, mbresa të gjalla e dëshmi të mirëfillta të një periudhe të kalueme shumë mizore, që mos u përsëristë ma kurrë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

I

I

Portopalermo

1949-1951

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Tinguj të kobshëm

Autoportret

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Tinguj të kobshëm

Pushuen kangët e gëzueshme të rinisë
tashma
shpejt filloi në zemrën time brenga
tinguj të kobshëm
të nxierrë
prej lahutes
tinguj të përvajshëm
prej lahutës së kohnave
tinguj hapash
që vijnë lart e poshtë
tinguj gjymtyrësh që zvarriten
gjymtyrësh rrënkuese
në të zymtat
qeli
tinguj britmash
vikamash
tinguj të ngjirrun
psherëtimash
grahmash
tinguj hekurash
llozash
prangash
tinguj kërcëllitës
trokitës
qizmësh e këpucësh
xhelatësh
policësh
rojësh
tinguj batarësh
në ato mëngjese pa ngjyrë
te një zall
te një breg

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

te një lumë
i cili vrapon i lëmëritun
me frikë
me tmerr
e fshehtas
tinëz
në valën e tij të vrullshme
gjak herojsh
gjak trimash
merr
skuq
shkumbën e bardhë.
Tinguj të përziem me gjak
tinguj të njomun me lot
me djersë
tinguj që kumbojnë
kobshëm
tinguj mortorë
tinguj të përvajshëm
nanash
nusësh
motrash
fëmijësh
prej thellësisë së shpirtitnave
të brengosun
prej thellësisë së zemrave
të lëndueme
tinguj të kobshëm
tinguj të vrazhdë
nxierr
tashma
lahuta e lashtë
lahuta e kohnave
pushuen kanget e gezueshme të rinisë!

Arrestimi, qeli në burgu n e Tiranës, maj 1950, trasferimi në Portopalermo.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Portopalermo

Tallaze të zeza
të një deti të stuhishëm
përplasën mbi shkrepat e thepisun
me një potere shurdhuese
shpërthime stërpikjesh
shkumbë të kuqërremtë

grihen t'errtë tallazët
mbi horizontin e përflakun
të një perëndimi të pistë
me re të kobshme
hije ogurzeze
që shtyhen e përdridhen
me ndriçime vetëtimash
gjëmime bubullimash
shkrepje rrufeshë
apokaliptike bie mbramja
mbi këtë siujdhesë të shkretë
tokë të mallkueme

i kobshëëm burgu
i kobshëm regjimi
i kobshem kush e ndërtoi
kala e mallkueme
humnere e sketerrë
vorr e qivur
qënjesh njerëzore të pafajshme
kositë në lulëzimin e tyne

Portopalermo
shkamb i lashtë
shkretinë e vjetër

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

dhe shkretinë moderne
burg mizor
i një kohë mizore

gjak duket se kullon prej reve të zeza
përzie me lot dhimbjësh
me djersë mundimësh
përskuqet deti nen ndriçimin e zjarrtë
të një dielli të lodhun
që kërkon të çajë mes reve
siç kërkoj unë mes kujtimëve

apokalips
mbi tallazët e përgjakun
t'egërsuem
apokalips
në shpirtin tim të brëngosun
të dërmuem !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Shpellë e Polifemit

Ciklopin Polifem prisnim
që të zgjaste duert përbindëshe
e të na gllaberonte të gjallë
tallazët e detit Jon
na shoqnonin me vajtime ngashruese
qanin hallin tone vallë ?
ne
të pllakosun në zgavrat shkambore
ku sundonte errësina
e sundonte mjerimi
gjith ankth
gjith frikë
rrinim bri njeni tjetrit
të heshtun
flisnim apo recitonim
fjalë e vargje
me vetvehtën
të heshtun
prisnim të panjohunen mizore
të heshtun
prisnim monstrin me nje sy ne balle
të heshtun
të pafuqishëm
Uliksi nuk ishte midis nesh
kush vall do të na nxirrte
nga ato shpella mizore ?

ulurima e erës jëhonte nëpër gurrat
me motive mortore
dhe dallget shkumbuese gjëmonin
plot britma lemërimëse
hija e zezë e ciklopit përbindësh
sillej aty vërdallë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

e kobshme
pritje e frikshme
thërmohej tallazi
mbi shkrepat shekullorë.

Stërpikje të përskuqme
shkumbë të përflakshme
hidhëshin drejt qiellit
n'ato perëndime vjeshtore
kur qielli merrtte flakë
prej saçit viganor të diellit të zjarrtë
si një sy i kuq ciklopik
gjak.

Të strukun në terrin e guvave
prisnim
(Ciklopët vështronin t'uritun
prej shekujsh)
e llahtarshme pritja
i llahtarshëm ankthi
në ato shpella që nuk njihnin rreze drite
në flakëzen e shpirtit
dallonim njeni tjetrin
miset
kockat tona
s'kishin ma përbamje
t'ishe a të mos ishe
njëlloj!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Edhe n'andrrat s'ka qëtësi

N'andrrat kërkoj prehje përherë
prej realitetit mizor të ditës
që vetëm 22one22 trishtimi
prapëhtinash
fyemjësh
brengash
jep

i shtrime mbi shtresën time të mjerë
pres me dëshirë
që mbi qepallat e lodhuna
gjumi
lehtësisht të me prekë
me njet të 22one
me pushue.

lumej vërshues e përmbytës
ujna të trubullta
ura të shëmbuna
gremina
humnera
gjarpij
ujq gllabërues
qen të tërbuem
luftime
arratisje
mundime çnjerëzore
për me shpëtue

nofulla të 22one
egërsinash e kulshedrash

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

bolla të coptueme
lundrim n'për detna tallazore
stuhi të përballueme
lumej të kapërcyem
ikje me fore
një luftë e parreshtun
pa kufi
edhe në gjumë
edhe n'andrrat
nuk po gjej prehje as qetësi !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Shpirti po shuhët

Kurrë ma
kurrë
s'do të kthehet
koha e bukur e rinisë
fkaka e zjarrtë shkëlqimtare
që rrezatim jetësor shpërndante
e ngohtësi trupit
e fuqizim shpirtit
mendjës jepte
u fik
u shue
fare

një stuhi e furishme
shi
akull
borë
një tufan i kobshëm
solli errësinën midis nesh
përlau
pishtarët e ditunisë
meku
dritën jetësore
zhduku
idealët njerëzore
mbetëm
haru
në mëshirën e dhunës barbare
të një ideologjie përverse
e mishërueme
në terrorin
mizor
të tiranisë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Burg mizor, i një kohë mizore

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Portopalermo

Një grumbull gurësh që formojnë një kala të ndërtueme mbi një grumbull shkrepash të thepisun. Një siujdhesë që shtrihet midis gjinit të vogël të detit Jon. Strehim e skele piratësh që në kohnat lashta. Ali Pashë Tepelena e përdori si fortifikatë për të mbrojtun vilajetin e vet. Një vend i shkretë. Palermo do të thotë "shkretinë e vjetër". Për rreth kodra e male shkambore. Shkurre, ferra e bezga, si dhe nëpërka helmatisëse. Ky ishte Portopalermo. Po të vinte njeriu dorën e mbarë mbi të, mund të kthehej në një vend turistik mjaft tërheqës. Por njeriu vuni dorë të mbrapshtë dhe e ktheu në një burg mizor. Mbrenda në atë kala, ku nuk pranonte të hynte as bagëtia, sepse errësina ishte e tillë sa ngjante si një skëterrë, diktatura komuniste pllakosi familje të tana: gra, fëmijë, pleq e plaka, të rinj e të reja deri dhe foshnje djepi, si pengje e hakmarje ndaj kundërshtarëve 26one26t26 të arratisun, të konsideruem anmiq të përbetuem të regjimit komunist. Mbasi i hoqën prej aty 26one26 e fëmijët, duke i degdisun në kampin tjetër famëkeq të Tepelenës, e mbushën kalanë me burra nga katër anët e Shqipnisë, të dyshuem për rrezikshmëni. Aty u burgosën dhe djemt e të arratisunve ma të randësishëm. Mbrenda dy muejve, gjysma e të dënuemve prej dobësisë dhe konditave kafshore, humbën shikimin. Sa afrohej mbramja ata që ishin të 26one26 duhet t'i shoqëronin për dore pse nuk shihnin. Buka prej thekne ishte krejt e qulltë. Supa, një spirilang si ujë i turbullt, ku fasule apo makaronat notonin si peshq vetmitarë, ndahej me nga një lugicë në ditë për njeri. Ky ishte ushqimi i përditshëm. Dikush që merrte ndonjë ndihmë nga familja, kishte mundësi të blente diçka nga fshatarët. Shumica minin barkun me dorë e vareshin vetëm nga spirilangu i neveritshëm dhe i pamjaftueshëm. Filluen sëmuren. Disa i zuri dizanteria dhe

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

u semunë randë sa që i ruenim ditë e natë. Ndër ta, Musa Sina, një dibran i ri 16 vjeçar i internuem që në moshën 10 vjeçe, bashkë me familjen. Musa arriti në atë 27one27, që quhet e fundit. Mjek nuk kishte, as ilaçe, fare. Gjendja e tij u keqësue tepër. Komandanti i kampit, njëfar rreshter Qaniu, kur erdhi të bajë apelin e darkës dhe u gjet para Musës të reduktuem në një grusht kockash e pa ndjenja, nuk e përmbajti dot urrejtjen kriminale e duke u tregue i ulët e mizor tej mase u çjerr: "Ç'prisni, kapeni këtë kërmë të ndyrë e hidheni në det!" Të burgosunit e tjerë mbetën shtang. Ç'përbindësh! Por Zoti kishte mendue ndryshe. Musa mbijetoi e ishte një mrekulli. Kaloi 45 vjet në burgje e në kampe. Pësoi tortura të tmerrshme e nuk u dorëzue kurrë as nuk nxori një emër e një fjalë. Ai vdiq pas dy vjetëve që përjetoi shembjen e komunizmit, duke 27one një kujtim të 27one, për të gjithë ata që e njohën. Përsonalisht e kam pasun shok e mik të ngushtë e tepër besnik! Njeri i sakrificës, bahej 27one për të tjerët. Kurse rreshter Qaniu mbeti i përbuzun përgjithmonë si njeri xhelat e katil. Mori vulën e pashlyeshme të turpit. Kishte kujt t'i ngjante!


BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

II

Kampi Tepelenës

1948-1958

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Kështu ishin të stivosur të internuarit në kazermat e kampit të Tepelenës, ku përveç vizatimëve Lek Pervizi kishte krijuar edhe poezitë e librit "Ankimi i Zanave" paraqitur në këtë Antologji.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Tepelenë kala e mallkueme

Tepelenë
Tepelenë
sa krime të llahtarshme
nën muret e tua
kala e mallkueme !

e kobshme
me ato gurë të gdhendun
me gjak e djersë e mundime
skllevësh
me ato mure t'errtë
të mynxyrtë
siç e mynxyrtë asht historia jote

lindun prej gurëve
ndertue me gurë
sundon mbi gurët
sundon mbi terrorin
që këtu ka strofkën e vet 30one30t30
kala e mallkueme !

pse
këta krijesatë të pafajshme
të pambrojtje
të mjerë
nën hijen tande shtypëse?

Shiko sa varre të gërmueme
shiko sa kryqe të drunta
shiko sa rrasa të gurta
shiko sa nana të deshpërueme
shiko sa baballarë të trishtun

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

sa ankth
sa tmerr
kala e mallkueme !

e keqja lind prej së keqës
terrori prej terrorit
tirania prej tiranise
ti
kala e mallkueme
prej një shpirti të mallkuem!

e furishme era
pa pushim
me vrullin e saj të parreshtun
gerryen e bren
muret e tua mizore
dhe mizor
t'urryem
emnin e 31one31t tand
31one31t31
mbi botë
kala e mallkueme!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Vdekja sillet midis nesh

Kujtime kohnash të trishta
në mendjën e sfilitun
në trupin e dërmuem
në shpirtin e brengosun

hija e shemtueme e vdekjës
e zgërdheshun
e frikshme
sillet midis nesh

ne fytyrat e zbehta
në sytë e çakërrisun
në faqet e fishkuna
në trupat e rraskapitun
kërkon viktimën e ditës
kërkon kurbanin e 32one
kërkon flijimin e çastit

kosa e përgjakun
e ndryshkun
kërcënuese
shtrihet ogurzeze
mbi fatkeqët e pafajshëm
korr
korr
korr
turra foshnjësh korr
sa dhimbje e dëshpërim nanash
turra pleqsh korr
sa dhimbje e vajtim fëmijësh
turra burrash korr
sa dhimbje e brengë nusesh

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

mizore sillet midis nesh
kasape besnike
e nje tirani t'egër gjakatar
shërbëtore
por një ditë me siguri
xhelate e tij !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Vorre

U gërmuen disa vorre
shume vorre
në të mallkuemënTepelenë
për foshnje të brishta
për ëngjëj
(a varrosën ëngjëjt ?)
që sapo kishin hapun sytë jetës
sy të kaltërt
sy të zi
sy të hirtë
sy laramanë
sy të jeshiltë
sy të mëdhej
te bukur
gjithë këto sy u mbyllën përgjithmonë
që të mos shifshin tmerret e kësaj toke.

Nanat mbeten qyqe vetëm
kërcuna
pa burra
pa fëmijë
fëmijët mbetën pa nana
pa etën
morën rrugët e pafundshme qiellore
u lanë mjerimin të tjerëve
me lotët e përthamë
me ninullat e harrueme
u groposën
në atë tokë t'ashpër
të ftohtë
të braktisur

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

vorret humbën
në zemrat e lëndueme të nanave
mbeti kujtimi i krrelave t'arta
i syve të kaltërt
buzëqeshja engjëllore
emnat e vogëlushve
në lartesitë qiellore
ndrisnin yje të rij!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Acar kërcënues

Acari i netëve të janarit
qëndron pezull
kërcënues
mizor

vagëtima fëmijësh
rrënkime pleqësh
36one36t mortore
çajnë muret e kazermave vigane
hidhen drejt qiellit
shigjeta të përflakme
mesazhe dëshpërimi e dhimbjeje
qielli qëndron i heshtun
në zbrazëtinë e pafundshme
i ftohtë
i largët
mes territ të natës endem
kërkoj që të flas me yjet
kërkoj që të flas me hanën
(a ndrit dielli mbi këtë tokë vallë?).
orvatem
të ndez pishtarin e shpresës
për të lëshue një fije ndriçim
mbi këtë tokë të mjerë
mbi këto njerëz të braktisun
të sfilitun
të harruem

yjet fundosën në humnerën siderale
hana tej maleve zhdukët
acari i netëve të janarit
qëndron pezull
kërcënues

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

mizor

vagëtima fëmijësh
rrënkime
graham
pleqsh
ankime e lutje nanash
të trishta
dëgjohen !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Skllavët

Një varg qënjesh njerëzore
ngjitet e zbret
nëpër shtigjet e ashpra malore
ngarkue si kafshë pune
burra e gra
djem e vajza të reja
bukuria e tyne
mbështjellë me zhele
të 'perkulun
nën peshën e barrës së randë të druve
nën peshën e randë të gurëve
nën peshën e randë të terrorit
fytyrat e tyne të dëformueme
prej lodhjës e prej tortures

bie shi
bie 38one
frynë era acar
djeg vapa përvëluese
karvani i skllavëve të shekullit njezet
shekull i turpshëm
hyp e zbret leqëve malore
nën tytat kërcënuese të armëve vrastare
të policëve
çerberë t'egërsuem

në çdo pike djersë një 38one lot
në çdo 38one loti një 38one gjak
me rraskapitjen shtohët dëshpërimi
me dëshpërimin shtohët lodhja
lodhet dhe mendimi

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

vorret qëndrojnë të heshtun
të vdekmit sodisin të heshtun
në qetësinë e thellë të tokës së zezë
ku kane gjetë prehje e qetësi t'amshueme.
Shpirtnat e tyne
na veshtrojnë ndoshta
nga lartesia e qiellit hyjnor
i shpëtuen përjetësisht mundimeve
mjer të gjallët
mjer këta skllavë të shekullit njëzet !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Heroj e martirë

Heroj
thue të dalun prej poemëve homerikë
krenarë
të 40one40
guximtarë
si krenaria e shqipëve të malëve
si fortësia e shkambit granitor
si guximi zulmëmadh i luajve
kreshnikë të ri lëgjendarë !

u këputen flatrat
u coptuen shkembejt
u robnuen luajt
në kafaze të hekurta
në guva shkambore

të tjerë emna herojsh
të tjerë emna dëshmorësh e martirësh
do të skalitën në mermerin e pavdekshëm
do të këndohën nga rapsodët e malëve:
prind herojsh
nana herojsh
vllazën e motra herojsh
gra e fëmijë herojsh
ata vetë heroj
ata vetë dëshmorë
ata vetë martirë
të flijuem
idhujve gjakatarë
sa të shumta kryqe
sa të shumta vorre
pleqsh

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

nanash
vllaznish e motrash
foshnjësh engjëllorë
sa e sa kryqe
sa e sa vorre
te bjerrun skurrëve e prroskave

sa kunora me gjemba
mbi ato koka të pafajshme
sa gozhdë te ndryshkuna
mbi ato duer bujare
sa fytyra të pergjakuna
sa shpata që thyejnë kocka
sa heshta që çajne gjokse.
me mija të kryqëzuem
Krishta
mbi Golgotën e shekullit 41one
të këtij Kalvari të shekullit njëzet
që komunizmi ngriti mbi botë
për turpin e vet
mbi aq popuj të gjorë
mbi aq kombe të dëshpëruem
për bijt e bijat e tyne
që u 41one thëror
masakrue
prej xhelatëve të pashpirt
barbarë
qofshin mallkue !

sa martirë vogëlushë
sa dëshmore të shejtë
fëmijë
fëmijë
fëmijë
të grabitun prej gjinit të nanave
të bardha petale zambaku
të grabitun prej syve të etënve

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

të bardha pupla pellumbash
të grabitun prej dashnisë njerëzore
të bardha flutura bore
të grabitun gëzimit e lirisë
jetës fëmijore
(lodrat mbetën të braktisuna).
sa e sa vorre dhe kryqe
vorre
vorre
vorre
kryqe
kryqe
kryqe
humbun
zhdukun
tretun
pa lanë shej e gjurmë
në këtë toke të shkretueme
prej stuhive të çmendunisë njerëzore
tokë lotësh
tokë dërgjesh
tokë në meshirë të fatëve mizore

ne lartësine e qiellit
në lavdinë e madhërishme të Zotit
buzëqeshje vëzulluese engjëjsh
gjitkund
yje
yje
yje
shëndritës
n'universin e pafund !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Balada e bukës

Yjet vështrojnë të heshtun
dhe vëzullojnë
në largësinë e nates kosmike
indiferentë
43one43t43 shtigjëve të mendimit
si lugetën e hije
qëndrojme pranë njeni tjetrit
e s'njihemi
as njohim vetvetën
(kërkova një copëz pasqyrë)
të gjallët jetojnë me të vdekmit
të vdekmit me të gjallët
për një kafshatë të thatë
për një kothere bukë
ne grahmën e fundit i burgosuni
mbërthen pas gjoksit racionin e tij
me dy duert skëletike
rrenkon
bukë
bukë
bukë!
Shpirti s'po don me 43one
aq i lidhun pas asaj kotherëje të thatë
aq e shtrejtë
aq e dashun
aq e shejtë
prej së cilës duhej të ndahej
me aq dhimbje
përgjithmonë

tre dit jetoi i vdekmi me të gjallët
e tre net
tre dit jetuen të gjallët

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

me bukën e të vdekmit
e tre net
tre dit e tre net
u përgjigj i vdekmi apelit të kapterit
me gojën e të gjallit
u gropos diku
ku ?
u gropos një njeri
u gropos një racion buke
u gropos një emën
një racion buke ma pak
një emën ma pak
në 44one44t e apelit
ma pak shkronja
ma pak 44one44t44
në librin e shkruem
me mija emna
të gjallë e te vdekun
në librin e kapterit
kryevepër
me mija vargje
kalue Homerit e Virgjilit
Dantes e Shekspirit

yjet vazhdojnë të vështrojnë
xixëllues
të heshtun
prej largësive të pafundshme
indiferentë
si gjithmonë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Bukë… bukë… bukë… !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Flijim mizor

Ç'asht ky idhull prej hekuri e çeliku
i ngritun
mbi këtë altar të tmerrshëm
të përgjakun ?
nje yll i kuq vigan
gjak
një drapën i ndryshkun vigan
gjak
nje çëkan i randë vigan
gjak
një flamur i huej vigan
gjak
potrete vigane
të Stalinëve & kompani
xhelatë përbindësh
terror përbindësh
mbi male skeletësh
kokallesh
kafkash !
cilet jane
këta shtriganë të çthurun
që nuk njohin Zot e fè
që shqyejne
kaq trupëza të brishtë
vogëlushësh të njomë
kaq trajta të bukura
vajzash e nusësh përri
kaq trupna të përkryeme
të rijsh guximtarë
kaq muskuj t'fuqishëm
trimash kreshnikë
kaq mise të lodhura

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

pleqsh të gjorë
të flijuem kurban
idhullit monstruoz
të komunizmit
të pa din e imanë
të pa fè
të pa Zot?
një kasapane krijesash njerëzore
të pafajshme
sakrifikue
nje pushteti tiranik
barbar
mizor !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Nën mbulesën e frikës

Acari i netëve të janarit
qëndron pezull mbi kampin
kërcënues
i kobshëm
vagëtima foshnjësh të njoma
rrënkime pleqsh
48one48t mortore
dëgjohën
48one48t atyne kazermave vigane
shpella ciklopike
ku i frikshëm
terrori
veshun me rroba 48one48t48
me qizme 48one48t48
me gryka pushkësh
automatikësh
me fjalë t'egra
barbare
poshtnuese
sillet rrotull i llahtarshëm.
struken viktimat
nën mbulesën e frikës
të mornicave
të ngricës.
Dikush tepër i lodhun
tepër i dërmuem
nën batanijën e randë
në gjumin e thellë të vdekjës
pushon
prej tre ditësh
zemër madh e bujar
racionin e vet të bukës
trashëgim
ua 48one48t gjallëve

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Kampi famëkeq i Tepelenës

Tepelena u damkos me njollën e turpit nga komunizmi, që aty krijoi kampet më të tmerrshëm të internimit që kishte njohun ndonjëherë vendi ynë. Duke përfshi edhe Turanin, Memaliajn e Veliçotin, aty u mbyllën për gjashtë vjet shumë të gjatë, me mija qënje njerëzore. Familje të tana. Pleq e plaka, burra e gra, të rij e të reja, fëmijë të mitur dhe foshnje të varun pas gjinit të nanave të reja, që sapo ishin nda prej burrave të tyne të arratisun në mal ose jashtë shtetit. Në kampin e Turanit konditat ishin tepër të këqia. Një mungesë e plotë e strukturave higjenike, krejtësisht primitive. Sëmundjet ngjitëse filluen të korrin viktima ndër pleqtë dhe fëmijët. Ishin këta që e paguen shtrejtë këtë gjendje 49one49t të një pakujdesie të pafalshme nga ana e 49one49t49s4949tes komuniste. Epidemitë shkaktuen një ekatombë të vërtetë foshnjesh të njoma. Vdekja nisi të korrte si pas qejfit. Shumë nana mbetën pa fëmijë. Xhelatët përfitonin për t'i nxjerrë menjëherë në punë të detyrueshme. Puna ishte shtazore, me mbajtë mbi kurriz si kafshë ngarkese, barrë të randa drushë, gurësh, etjerë 49one49t49s të randa Me kilometra e me orë të tana, nëpër shtigje të pjerrta e të ngushta malore, me shi e me 49one, me vapë e me acar, pa ushqim e pa veshmbathje. Prej vuejtjeve e mundimeve, prej urisë e prej të ftohtit, vdiqën shumë të internuem, sa që u ba problem për vorret, që kishin mbulue fushën në hyrje të kampit të Tepelenës e dalloheshin nga rruga automobilistike e binin në sy. Aty kishte kalue një ditë vetë diktatori, që kur mori vesh ç'ishin ato vorre, dha urdhër të zhdukeshin. Kështu u ndërmor nga komanda tranferimi i 49one vorrëve e shumë prej tyne humbën. Vorret u çuen në gryken e lumit të Bënçës, një gjysmë ore larg, për t'i përdjerrë. Ato vorre do tranferoheshin përsëri ma vonë, në 1953, për t'i zhdukun krejtësisht. Prania e fëmijëve në këto kampe ishte ana ma

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

50one50t50 dhe e tmerrshme. Kur shpërtheu dizanteria apo kolera, ata vdisnin si mizat. Në një natë të vetme, në kampin e Turanit vdiqën 33 fëmijë. Si pas dëshmitarëve që përjetuen ato rrethana të llahtarshme, pothuaj çdo ditë vdisnin nga shtatë – tetë vetë, në Turan, Memaliaj, Veliçot e Tepelenë. Për t'u përmendun, vdekja e dy binjakëve të vegjël të nanës malësore Cuklina. Njeni në mëngjes e tjetri në darkë. I gjithë kampi i lemeritun dha kujën. Vogëlushët ishin të bukur si dy engjëj dhe shtëpia e tyne dilte fare, sepse nuk kishte mashkuj të tjerë. Kjo ngjarje u kthye në tragjedi. Motra tyne, që ishte arratisë në Mal të Zi, kur mori vesh lajmin, vrau veten. Ma vonë lirohet e ama, tashma e vejë e pa asnjë fëmijë e pa kërkend. Kur kthehet në kullën boshe e të braktisun e zen një dëshpërim i madh dhe e ther veten me thikë. Këto ngjarje të kobshme, njollosin sistemin e diktaturës, si një 50one50t nga ma të urryemit e ma kriminelët, që populli shqiptar pati fatkeqësinë të durojë për 45 vjet rresht, duke e pague me flijimin e mija e mija viktimave të pafajshme. Këto poezi vlejnë për të dhanë ma të qartë përfytyrimin e asaj vale terrori dhe persekutimi që përfshiu vendin 50one gjatë një gjysmë shekulli.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Një mijë mundime

Mija 51one në pranga
mija 51one ekzekutue
mija 51one torturue
mija 51one ne burgue
mija 51one internue
mija 51one i uritun
mija 51one i etun
mija hereëi vdekun
mija 51one i kryqëzuem
ndeë mija kryqe
ndër mija pranga
ndër mija burgje
ndër mija kampe
lumej trupash të gjymtuem
lumej mëndjesh të përdaruna
lumej zemrash të brëngosuna
vijne trubull me gjak
shkumbues me gjak
lumej kockash të thyeme
gjymtyrësh të sakataueme
syshë të çakërdisun
gojësh të përçame
nga tmerri
barbaria.
e idhtarëve të skëterrës
xhelatë vampirë
ku mund të gjejnë strehim
shpirtnat tuej katran
shpirtnat tuej kriminelë?
për maskrat mbi njerëzimin
për gjakun e pafajshëm
që dërdhet mbi njerëzimin !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Ankth e shpresë

Sa dhimbje
sa dëshperim
pushtojnë shpirtin e sfilitun
ankthe
forma të perçudme
kërcënuese
përfytyrohen pa pushim
mbi skenare të përgjakun
perëndimesh të perflaktë
shqetësues
uraganë e stuhi shkatërrimtare
lamshe qenjësh njerëzore
52one52t52s universal
me gjak viktimash kupat plot
dehën monstrat e ngërdheshun
përbindshat që nuk njohin Zot
djajt 52one52t52 të rrathëfe të ferrit
ideologji 52one52t
të çmenduna
përfshijnë këtë tokë të përlotun
shëmbin e rrënojnë
shfarosin e përlajnë
me sadizem të ndotun
pa dhimsuni
pa ndërgjegje njerëzore
përplasën mbi këtë truell të shkretë
mundohën të errësojë diellin
mundohën të gremisi në humnerë
ruzullin mbarë

diell
ngrihu me fuqinë tande rrezatuese
me fuqinë tande të zjarrtë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

me fuqinë e dritës së pasosun
të drejtësisë
të lirisë
të mirësisë
të dashunisë
riktheje paqën në këtë luginë të pa shpresë
riktheje virtytin në këtë botë të përdalun
riktheje qetësinë në zemrat e brëngosuna
riktheje mirësinë midis popujve
riktheje dashuninë midis njerëzve !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Një heroine e lirisë

Flokët krrela krrela
vashëza e hirëshme
buzët si lulja e allit
vashëza e bukur
zemrën të florijtë
vashëza e 54one.

Tërhequn për flokësh
zvarritun
t'përgjakuna buzët
rrahun
sy të përvajshëm
mavitun

ma e bukur
me atë sjellje krenare
ma e bukur
me ato flokë të shprishun
ma e bukur
me ato sy të përlotun
aq ankth në zemër
aq ankth në mendje.

bisha lakmiçare
xhelatët
vështrojnë prenë e bukur
bisha të urituna
gllabëruese
dhe kur fillojnë të nxierrin
kthetrat
dhe kur nisin të shërmisin
dhambët
dhe kur hapin nofullat

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

t’egërsuem
prej dritarës
fluturon me vrull
vashëza krenare
vashëza e bukur
vashëza trime
heroina shqiptare
fluturim fatal
dallëndyshe pranvere
në një dimën të kobshëm
acar
ja vdekje ja liri
vdekje
liri !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
“MARIN BARLETI”
SHKODER (2018)

Ankimi i Zanave

I errët
qielli
e errët
toka
e heshtun era
të heshtun malet
të heshtun pyjet

s'vallzojnë ma
të bukurat Zana
as Orë e Shtojzovalle
ne 56one56t56 bardha
mbështjellë.
s'këndojnë ma
Zanat e malit
nën tingujt kumbuese të lahutës
kur ndrit hana e argjendë
kur ndrisin yjet e zjarrtë : :
vajtojnë !

trupore të ngurta
në rroba të zeza veshun
vetëm ankime
tashma
tinguj të kobshëm
nxierrin
prej lahutës së kohnave

ishin të rij guximtarë
ishin dragoj
si Zanat e malit trima
si lisat shekullorë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

të fortë
si shqipet flturuese
krenarë
si ylli i mengjesit
të bukur
ku janë miset tueja
hyjnore
ku janë armët e rrebta
ku janë lahutat kumbuese ?

më kot presin burimet
etjen tuej
më kot presin pemët
andjen tuej
me kot presin vashëzat
dashuninë tuej
me kot presin nanat
përqafimin tuej
të tretun janë eshtnat
të bjerrun vorret
e braktisun dashunia
të harrueme puthjet
shterrun burimet
pertha pemet
të coptueme lahutat !
në qiell shkëlqejnë
yje të rij llamburitës
çdo yll ma i ndritun se tjetri
çdo yll
një hero
në hapsinën e universit
në faqet e historisë
në zemrën e tokës
në kangët
në lëgjendat
të pavdekshëm !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Sa e bukur ishe moj Shqimni

Sa e bukur ishe moj Shqipni
tashma sa e zymtë që je !
ne burimet e tua
të kjarta
të kullueta
gjak !
në lumejt e tu
të shkathtë
të argjendë
gjak !
në liqejt e tu
pasqyra të qiellit
gjak !

sa e lumtun ishe moj Shqipni
tashma sa e trishtueme je !
në pyjet shekullore
vorre
në detnat e kaltra
vorre
në shkrepat granitor
vorre
të humbun
të perdhunuem
eshtnat e herojve
tretun !

sa e hishme ishe moj Shqipni
krenare
për historinë tande
të skalitun
në rrjedhën e shekujve

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

prej bijve të tu kreshnikë
të dalun
prej lëgjendave të lashta homerike

Plot shkëlqim njato dy sytë e zi
faqet e kuqe porsi molla n' gemb
buzët e tua gazmore
porsi lulja e allit
shtatin si selvi
gojën plot me kangë të hareshme
kangë trimnije
si ato Zanat e malit perri
sa fatkeqe je tashti Shqipni !

mbrapshtue historia
lëgjendat përdhunue
sytë mbushun me lot
faqet flakë e zjarr
prej marazit
buzët nxi prej tmerrit
goja plot vajtime
shtatin me plagë mbulue
kështu të katandisën
e të kanë mjerue
xhelatët e këtij shekulli kobzi
qofshin mallkue !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Atdhe Atdhe i imi

Atdhe Atdhe i im
tokë herojsh
tokë lëgjendash
gojdhanash
që trashëgohen ende
ndër malet e bjeshkët e nalta
ku fluturojne të lira
shqipet krenare
prej mjegullnajës
së kohëve të shkueme
ndër pyjet e tua shekullore
ndër fushat
lumejt
detnat
ku flitet
një gjuh e vetme arbnore

Atdhe Atdhe i im mijavjeçar
qytetnime të lashta
ruen me xhelozi
në gjinin tand
tokë bujare
tokë trimash
q'aq forcë i dhe
krahut të fuqishëm
të Gjergj Kastriotit Skenderbeut
Herojt të pavdekshëm
të Kombit shqiptar

Atdhe Atdhe i im
tokë ligjesh të moçme

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

tokë e Kanunit të Lek Dukagjinit
të ligjit primar
të shqiptarve
krijue
në agimet e njerëzimit.

tokë poetësh
lahutarësh
atdheu i Gjergj Fishtës
vjershëtari të madhërishëm
Homeri i fundit
i njerëzimit
që i këndoi trimnitë
heroizmat
e një populli luftëtar
e një populli kreshnik
e një populli liridashës
e nje populli shum të lashtë
si bjeshkët shkambore
që naltohën hijerandë
kunorë
të pamposhtuna kurdoherë.

Atdhe Atdhe i im
aq i çartun e fatkeq
në skëterrën e komunizmit
në sketërrën djallëzore
në skëterrën gjakatare
aq i çartun e fatkeq.

Gjithmonë qëndrove i vendosun
me trimni krenare
ndër stuhitë e 61one61t61s61
s'pyete as për djall as dreq
as për baloza zullumqarë.
Histori të reja
kangë të tjera heroike

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

do të thurin e këndojnë
poetët mendjendritun
rapsodët e lahutarët
me atë lahutë aq të moçme
me atë lahutë jehonë e shekujve
e gdhendun me çelik shpatash
me hekur e zjarr betejash
e kalitun me burrni shqiptare
e stolisun prej mjeshtrave malësorë
e ruejtun prej Zanave belholla
n'ato bjeshkë të nalta mbulue me 62one

histori të reja
kanë me u këndue
qe te mbesin trashegim
për breznitë e ardhshme
të trojëve arbnore !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Pamje e brendshme një kazerme të kampit të Tepelenës,
si sihin të stivosur të internuemit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Bir'i i njeriut

Kur dhimbja dukej se po më shqyente miset
kur tmerri dukej se po më çthurte mendjen
kur mënija dukej se po më pushtonte trunin
kur vuejtja dukej se po më trondiste shpirtin
kur lutja dukej se po heshte
dhe qëndronte memece
mbi buzët e zhurituna
përpara me je shfaqej një kryq
e mbi atë kryq
i kryqëzuem
Bir'i i Njeriut
me atë kunorë gjembash
mbi ballin hyjnor
me ato gozhdë t'ashpra
mbi duert bujare
me ato kuja të ndryshkun
mbi kambët e lodhuna
me ato plagë të gjakosuna
mbi gjoksin e shejtë
i çame nga një heshtë mizore
me atë fytyrë të pikllueme
për botën mëkatare
me ato sy të ndritun
mishörues
nga dhembshunia e madhe

sa dashuni në atë vështrim të zjarrtë
në atë vështrim lutes
për ata që po e dënonin
që po e torturonin

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

që po e vrisnin
që po e kryqëzonin mbi kryq
zhdukeshin
dhimbja tmerri dhe urrejtja
e prej thellësisë së gjithë qenies sime
vinte fuqia dhe guximi
besimi dhe shpresa
lutja rikthehej
në buzët e përthame !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Lahuta e coptueme

Mora lahutën
me ia marrë një kange
një kangë trimnije me këndue
një kangë të maleve tona

të ‘ankueshëm kumbuen
tingujt e lahutës
të vrazhdë
therës
thika në zemrën e lëndueme të njerëzve
si vaji i ngashruem i fëmijëve
në përpëlitjet e fundit
si lemeria e nanave të shkreta
mbi trupat e vogëlushëve pa jetë
si 66one66t e pleqve të mjerë
buzë vorrit të zi
si britma e llahtarshme e 66one66t66s
si kërcëllitja e prangave
si bataret e pushkëve vrastare

kupa e qiellit 66one66t mue
mbeta haru
ngrinë vargjet mbi buzët e zbeta
heshtën tingujt e lahutës së lodhun
s’ishin 66one66t ma male
s’ishin fushat ma fusha
s’ishin pyjet ma pyje
s’ishin mrizet ma mrize
s’ishin krojet ma kroje
s’ishin kangët ma kangë
hana nuk ndriçonte për Shtojzovalle
as për Orë e Zana
dielli nuk shëndrisste si përherë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
“MARIN BARLETI”
SHKODËR (2018)

qielli qëndronte krejt i mvrejtun
prej reve të zeza të stuhive

lahutën e kapërtheva me dy duer
e përplasa për një shkamb graniti
e coptova për një trung lisi
tinguj të rënqethshëm u ndigjuen
jehuen të kobshme
isot e vajtimeve mortore!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Zbrazëti

Bora bie
e bardhë e papërlyeme
dhe ndotët e nxihet
prej çthurjeve të njerëzve
dhe skuqet
prej gjakut të viktimave
dhe kthehet në akull kallkan
prej mospërfilljes
kthetra të ftohta
kanë mbërthye njerëzit
(dimën i madh)
dielli qëndron i strukun
mbas shtëllungave të zeza të reve
dashunia përdaret nëpër shtigjet e harresës
një natë e gjatë diluviane
mbështjell rruzullin tokësor

n'errësinën e llahtarshme
të kalamendun
i shtrijmë duert njeni-tjetrit
zbrazëtia hapet para nesh
e përfrikshme
shtrijmë duert për të gjetë një mbështetje
atje ku ka vetëm humnerë!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

E kaluemja nuk kthehet

Kurrë
kurrë
nuk rikthehëmi
në lojnat e fëmijore
në lumturinë e rinisë
në dashuninë e pafund
të nanave tona
t'etënve 69one

një stuhi e përgjakun
një stuhi e përfrikshme
zhduku
format e tyne toksore
bashkë me to
çdo kujtim
çdo ndjenjë

mjegull e largët kohore
abstrakte
vëgimtare
mbetet tashma
e kaluemja
ajo nuk rikthehet ma kurrë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

III

Pluk i Lushnjës


1958-1990

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Gjurmë të humbuna

Hap pas hapi
zvarritem
nëpër shtigjet gjithë pluhun
të arave
ndjek hijën time
hijën timë besnike
të heshtun
qe më prin e stërgjatun
nën dritën e venitun
të diellit përëndues
mbrapa
mbi pluhurin e shkriftë
mbetën gjurmët e mija të lodhun
ç'do hap një mendim
çdo hap një ndjenjë
çdo hap një kujtim
me çudi
e vështrojnë gjurmët
këtë vetmitar
këtë hije
që zvarritet nëpër pluhurin e fushave
aq i lodhun
aq i mëndueshëm
vetëm gjurmët
mbesin mbrapa
stamposun
n'atë pluhur të butë
që zhdukën në hi
nën vrullin e parë të erës !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Nana e autorit, vizatim në kampin e Tepelnës 1951. I internuar më 1945 beri 32 vjet internim, deri 1977, kur nderroi jetë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Nanë,nana ime

Nanë
nanë
nana ime !
nje britmë plot ankth
plot ankth një thirrje
prej thellësisë së qënjes sime
prej zemrës
prej shpirtit tim
nje jehonë
një fytyrë
një buzëqeshje
një gëzim
kujtime të një fëmije

mundime
lot
dëshpërime
vdekje
kujtime të një njeriu të brëngosun
mbërthye në pranga
trup
mendje
shpirt
përçudnue
mohue
mbaru

e randë pesha e padrejtesisë
e randë pesha e mohimit
e randë pesha a absurditetit
e randë pesha e terrorit
e randë pesha e përversitetit

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

nanë
nanë
nana ime
dashunia jote thyen prangat e zeza
përmbys muret e absurditetit
rropos të gjitha mbrapshtinat
i jep drite mendjës
fuqi trupit
liri shpirtit.
zani yt i ambel asht i larget
fytyra jote
vetëm një kujtim
dashunia jote
vetëm një vëgim.

nane
nanë
nana ime
ndigjoje britmën e tand bir
ndigjoje thirrjen
në prehnin tand
gjen prehje
si fëmijë
përsëri !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Terror e mizori

Një mjegull e përmortshme
një mjegull e përgjakshme
mbi gjithë vendin
terr
e nëpër terr e terr rreshqasin hije
shpirtna t'arratisun të mallkuem
e nëpër terr e terr një heshtje e randë
që të len pa frymë
ashtu
haru

hije lugetnish nëpër rrugët
hijet e xhelatëve
vijnë vërdallë
çdo shtëpi përgjon me frikë
me ankth e brengë
llahtar

befas
një trokitje dyersh
aq shurdhuese
një potere prangash
aq e vrazhdë
gulçasin kamionët
të tronditun
breshën
hapa policësh
mbi kalldram
sigurimi
tmerr!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

burrat i kanë lidhun
trimat i kanë prangue
po duen trimat për me i vra
po duen trimat për me i pushkatue
mizorisht
vajë nanash të mjera
vaje nusesh e motrash të ngrata
vajë i ngashruem fëmijesh jetima

edhe muret e shtëpive
qajnë
edhe gurët e kalldremëve
qajnë
edhe makinat e kaminonat
qajnë
veç përbindëshi qesh
gajaset
si oktapodh hukubet i ndyre
zgjat krahët gjarpij - shushunja
që shtrydhin pa mëshire
viktimat e shkreta
shtrydhin
shtrydhin
viktimat e pafajshme

lot në sytë e nanave
lot në sytë e motrave
lot në sytë e nuseve
lot në sytë e fëmijve.
gjak në sytë e xhelatëve
gjak mbi ballin e katilëve
gjak mbi duert e vrasëve.
krisma pushkësh mortore
në breg të lumit
gjak në ujnat e trembuna
lot në zemrat e nanave

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

batare plumbash
mbi gjokset e trimave
gjak mbi zallishtën e bardhë
lot në zemrat e motrave
tyta të zjarrta mbi ballin e herojve
gjak mbi ranishtën e shkriftë
lot në zemrat e fëmijëve
përhapet jehona e përfrikshme
tronditën malet e fushat
llahtar
nje za buçet i fuqishëm
një thirrje
ma e fortë se krisma e armëve
ma e forte se breshëria e plumbave:
Rrofte Liria!

dridhet zemra e tiranit përbindësh
tmerrohet
monstri ngrin i ngërdheshun
ushqye me gjak
zhytun ne gjak
se fundit hesht
infarkt !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Mater Dolorosa

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Lëgjendat përsëriten

Një baloz i ardhun prej stepave Siberiane
apo prej Uralëve të largta
e prej malëve t'ashpra të Kaukazit
kishte lëshue një haraç të randë
nga nje trim për shtëpi
po don me gri
e vajza t'reja
me gllabërue
me gjakun e viktimave
etjen me shue
i pangopshëm gjithmonë
kanibal mizor
hukubet e katalla i ndyrë
me një sy të kuq gjak në ballë
si gacë prushi i zjarrtë
me një drapën në një dorë
me një çekan në tjetrën
korr qënje njerëzore pa meshirë
dh'eshtnat ua copton
me egërsi

Gjergj Elez Alia kreshniku i malëve
trimi i pavdekshëm i lëgjendave shqiptare
paska dëgjue
turrshëm asht çue si rrufeja
nga varri shekullor
pllakat e gurta tutje tuj hedhë
ka ngjesh armët e rreptа
ka shilue atin pullalli
ka vringllue shpatën flakëruese
me balozin forcasht kapërthye

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

në sulme ngulmuese
idhshem tuj flakrue patershanat
rreptas tuj kryqezue jataganat
fort fuqi i ka dhanë krahut Gjergj dragoi
si nje vetimë ka shkëlqye shpata mizore
koka e balozit ka flutrue në njenën anë
trupi asht gremis në anën tjetër
u perserit e lavdishme
lëgjenda e vjetër !

Baloza
Baloza
të zi
të kuq
të verdhë
me shqiptarin mos u ndeshni kurrë
mos u ndeshni me Gjergj Elez Ali
si malet shkambore asht forca e tij
s'pyet për plagët e luftave shekullore
qe e randojnë
s'pyet për rrasat e mermerit
që e mbulojnë
nga vorri çohët përsëri
nuk lejon që sytë e bukur
të motrës trime Tringë
të lotojnë
nuk lejon që kambë anmike e huej
të shkelë atdheun e tij
s'duron që balozat të kapërdisen
e me thundrat e tyne kafshore
të shkelin trojet shqiptare
haraçe tuj kerkue e flijime
e vasheza të bukura si përri
kurdohere do të gjëndet
kurdohere do të ngrihet
një Gjergj Elez Ali
burrë mbi burrë e trim i rallë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

tokave arbnore
zot me u dalë ngadhnjimtar
anmiqt
baloza qofshin
apo kulshedra me shumë krena
me i rroposë e me i përmbysë
e me i shue fare !

ne çdo votër
të kullave kala shqiptare
do të kumbojnë tingujt e lahutës
lëgjenda të reja do të thurën
e Oret e Zanat e malit
e Shtojzovallet
do të kërcejnë
kangët e heroike tuj këndue
për fatosin e pavdekshëm
trim mbi trimat Gjergj Elez Alinë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Dashuni e ndrydhun

Dashunia mbeti e ndrydhun
ndër muret e mendimit
dhe mendimi vetë
ndër muret e qëlive
(e kam fjalen për trunin)
andrrat vetëm
mund të dëpërtonin përtej gurit
mund të dëpërtonin përtej betonit
përtej dyerve të hekurta
e telave me gjemba

ne pandërgjegjën e gjumit
çdo andërr ishte dashni
e dashnia vetë
andërr
e bukura ime
një vëgim !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

!

Balada e trëndafilit të bardhë

E këputa një gonxhe trëndafili të bardhë
në agimin e një dite pa shkëlqim
dielli fshihej pas reve të zeza
dielli nuk lëshonte ma nxehtësi
nuk kishte ma forcë
nuk kishte ma jetë
ishte shue
si mund të çelte trëndafili i bardhë?

e vendosa në një vazo të kristaltë
në dhomën time të vetmueme
ku diell ishte dashnia
ku dritë ishte mirësia
u magjepsa me lulëzimin e trëndafilit
me shkëlqimin e petaleve të bardha
dhe u mahnita nga ajo bukuri e rrallë
bukuri e brishtë!

e pashë trëndafilin tue u venitun
petalet binin njeni pas tjetrit
si fjolla dëbore
të ftohta
dimni po trokiste mbi xhamat e dritares
dielli tashma ishte harrue
shpirti po shuhej
në përqafimin e errësinën siderale
ku nuk mund të çelnin trëndafilë të bardhë!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Ecce Homo!

Njeriu
kapitali ma i çmuem
shkruente Lenini
po
vërtet
asht njeriu
kapitali ma i çmuem
shpallte Stalini
prej Siberisë së pafund
mbi ato miliona krijesa njerëzore
që i kish zhduk
në hiç

Ecce Homo !

shpallin bijt e Stalinit
gjithashtu
Çausheskët
Enverët
Pol Potët
Maot
krijesat përbindëshe
të komunizmit
shpallin e shpallin
xhelatët e popujve
dhe demagogët e tjerë
diktatorë.

Ecce Homo

Po
njeriu i prangosur

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

njeriu i fyem
njeriu i torturuem
i kryqëzuem
i masakruem
i vramë
njeriu i mjerë
bagëti
për me ngranë bar
njeriu i degraduem
për me brejte një kockë
një popull
një popull i tanë
për me brejte një kockë.

Ecce Homo !

në banketët e përbindëshve
mish
në kupat e arta të vrasëve
gjak
në gotat e kristalta
të varrmihësve
lot
në syte e përskuqun të xhelatëve
në buzët e dëformueme
egërsi
sadizëm
tmerr
tmerr !

Ecce Homo !

ja njeriu
njeriu i Leninit
njeriu i Stalinit
e i bastardeve të tjerë
i bijve të dënjë të tyre

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

grabitçarë të urryem
të njerëzimit
përbindësh
ja pra
ky ishte njeriu
i Leninit & kompani
kapitali ma i çmuem.

Ecce Homo !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Korbat

Nje korb
flutoroi
mbi majen e një lisi shekullor
me qindra korba të tjerë
pas tij
mbulojnë degët
me një kunorë t'errët
ogurzezë
dhe fillon orkestra
sinfonia makabre
dhe kori
krokatja
krra...krra...krra...

heshtin kangët e bilbilave
cicërimat e zogjve
pushon fluturimi i pëllumbave
në qiellin e kaltërt
të dlirtë
re të zeza
mbulojnë diellin perëndues
te zhytun në llucën e mashtrimëve
të një ideologjie të përdhosun
përverse
qëndrojmë të pafuqishëm
n'atë errësinë të pistë
të përçudun
thundra e randa e diktaturës
shkel mbi kokat tona
mbi miset tona
e dhunshme
dërmuese

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

ndigjohet vetem
krokatja
e sorrave e stërqokëve
te kërmave
krra… krra… krraja
e korbave të zi !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Vrasjet në kufi

Ata që qëndronin të dënuem në kampet e internimit nuk kishin asnjë mundësi që të arratiseshin, sepse ishin të rujtun ditë e natë prej organeve të sigurimit e prej spiunëve të ndryshëm që kontrollonin çdo lëvizje. Kush prej tyne orvatej të ndërmerte një hap të tillë ose përfundonte i vramë ose kapej e degdisej në burg. Ndërsa ata që quheshin të lirë, e kishin më lehtë t'i iknin kontrollit e vigjilencës së forcave të sigurimit e ndërmerrnin guximin për t'u arratisun jashtë shteti. Disa arrinin të kalonin, por ma të shumtët mbeteshin të vramë mbi telat me gjemba ose kapeshin duke pësue tortura e dënime të randa. Ushtarët kufitarë caktoheshin nga familjet komuniste, sepse tek të tjerët regjimi nuk kishte besim. Kohët e fundit, ushtari që arrinte të vriste një njeri që kërkonte të arratisej, shpërblehej me 3000 lekë dhe një leje një mujore. Një akt që tregonte qëndrimin kriminal të qeverisë komuniste, për t'i mbajt shqiptarët të mbyllun brenda kufijve si në një vath bagëtishë . Sigurisht se ky përcaktim i mbylljës i kapërcente përmasat, sepse vendi ishte kthyer në një burg apo vorr të madh. Rënqethëse ishte shëtitja e kufomave të të vramve nëpër fshatna, të lidhun me tela me gjemba mbi ndonjë rimorkio traktori apo pas noçkës së ndonjë buldozeri, për t'i kallun tmerrin popullsisë. Megjithë këto masa makabre, të rijtë nuk përmbaheshin dhe kërkonin vazhdimisht për t'u arratisun drejt botës së lirë, që sistemi komunist ua ndalonte me masa nga ma të egrat shtypëse. Një gjendje që nuk kishte ekzistue kurrë gjatë gjithë historisë sonë që prej pushtimit turk e këndej. Në kohën e mbretnisë, njerëzit hynin e dilnin prej Shqipnisë lirisht me pasaporta e pa asnjë pengesë për punë, për studime, për qejf e të tjera arsye. Diktatura komuniste bahej çdo ditë e ma tepër ma e padurueshme. Persekutimi politik sa vinte e shtohej. Vdekja e diktatorit nuk solli asnjë ndryshim për mirë,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

bile gjendja u keqësua ma tepër, sepse ekonomia arriti në falimentimin e saj të plotë. Qeveria filloi të marrë masa shtypëse të pajustifikueshme. Shqiptarët kërkonin të afroheshin nga Evropa, kurse pushtetarët vazhdonin të rrinin të lidhun pas qerres së komunizmit aziatik të Moskës, të Kinës, Koresë etj.! Kjo gjendje nuk mund të mbetej e pa pasqyrueme dhe në veprat e shkrimtarëve, por sigurisht jo të atyne që ishin të inkuadruem në Lidhjen e Shkrimtarëve të "Realizmit socialist", sipas të cilit ky lloj realiteti duhej të paraqitej i idealizuem dhe lulëzuem, në kundërshtim me gjendjen, ku të drejtat themelore të Njeriut ishin të mohueme e të shkeluna zyrtarisht. Në këto poezi trajtohet ai realitet i hidhun që kishte mbërthyen vendin si në një danë të hekurt, për të mos i lanë njerëzit me marrë frymë as me mendue një çast të vetëm. Gjithashtu tregohet se arti e letërsia trajtohëshin në frymën ideologjisë komuniste dhe te « luftës së klasave » , dhe i shërbenin atij sistemi kriminal të terrorit. Asnjë shkrimtar ose artist i numenklaturës komuniste nuk mund t'i ikë përgjegjësisë morale e faktike, sepse ata i ishin konformue plotësisht atij regjimi, të cilit i shërbenin me zell e devotshmëni. Me anë të këtij libri me poezi jemi të ndërgjedhshëm se dëshmojmë para historisë atë të vërtetë makabre që ishte mbytë e mohue gjatë gjithë pêriudhës së sundimit të diktaturës komuniste.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Mallkim

Një mëngjes i kuqërremtë
i pergjakun
mbi këtë tokë fatkeqe
të braktisun
të poshtnueme
të perçudun
një yll i kuq me drapën
një yll i kuq me çekan
yll e drapën e çekan
simbole absurde
të hueja
anmiqsore+
mbi një flamur të kuq gjak
gjak që rrjedh e kullon
gjak therorësh

drapen
mbi të korrat e bollshme
martirësh e viktimash
gjak
çekan
mbi kockat e coptueme
herojsh e dëshmorësh
gjak

drapen
tmer
çekan
tmerr!
kazme e pushkë
të tjera simbole absurde

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

shkatërruese
kazme
shëmbje
varrmihje
pushkë
vrasje
krime

xhelatë mizorë
vrasës të pafajsisë
shporruni
jashtë historisë e qytetnimit
te mallkuem !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Dikush vdes

Kur hedh një vështrim mbrapa
në brazdën e gjatë të kohës
mundohem të hulumtoj
të kuptoj
të shoh
pa frymë mbetëm
i tmerruem

një turmë njerezish mjeranë
më shfaqet
të zbathun
të çveshun
që zvarriten
nëpër balturinat e moçalëve
nëpër llucat e zeza
kazma e lopata
kazma e lopata
kazma e lopata
dhe policë
bisha t'egërsueme
çërberë
nofull dalë
çakërdisun e çatallue
gishtin e pamëshirshëm
mbi kambëzen e armës vrasëse
breshëri mortore
mbi trupat e zdërlaqun
të lodhun
pa mbrojtje
pa forcë
pa shpresë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

dikush vdes
një babë
një djalë
një vëlla
një mik
një shok
një njeri
vritet
vdes
varri i tij
lluca
varri i tij
kujtimi
ndoshta
emni !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Bijt e Prometeut

Netët njohën vetëm
n'errësinën e shëmtueme
të qëlive të ftofta
terrorin njohën vetëm
torturat barbare
të xhelatëve vampirë
gjak e lot
ankth e brengë
njohën vetëm
ata
që misheronin dituninë
të ushqyem me zjarrin e pashuem
të Prometeut
pishtarë te flakëst hyjnore
qe e ngriten lart
mbi kete truell te lashte
ata
që po i këthenin kombit
lavdinë e kohnave heroike
dhe po hapnin rrugën
drejt qytetnimëve të reja !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Sa lutje ?

Sa lutje
(nje lutje ?)
me mija lutje
me miliona lutje
murmuritën
në buzët
në zemrat
në shpirtnat
mendjet e çorodituna
buzët e përthame
zemrat e coptueme
shpirtnat e brëngosun

nuk mund të perqendrohemi
në mendime
dyshim
nuk mund të levizim buzët
dyshim
nuk mund të tregojmë
rrahjet e zemrës
dyshim
nuk mund të shfaqim
krenarinë e shpirtit
dyshim.
ligji i dyshimit
kërcënues
qëdnron si orl grabitçar mbi ne
(apo shpatë e Damokleut ?)
lutjet që shtjellohën thellë në qënjen tonë
në këto netët e gjata dimnore
si farnat bimore të përthame
mbetën të ngrime në acarin e akullt

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

presim diellin e nje pranvere të largët
a do na ngrohin vall rrezët e tij ?
lutemi
mjafton të na plotësohet një lutje !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Teori e praktikë

Darwin
Darwin
sa e mrekullueshme teoria jote !
prej epokave të harrueme
prej shpellave të errëta
të një bote të humbun
të varrosun
nxore në dritë
ringjalle
lëgjendën e madhe
aventurën e mrekullueshme
të njeriut
" homo sapiens "

miliona e miliona vite
u deshten
(sipas teje)
qe nje majmun
kafshe gdhe
i pavetëdijshëm
" Homo inconsciens "
të transformohej
në një qënje njerëzore
ma të zhvillueme
të vetëdijshme
" Homo sapiens "

Darwin
Darwin
sa e kotë ajo teoria jote !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

nje biri të mallkuem të Stalinit
një diktatori paranoiak
i mjaftuen
vetem dyzet vjet
me revolucionarizue
njeriun e dijshëm
" homo sapiens "
në kafshë primate
majmun
kafshë gdhe
njeriun e ri
" homo novus "
me e transformue
e përçudnue
një popull të tanë
në kafshë primate
majmun
kafshe gdhe
ne njeriun e ri
" homo novus "
majmun !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Dëshpërim

Lëkundet shpirti i shqëtsuem
n'errësinën
e këtij shekulli absurd
absurde
padrejtesitë
absurde
barbarizmat

mbi brigjet ranore të kohës
shkelin hapat tona
kërkojnë të lajnë
gjurmët e kujtimëve
që i fshin era parreshtun
që i fshijnë dallgët e detit
në çdo çast

shtrijmë duert drejt qiellit
lutës
me dëshpërim
në rrjedhjen e lotëve
shkruhën lutjet tona
në rrjedhjen e gjakut
fiksohet fati ynë.

nanë Shqipni
nanë e shejte
nanë shekullore
nane e mëshirshme
e kombit mbarë
kthej sytë nga bijt e tu
të syrgjynosun
të prangosun

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

në prehnin tand
na merr
na mbron
në ate prehën
bujar
në krahët e tu
në dashninë tande
në dhemshurinë tande
kërkojmë
tashma
shpëtim !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Frati dhe kryqi

Dite e kobshme për njerëzimin
një diell i zymtë
me dritë të mekun
me grohtësi të paktë
një simbol i turpshëm ngrihet mbi botë
një kryqëzim absurd
drapen e çekan
tmerr
në shpirtnat e sfilitun
në mendjet e çorodituna
tmerr
mbi popujt e nënshtruem !

një kryq i thjesht druni
një kryq krejt i thjeshtë
spikat në qiellin e përgjakun
në këtë agim të trishtë
një kryq
në dorën e thatë
të një frati të mjerë
pret frati i vogël
në bregun e mallkuem
të një lumi
pret në heshtje
goditjen e plumbave vrasës
kur krisma e kobshme e armëve
bashkohet me currilin e gjakut të shenjtë
kryqi mbetët lart në qiell
në grushtin e hekurt
të fratit trim
kryq i thjesht prej druni
kryq vigan i lirisë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

i një vullneti hyjnor
me një shkelqim llamburitës
kryq i përflakun
madhërisht krenar
mbi botën
mbi njerëzimin
kryq fitimtar !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Urrejtje e mëshirë

Nje dorë mizore
një grusht mizor
ngrihet
mbi qiellin e vrejtun të historisë
përplaset shkatërrues
mbi vlerat e larta njerëzore
mbërthen
në kethetrat e përçudme
misionarët e besimit
lajmetarët e dashnisë
të vllaznimit !
shoh
gjymtyrët tueja
të shqyeme
prej breshërive të armëve vrasëse.
shoh
plot ankth të papërmbajtun
miset tueja
të dëformueme
nga laku i litarit
në ato ditë të mynxyrta
të terrorit absurd
shoh
fytyrat tueja të gjakosuna
kunora gjëmbash
mbi ato koka të lodhuna
gozhdë katile
mbi ato duer të shejta
gozhdë xhelate
mbi ato kambë të zbathme
shoh
buzet e perhame zhur

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

prej etjes
gjokset tueja bujare
të gjaosun
mbi gjithë ato kryqe
u shoh
të kryqëzuem !

kurre s'përjetoi ma turp bota
kurrë s'përjetoi ma urrejtje njeriu
mbi këtë tokë gjynahqare
të përdalun
dhe kurrë
nuk pa dashuni ma të madhe rruzulli
n'ato vështrime
plot besim të zjarrtë
kur në çastin e fundit
lutëshin
për katilët
fali o Zot
se nuk dijnë çka bajnë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Terror bolshevik

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Një martir ma tepër

Në zymtësinë e një dite shiu
një zymtësi qënjesh njrëzore
qe hiqen zvar
nëpër moçalishte
e balta kënetore
me lopatat mbi supet
skllevën
me prangat mbi mendimet
skllevën
me grykat e pushkeve mbi tamthet
skllevën !

t'errta
të kobshme
kalojne retë
lotuese
në velot e tyne te zeza mbeshtjellë
kalojne retë
vajtuese
kah vështrojnë
atë turmë njerëzish t'rraskapitun
që zvarritën
në llucën e pistë
rreshqitëse
nëpër baltën ngjitëse
gjymtyrë skëletike
kufoma të gjalla

nje krah ngrihet drejt qiellit
prej llucës së gjakosur
një dorë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

një kryq
një heshtje
një vdekje
një tmerr
një skllav ma pak

një njeri ma pak
një frymor ma pak
një emnë mpa pak
një martir ma tepër !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Kryqi i pavdekshëm

Një mendim i mbrapsht
në trunin e Marksit
dhe ma mizor
i çthurun
e djallëzor
në mendjen paranoiake
të një diktatori të madh
të një populli të vogël
ateizmi !
u shëmbën kishat e faltorët
xhamijat e teqet
u shkulën kryqet e varrëve
u shkulën zemrat
u shkulën sytë
u shkulën kambët
u shkulën krahët
u shkulën kokat
e fetarëve
priftave
murgjëve
të pambrojtun
por jo
kryqi i pavdekshëm
i ruejtun në shekuj
nga çdo besimtar burrë
nga çdo besimtar grue
nga çdo besimtar femijë
simboli i shejtë dymijëvjeçar
dymijë vjet besim i patundur
flaka gjithmonë e ndezun
në shpirtin kristian
gjithmonë
ngadhnjimtar !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Apostujt e besimit

Dymijëvjeçare
rrajët e tua
kryq
në këtë tokë të moçme
të ashpër
ku shqipet fluturojnë të lira
mbi malet mbulue me borë
nëpër kreshtat shkambore
e pyjet e çetinave vigane.
ndigjohët kushtrimi i borive luftarake
ndigjohët ushtima e armve të rrepta
ndigjohët jëhona e kangëve trimnore
dhe një kumbim i largët
që nuk shuhët kurrë
prej kishave të humbuna
të vjetra
një tingull këmbanash
përtej hapsinave kohore

në këtë luginë hallësh e mundimësh
plot lot e gjak
në këtë luginë mizorishë e krimësh
gjith padrejtësi
në këtë luginë vuejtjesh e mjerimësh
ku e keqja
shtrinë kthetrat e saj kërcënuese
hukubete
mbjell terror
tmerr
ankth
frikë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

e ne simbolin e nje drapni absurd
mbjelle vdekje
korr jetë njerëzore
e në simbolin e nje çëkani
thyen e shtyp
mish e kocka
pa mishirë
.
të dërmuem
apostujt e besimi
të poshtnuem
apostujt e së vërtetës
të përbuzun
apostujt e dashunisë
të kryqëzuem
apostujt e ndërgjegjës
kurrë
nje ankim prej buzëve të zhurituna
për një pikë ujë
në çastet e torturave barbare.

Kurrë
një urrejtje në sytë e trishtun
mëshirues
në çastet e fundit të jetës
vetëm dhemshuni
përkushtim
në Krishtin të mishëruem
Krishta !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Lavdi martirëve

Pranvera
stina ma e bukur e jetës
sot i përulet vdekjës
vdekjës se lavdishme.
në kujtim
të nanave
të nuseve
të fëmijëve
në kujtim të kombit mbare
me ma të bukurat lule
me ma të njomin bar
hijëshon
vorret e shejta
të panjohun
të tretun e humbun
të martirëve
dëshmorëve
shqiptarë
atje ndër pyjet shekullore
atje ndër bjeshkët e nalta
atje ndër fushat pjellore
ndër lumejtë e vrullshëm
ndër dentnat e kaltërt
vorret e shejta nderon
të luftëtarëve
therojve të pavdekshëm
të dëshmorëve
martirëve
të Lirisë !.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Vajtim

Kush ishte ai shpirt katran
tiran mizor e faqezi
që mëshirë s'pati
as një grimë turp
e këtu
mes këtyne maleve gurore
nën hijen e kësaj kalaje
të mynzyrtë
ju përplasi
ju pllakosi
vogëlushë engjëllorë
ju ndryni si qingja në vath
në pritje të kasapit të përbindshëm
një nga ju përlanë
ju shkëputën nga gjini i nanave
porsi njaj skyfteri grabitçar
kur mbërthen me kthetrat mizore
zogjt e klloçkës së lemeritun
ju groposën në dheun e zi
ju groposën në dheun e ftohtë
mbushën brigjet e prroskave
me vorret tueja të vogla
kujës ia dhanë nanat e shkreta
qyqe vetëm mbetun
kërcuna.
vajtimi i kobshëm mortor
jehoi anëmbanë
u ngrit qortues
dënoncues
mbi tokën mbar
a kishte nanë ai katil
grue a kishte
a kishte fëmijë?

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Vrasjet dhe ekzekutimet

Vrasjet dhe ekzekutimet e njerëzve, viktima krejt të pafajshme, pa gjyqe apo të dënuem me gjyqe speciale, kryheshin në të aguem të ditës në bregun e lumit të çdo qyteti. Zalli i Kirit në Shkodër do të mbetet i kobshëm për shumë breza. Aty u pushkatuen me qindra e qindra intelektualë, fetarë, oficerë, personalitete e figura të shqueme të historisë e të kulturës, qytetarë e fshatarë myslimanë e të krishtenë, nga ma i randësishmi deri te ma i thjeshti. Edhe bregu i Lanës i Tiranës nuk i la gja mangut atij të Kirit. Ndër të tjera, aty u pushkatuen figura e personalitete të larta të Kombit, si Lef Nosi, Patër Anton Harapi, gjeneralët Aqif Përmeti e Gustav Mirdashi, kryeministri Maliq Bushati, Sheh Ibrahim Karbunara e plot të tjerë. Ashtu ndodhi në brigjet e lumejve: Vjosa, Osumi, Shkumbini, Semani, etj., që u përdorën si vende të ekzekutimeve kriminale të njerëzve ma të mirë të qyteteve pranë të cilëve ridhnin. Ma e keqja ishte se nuk i linin t'afërmit që t'i varrosnin, por pllakosëshin në gropa të përbashkëta diku në skuta të panjohuna. As sot e kësaj dite nuk u gjendën vorret. Në ato vende mortore nuk lejohej qarkullimi e ruheshin nga sigurimi, për të ndalue çdo orvatje nga ana e t'afërmve për të marrë eshtnat e të dashunve të tyne. Që vendi i vorrimit të mbetej i pagjetshëm, mbuloheshin nga vetë ushtarët e togave të pushkatimit. Kishte raste që groposeshin edhe të gjallët, që nuk i kishte kap plumbi ose kishin mbetun të plagosun. Rojet kanë treguë se si përdokohë ndigjoheshin rrënkimet e të vorrosunve ndërsa gjaku gufonte mbi zallin apo ranën. Regjimi komunist po zbatonte politikën e pansllavizmit të Stalinit, duke zhdukun gjithë shtresën patriotike e intelektuale të Shqipnisë. Po përgatitej terreni i përfshimjes së Shqipnisë në kampin sllav si republikë e shtatë e Federatës Jugosllave me president Titon. Ishin këto arsyet që atdhetarët shqiptarë nuk pranuen

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

të bashkëpunojnë me partinë komuniste shqiptare e cila ishte lidhun ngusht pas Moskës e Belgradit dhe zbatonte verbnisht urdhnat e udhëzimet e tyne antishqiptare. Si rrjedhim diktatura komuniste mori përsipër të spastrojë vendin nga të gjithë kundërshtarët politikë të saj, anmiq të përbetuem të sllavizmit e komunizmit , duke ushtrue terrorin ma të egër e kriminal ndaj tyne e duke mbushun Shqipninë me burgje e kampe internimi. Si pasojë vendi u mbyll hermetikisht dhe u izolue nga bota që të mos merrej vesh se çfarë krimesh të hatashme kryheshin brenda kufijve të tij, ku të drejtat ma elementare të njeriut, shkelëshin haptazi e pa ma të voglin pëndim, duke arritë në shkallën e krimeve kundër njerëzimit. Këto ishin pasojat e konferencave të Teheranit e të Jaltës, ku u vendos që Evropa Lindore dhe Ballkani të kalonin nën patronazhin e Bashkimit Sovjetik. Përfshimja e Shqipnisë në kampin komunist, ishte fatkeqësia ma e madhe që i ndodhi, ndër ma të kobshmet të historisë saj!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Agim mortor

Zemër thyem çohet agimi
lëshon dritën e mekun
mbi bregun e një lumi
mbi zallin e një lumi
zallin e Kirit
zymtohët qielli prej tmerrit

mbi atë breg të kobshëm
një kamion gulçitës
burra të lidhun
bijt e agimit te lidhun
te prangosun
gryka mashinkash mbi brinjët e tyne
kandaqe pushkësh mbi kokat e tyne
buzë humnerës se një gropore të zezë
surretën të zverdhun xhelatësh
kërcëllitje dhambesh xhelatesh
sy të përgjakun xhelatësh
një thirrje lamtumire
amaneti i fundit
rrofte liria !

breshëri plumbash llahtarisin malet
coptojnë zemrat e nanave
korrin qenje njerëzore
ikën nata e tmerrueme
një ushtar tregon :
të gjallë i mbulova heroit
me këto duer
te gjallë
dhe me këto duer
vehten due me mbulue

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

gjama e tyne
gjama ime
vaji tyne
vaji im
grahmat e tyne
grahma ime
në ato agime që nuk duen me u çue
e prap çohën të kobshme !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

" COGITO ERGO SUM "

(Decartes)

Katër mure pa shpresë
gurë të ftohtë
të pamëshirshëm
më rrethojnë
i shtrimë
mbi betonin e ndotun
spërkatun me njolla gjaku
shenja torturash
hieroglife për t'u dëshifrue
mesazhe misterioze dëshperimi
ngjarjesh të rënqethshme
krimësh

nga tavani i ashpër
varet një llampë
e ndezun
natë e ditë
ditë e natë
(thue shpatë e Damokleut)
koha qëndron e palëvizun
ankth apo andërr?
" cogito ergo sum "
shkruente filosofi Decartes
" sum ergo cogito "
them unë
aty i pllakosun.
kujtoj rininë time të humbun
tashma jeta ime
shkruhet
në faqet e këtyne murëve
bashkë me jetën
e sa vuejtëse të tjerë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

tregime rënqethëse
a do të arrije kush vallë
të deshifrojë ato shënime
të padukshme
por aq fort të pranishme ?

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Nën thundrën e diktaturës

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Andrrat dhe realiteti

Murët më vështronin
të heshtun e të akullt
dhe unë i sodisja
ma i heshtun dhe i ftoftë
ato
prisnin me njoftë një tjetër hominid
(nga që kishin njohun të ndryshëm)
kurse unë prisja me njoftë ndonjë mur tjetër
që të kishte një frënxhi
për me shikue një cope qiell të kaltërt
për të thithë pakëz ajr të pastër

ne gjithë atë zymtësi
nuk më mbetej veçse me andrrue
(kur xhelatët me linin rëhat)
me sy hapun
apo me sy mbyllun
(andrra në diell)

mund t'endësha i lirë nëpër botë
përtej këtyne murëve të tmerrshëm
kush mund të ndalte vrullin e mendimit?
mund të fluturoja mes reve
mund të notoja në thellësitë e detit
mund të bridhja në fushat pa mbarim
në male te larta në pyjet shekullore
mund të takoja gjithe ato vajza të bukura
cilën me zgjedhë
cila do të ma pushtonte zemrën?
mund ta shifja vetën në shtepi
ja gjyshja ime e vogël

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

qe e doja aq fort
ja nana zemërbujare
ja prindi i rreptë
vllaznit e miqtë
e plot dashamirë
mund t'ulësha në bangot e shkollës
mund të lodroja me shkokët çapkenë
në sheshet dhe oborret e kolexhit
rrethue me lule jargavani
risgjohësha nga zhurma e llozave
e britmat e rojëve
pllakosësha ne realitetin e hidhun
muret me qëndronin sipër shtypës
(ç'faj kishin muret ?)
dëshiroja vdekjen
si mund të kthehësha në atë jetë përsëri
ashtu i lidhun kambë e duer me pranga
ashtu i mbyllun në atë qëli betoni
ashtu i përplasun në atë burg të zi
në mëshirë të një pushteti mior ?
o Zot, o Zot mos më braktis!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Koha në pranga

Katër faqe muri
me shikojnë ngultas prej kohësh
dhe unë i shikoj ato në heshtje
kur nuk mundem me mendue
mëni dhe urrejtje më vlojnë përbrenda
për ata njerëz që sajuen këto mure
që mö mohojne qiellin
që më mohojnë diellin
që më mohojnë yjet
që më mohojnë lirinë
që më mohojne jetën
që më mohojne dashuninë
që më mohojnë të ndjehëm njeri
midis njerëzve
(ç'faj kane këto mure
që vetë njerëzit i kanë ndërtue
për të pllakosun aty shëmbëlltyrat e tyne ?)
nje llampë qëndron e ndezun natë e ditë
kur ishte natë
kur ishte ditë
sa net e sa dit
sa muej e vite ?
mos vallö edhe koha ishte ndry
prangosë
mes atyne murëve
me fatin tim?

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Petale bajamëje

Lart një frenxhi
qielli pas një zgare të ndryshkun
poshtë
mbi çimenton e ftohtë
mjerimi
bashkë me fatin tim
mbi murin e ngurosun
skalitun
jeta ime
dhe i gervishtun emni
ndër sa emna të pa njohun
e mbase
aq të ngjashëm

një petale luleje bajame
grabitun nga era
kaloi nëpër atë prezor
si një flutur endacake
dhe erdhi e u ul
butë butë
e lodhun
mbi faqen time të rrudhosun
me një përkëdhelje të ambël
lajmetare e pranverës
ndoshta e dashunisë së harrueme
ku do t'ishte vallë vashëza ime perr
me ato flokë të zi të lëshuem pas drë
me ato sy të ndritun magjepës
me ato buzë te kuqe alli
me shtatin e bukur si selvi
me gjinin e mbushun

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

me puthjet e zjarrta ?
petalja
qendroi aty gjatë
nuk guxoja të lëviz
për mos me e humbun
deri sa u fanit
mbi lëkurën time të vrazhdë
u zhduk andrra e dashunisë
që endëj akoma pas prezorës
mbi atë qiell të coptuem
të larget
të pa ngjyrë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Ekstazë demoniake

Zhytun në zbrazëtinë e netëve të qelisë
gurët na vështrojnë lotues
(a thue për dhëmshuni ?).
qëndrojmë të harruem
mes errësinës së kobshme
ku koha shtanget e nuk lëviz
ku hapësina kufizohet me qivure
ku gjembat e telave të ndryshkun
vaditen me gjak të pafajshëm
që gufon nga toka vorr
(çdo pëllambë tokë vorr)
sa vorre ?
në shënjestrën e armëve mizore
nguliten të pamëshirshëm
sadistë
sytë e zgurdulluem të vrasësve
vrasës të mishëruem në qenie
qenie apo përbindësha
hije apo pjella të skëterrës ?
në shtegun e ngushtë të ballit tyne
rrudhat mblidhen
kërcënuese
fryhën damarët
krejt urrejtje e mëni djallëzore
të gatshëm
me shpraz armën vrastare
në çast
pa mëshirë
xhelatët
sajojnë torturat ma përcudë
dhe ia marrin valles

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

me britma e vikama e kërcëllima
nën ritmin e isove barbare
të dehun
nga kudërmimi i gjakut
të viktimave thërorë:
ekztazë demoniake !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Valle makabre

Re të zeza prej stepave të Azisë
prej Siberisë së akujve
të ngarkueme me mbrapshtina
të ngarkueme me stuhi të përgjakshme
plot kokalle të coptueme
mise të sakatueme
si nëpër guvat e skëterrës
sillen rrotull shpirtnat e mallkuem
dreqnit
të mishëruem në xhelatë
ë katilë
me valle makabre
me rite makabre
me gosti makabre
nën dritën e flakadajve
lëkunden
hijet e zeza të dëmonëve
hukubetë
të skëterrës
që pijnë e dehën
në kupat - kafka plotpërplot me gjak
në kafkat - kupa plotpërplot me lot
dehje e përbindshme!
ju
qënje të përçudme
të tundrave siberiane
xhelatë të trojëve shqiptare
kasapë të njerëzimit
vrasës katila
ç'emna meritoni ma të turpshëm
se monstra e përbindësh?

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Akte dëshpërimi

Gjatë hetuesisë, njerëzit e sigurimit zbatonin torturat ma barbare e çnjerëzore, e arrinin në mizori të tilla sa që viktimat nuk mund t'i duronin e kërkonin shpëtim në vetvrasjen. Një vajzë e një familje patriote, e vendosun e trime, që nuk mund të pranonte t'u nënshtrohej xhelatëve, zgjodhi vdekjen duke u hedhun nga dritarja e degës së brendshme ku e mbanin. Vetvrasjen për t'i shpëtue mundimeve e zgjodhën edhe të burgosun të tjerë. Disa i jepnin fund jetës me varje, ku gjenin ndonjë tel apo ndonjë rryp pantallonash. Të tjerë pritnin damarët e gjakut. Kishte nga ata që e përplasnin kokën pas murit. Dikush bante grevën e urisë e rrinte pa ngranë e pa pi deri në vdekje. Në kampet e çfarosjes të burgosunit hidheshin mbi gardhin me tela me gjemba ose merrnin vrapin duke ikun që të vriteshin nga rojet, të cilat mezi pritnin për të tregue aftësitë e tyne kriminale si vrasës profesionistë. Kishte dhe tortura speciale me doktor tek koka, i cili përcaktonte nëse viktima ishte në gjendje me durue tortura të mëtejshme. Shumë të burgosun vdiqën në tortura e sipër në dorë të xhelatëve. Për disa të burgosun të veçantë, të cilëve u afrohej afati i lirimit, përdorej metoda e aksidentit në punë. Për këtë detyrë makabre ngarkoheshin agjentë të sigurimit të futun kastile në burg për të tilla maskarallëqe të neveritshme. Vetë diktatori dhe shokët e tij të partisë me pozita të larta, shpreheshin për njerëzit që vriteshin me urdhën të tyne, sikur t'ishin 'bagëti për t'u therë te kasapi, me të vetmin ndryshim se ndërsa kasapi i konsideronte berret kafshë, xhelatët komunistë i konsideronin njerëz berre. Pra t'i hiqej jeta një njeriu të pafajshëm ishte ma lehtë se të therej një qingj apo një zog pule. Prandaj ata që përfundonin në birucat e tmerrshme të Ministrisë së Brendshme kërkonin ma parë t'i jepnin fund jetës se sa t'u nënshtroheshin atyre lloje torturash që

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

shqiptari nuk kishte pa as kishte dëgjue deri në atë kohë, kur erdhi në fuqi ajo parti komuniste që i kishte premtue popullit lugën e florinjtë ndërsa nuk mundi t'i siguronte as atë të drunit. Ka pasë raste të ralla, që njerëz të veçantë të mbajtun me vite të fshehun, që askush s'dinte per ta, të zhdukëshin në furrat e ngohjës në bodruemet e Ministrës Brendshme. Për këtë kemi dëshmi të përjetueme. Që pastaj raportohej se ishin gjykuar e pushkatuar. Më e ulta ka ndodhun që vetë ata që i kishin premtue popullit lugën prej floriri, të poshtnonin atë popull me totura të turpshme siç ishte ajo me u kue me lugë nevojën e vet, nën kërcënimin e automatikut. Kjo që përmendëm në fund, s,asht thanie e kotë, i nenshkruemi ka njohun një nga officerët qe kishte krye atë akt poshtërues diku në Veri. Ky akt i tupshëm vlen për të kuptue poshtërsinë dhe ultësinë aq fyese e të nevertishme të atyne që n'emën të partisë tyne komuniste e bolshevike, kryenin krime e akte të shëmtueme mbi vllaznit e motrat e tyne, sepse ideologjia që kishin përqafue e që zbatonin ishte krejtësisht antinjerëzore dhe antishqiptare.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Vetmi e madhe

Po më përdjek një vetmi e madhe
i mbyllun mes murëve anmiqsorë
të trishtimit
të dhimbjes
të mohimit
dielli qe aq shum shkëlqente
nuk ndrit ma
i harruem
(nje dimën i egër randon i pameshirshëm
mbi tokën e mbi trupin tim)
ka shkëlqye ndonjëherë vallë dielli ?
ka ndriçue ndonjëherë vallë hana ?
kanë vëzullue ndonjëherë vallë yjet ?
shpirti grëmiset në humnerat e absurditetit
i fyem
i trishtuem
i braktisun
bota zbehët tashma nga kujtesa
si një lamsh i rrudhosun
e felliqun
nga poshtërsitë e njerëzve
pa bukuri e ngjyrë
pa jetë
mërziia më mbërthen mendjen
humbasin njohunitë e fitueme
e gjithë qenja ime
përplaset
ndër rrjeta mërimangash
viktimë
formash përbindësh
cila dorë do te shpëtohet dhe jet mejet

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

cili krah i fuqishëm do të më ngrejë nalt
që të shikoj përsëri diellin
që të shikoj përsëri hanën
që të shikoj përsëri yjet
që të marr frymë lirshëm
nën qiellin e kaltërt
që të ndjej kundërmimin e tokës pjellore
që të thith ajrin e pastert të oqeanëve
që të vazhdoj rrugën nëpër botë
mes njerëzve
njeri ?

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Mure të ngurta

Mendimet po ndiqnin ritmin e hapave
që vinin vërdallë
nëpër qëlinë e burgut
katër
dy
katër
dy
ma tutje nuk të linin faqet e murit
trupi ishte i pa kurrfare force
por jo mendimi
që arrinte të tejshponte
ato mure të ngurta
çimenton e fuqishme
kangjellat e hekurta
telat me gjemba
t'u hikte rojëve
t'u shmangëj vigjilencës
së atyne çërberëve egërsina
s'pyeste për pranga
as për zinxhirë
fluturonte mendimi
endej
si pas qejfit
atje nën hijën e freskët të ullijve
ku vashëza ime pushonte
për t'i ikun vapës përvëluese
t'asaj dite vere
kur koka e saj u mbeshtet mbi gjoksin tim
për të ndigjue rrahjet e zemrës
kujt i duhëshin ato mure të ngurta
kujt
ato kangjella të hekurta
që mund të mbanin të burgosun trupin
por jo kurrë mendimin !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Bashkëvuejtës :
Ded Gjonij, Thabit Risi, Mitat Aranitij, Kuç, 1938

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Dantes

Dante
Dante
poet i pavdekshëm
ku ishe?
në këtë ferr tokësor
nuk u duke
me përshkrue
me ato vargje të përkryeme
atë skëterrë
që nuk mundet me përfytyrue mendje njeriu
ku njeriu kthehej n'eshtna skeletike
dh'eshtnat në pluhun
në hiç
apo nuk gjete një shoqnues të lavdishëm
një Virgjil tjetër ?
prandaj atë udhëtim nuk e ndërmore
nëpër humnerat e pafund të llahtarit
lemerinë me ndigjue
të nanave
për fëmijët që përpëliteshin
ndër kthetrat kockore të vdekjes
lemerinë
e një poplli të tanë
që zvarritej
për një kothere buke
të hedhun
siç kockë që i hidhet qenit
poetinj tonë të quenim,
që torturat e ferrit tand
aq tronditës ke përshkrue
që ngjanin me toturat
që ne pesonim

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

në një sketerrë të vërtetë
dhe jo si e jotja
fantastike
haмëndore

Dante
Dante
poet i pavdekshëm
ku ishe ?

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Bardhësi bore

E heshtun
bie bora
fjolla të bardha fluturuese
flutura të bardha
flutura mizëri
prej errësinës së hapësinave siderale
ndoshta lajmtare
botësh misterioze të largëta
ndoshta viktima
holokaustesh përbindëshe
absurde
ndoshta shpirtna
qytetnimesh njerëzore
të zhdukun
me bardhësinë e tyne të dlirtë
kërkojnë të mbulojnë
mynzyrat njerëzore
mizoritë e tiranëve t'urryem
të diktatorëve gjakatarë
perëndi toksore
shkatrrimtarë
t'etun
për lufta
për ekatomba qeniesh njerëzore
për krime monstruoze
t'etun
për gjak të pafajshmish
e heshtun bie bora
gjatë natës së kohnave
në pritje të një rilindje të re
të një epoke t'ardhme

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

kur rruzulli ynë tokësor
aq i vjetër
aq i lodhun
aq i ndotun
prej mbrapshtinave të mëdha
ndoshta do të ngjajë
si një top vigan bore
me bardhësi të papërlyeme!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Flatra të këputuna

Me velo të zeza mbështjellë
vajtojnë nanat shqiptare
bijt e tyne
të etun për liri
i këputën zinxhirët bijt e shqipës
për me u hedhë
drejt qiellit të lirisë
drejt jetës së re
në fluturime guximtare
batare të kobshme
batare të egra mortore
flatra të coptueme
ndër telat me gjëmba
të ndryshkun
prej gjakut të trimave
mbetën
trupnat pa jetë
ushqim makabër
sorrash
e korbash kërmash
realitet absurd
i një pushteti tiranik.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Thellësi katakombash

Suferima acar e maleve
e ngriu tokën e ngrohtë
bujare
të trojeve tona
njerëzit u pllakosën përdhunisht
ndër katakomba
të germueme me shpirt ndër dhambë
me thoj të përgjakun
n' errësinën e kobshme
të burgjëve vorre
thurin njerëzit vargje
me fillin e mendimit
radhisin libra
me rrahjet e zemrës
endin vepra
me vegime të përfrikshme
me skena makabre
me ngjarje të trishta
gjak pikon nga çdo germë
lot rrjedh nga çdo fjalë
suferima acar
shfryen pa meshirë
duke mbështjellë
me një qefin të akullt
dheun mbar
atje thellë
në katakombat virtuale
të qëndresës
një dritë rrin gjithmonë e ndezun
ajo flakëz e shpirtit
që nuk mund të shuhet kurrë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Monolog hamletian

Qendroj i pa shpresë
në vorbullën e vetmisë
kam humbun në natën e zezë
në errësinën e dëshpërimit
e ndiej zhurmën e heshtjës
të gjithpushtetshme
e ndiej
asgjësinë
hiçin
ku s'duhet të ekzistojë send tjetër
megjithatë diçka lëvrin
frika
po frika !
frikë me qënë
frike mos me qënë
frike me jetue
frike mos me jetue
frike me vdekë
frike mos me vdekë
si me zgjedhe
me qënë apo mos me qënë
me jetue apo mos me jetue
me vdekë apo mos me vdeke ?
jji gja asht e sigurt
si deshe si nuk deshe
dilema hamletiane
e ka zgjidhjen
së cilës
s'i ikën dot.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Labirintë

Ne tunelet e mendimit
të pllakosun
rrijmë
të strukun
të ndrydhun
të vetmuem
të braktisun
atje ku nuk arrin
të na pikase kush
ndër labirintët e mendimit
ku ligësia s'guxon të dëpertojë
ktakomba
labirintë të ndërlikuem
gërrye
me durimin e një murgu
me duer e me thoj
me forcën e shpirtit
me dhimbje në zemër
me vullnet të farkëtuem
gjatë vjetëve të qëndresës
me forcën e pashterrshme
të herojve të mëndimit
me shpresën e pashueshme
të shpëtimit
të lirisë
prangat u hodhën tutje
të coptueme
një pëllumb i bardhë
vërsulet drejt qiellit
një diell i përflakët
rrezaton
ngrohtësinë e dashurisë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

dalim nga shpellat e skëterrës
nga vorret e qivurët e robnisë
të topitun nga shkëlqimi i jetës
haru
të çoroditun
nuk besojmë
zymtësia e katakombave
labirintët e pëçudun
morën fund vallë
fund ?

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Dimën i madh

Fjollat e borës mbulojnë gjithçka
shpirtna të pafajshëm që rikthehën ?
flutura të bardha që flijohën ?
sufërima e akullt vërshon e terbueme
sufërima e një ideologjie barbare.
kallkan toka
kallkan qielli
kallkan deti
kallkan zemrat e njerëzve
trupi
shpirti
mendja e njerëzve
dimën i madh !
nje shkrimtar
nje oborrtar i tiranëve
thonë se shkruejti një libër
nje roman thonë
ku dimni ishte kthye në pranverë
ku bora ishte kthye në lule
ku ngrica ishte kthye në blerim
ku të vdekmit buzëqeshnin
ku të pushkatuemit gajasëshin
ku viktimat dashunohëshin me xhelatet
ku ujqit lodronin me qingjat
ku diktatori shëmbëllente me perëndinë
me fjalë
(mbasi e kish rrexue nga frori).
dimën i madh
kthye në lumturi pranverore
(mbrenda në serrë).
përjashta
ku acari ishte i gjithpushtetshëm.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

ku engjujt kishin ngri kallkan
ku edhe shejtnit kishin ngri kallkan
ku perendia vetë kishte ngri kallkan
ku dhe njerezit kallkan kishin ngri
shfryente grahma renqethese e vdekjes
nëpërmjet tytave vrasëse të armëve
bresheria e zjarrte
kethehej ne ngrice mortore
dimën i madh !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

MANE TEKEL FARES "
(Danieli, libri V)

Terr
në këtë ditë pa diell
terr
në këtë tokë pa fè
të braktisun
përplasemi
në vorbullën e stuhive përverse
me shpirt
me mendje
me trup
të lodhun
të dermuem.
pulëbardha
në mëshire të shtërngatave
zogj
në mëshirë të tufanëveë.
një flakë e pashueshme shprese
përgjon në thellësi të trunit
në pritje të mrekullisë hyjnore
dhe mrekullia e madhe ndodh
brenda një nate ftale
ne murin e historisë
u shfaq shkrimi
" Mane Tekel Fares“
u shembën idhujt gjakatarë
miliona pishtarë
miliona qirij të flakëzuem
vershojnë si lumej të zjarrtë
me një ndriçim ngadhnjimtar
shëndritës ma tepër se çdo ylli
se çdo diell
u zhdukën simbolet absurde

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

lavdia e Zotit triumfon
me mirësinë
me dashuninë
me vllaznimin midis njerëzve
rilind
një botë e
e lire !

Mane Tekel Fares, këto fjalë hebraishte u duken në murin ku bante gosti mbreti Baladasar i Babilonisë, që kishin kuptimin, « në këtë natë perandoria jopte del fare ». Çuditnisht fjalët përkojn me shqipën, Mana ti ke me dale fare.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Pas zgarës së hekurt

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Pesha e kryqit

Të vdekmit nuk harrohen kurrë
as nuk mund të braktisen
zemra mbetet me ta gjithmonë
vetë toka
e ruen dhembshuninë në gjinin e saj
mbi eshtnat e tyne
bie drita e yjeve të largët
ndriçime luhatëse
reflekse të përfrikshme
trondisin
shpirtin tim t'arratisun
ndër vise të panjohuna
era shpërndan farna të reja
vorrezat e harrueme
vaditen prej vesës mëngjesore
mbin bari i njomë
ndihet aroma e luleve
e gjithë qenia ime
ndien ardhjen e pranverës
vijnë kujtimet nëpër errësinën e kohës
të ruejtuna në thellësinë e puseve gurore
si një jehonë tingujsh mortorë
si trashëgim vuejtjesh të pafund
nën peshën e kryqit
si një dëshmi
e një kalvari shumë kohëgjatë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Çmimi i dhunës

Mos shisni mend ju
që zbatuet tarturat mizore
me pranga
hekur e zjarr
me breshëri armësh
me gazep duke ua marrë shpirtin
qënieve të pafajshme njerëzore
ndër të tmerrshme mundime
dhe i quenit vllazën e motra
s'mund të çpiknit një botë të re
as një njeri të ri
të shndërruem në përbindësha
të pangapun për pushtet
për gjak!
të kapun pas fronit si Makbethi
vrisnit gjumin
e bashkë me gjumin
pafajësinë!
dënuet vetveten përjetësisht
ndër kthetrat e Luciferit gllabërues
atje në fund të ferit dantesk
ky
për ju
çmimi i dhunës!

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Lamtumirë e fundit

Jehonte akoma zani im
me tingujt e pafajësisë ndërsa zhytësha
në humnerën e kohës
dhe ndjeja
dhimbjen e pashmangshme
të lumturisë së humbun
trupi yt përpëlitej
i veshun me bukuri hyjnore
krahët shtri drejt qiellit të vrejtun
në lutje të heshtun
e ndjeja rrënqethjen
gjaku gufonte ndër damarët
kangët e dikurshme
humbisnin në labirintet e heshtjes
si një lamtumirë e fundit
ndaj dashunisë
një murmuritje vargjesh
në buzët e zhurituna
n'atë shkretinë të zymtë të mohimit
ndërsa dielli i lodhun
ia lëshonte vendin
natës së amshueme.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Zjarr'i fikun

Jehojnë
prej hapësinave të pafundme
të së kaluemes
melodi të harrueme
kujtime
të një kohe të lumtun
flakërime
të një zjarri
tashma të fikun
që kërkon të shkundet
prej letargut të fundit
për të gjallnue vetminë e madhe
para përqafimit të mynzyrtë
t'errësinës!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Endacak

Mërgimtar e ndjej veten
endacak nëpër rrugët e botës
hijet e qyteteve të hueja
mbushin hapësinën jetësore
dhe hapësina vetë
peshon mbi qenien time
e randë
e panjohun
dashunia
mbetun e prangosun
nuk mundet t'i ndigjojë ma
kangët që për të u thurën
në këto çaste vetmie
kur parajsa e skëterra
qëndrojnë
mes vorreve të të vdekunve
ndonëse i groposun për së gjalli
orvatem me këndue
kangën e fundit të mjellmës
orvatem të shtyj gurët
që më mbulojnë
me forcën e rrajëve të lisave
nga thellësia e tokës.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Hiç

Shkruej
në përpjekjen e kotë
për të qenë akoma i pranishëm
(dëshirë e brishtë)
në faqen e një libri
ndër vargjet e një poezie
ndër rreshtat e një tregimi
miset tashma të përdarun
në pamatësinë e hiçit
hiç!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Pesha e vjetëve

Të lodhun
shkelin hapat e mija
mbi gjethët e rrëzueme
të vjeshtës
të pamëshirshëm hapat e kohës
mbi kujtimet e përdjerra
e randë
mbi supët e dërmuem
të përkulun
të vjetruem
pesha mizore e dhunës
mbi flokët e përthijun
pesha e vjetëve.
një lule u duk
mes gjethëve të fishkuna
jetë !
një mendim u duk
në mendjen e çoroditun
shpresë !
nje copë bregore shpëtimtare
për naufragun e raskapitun
mes furisë së shtërngatës !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Amnëzi

Kaluen gjithë ato pranvera
dhe nuk pashë një lule
nuk dallova kurrë
blerim
drizat e telave metalike
qendronin të thata
kërcënuese
s' mund të çelnin lule
s' mund të çelnin gjethe
s'mund të lidhnin pemë
ndonse vaditëshin
me gjak të kulluet viktimash
të pafajshme
mbetnin gjithmonë
të ndryshkun
të përdredhun
të kobshëm.
a ndriçonte kund dielli vallë
a ndriste netëve hana vallë
yjet a vëzullonin
n'hapsinën kozmike ?
a binte shi
a binte borë
a fryente erë ?
hedh vështrimin nga e kaluemja
e nuk dalloj asgja
s'kujtoj asgja
mjegull
errësinë
zbrazëtinë
ankth e brengë
trishtim
amnëzi e llahtarshme

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Humnerë sketërrore

Kujtimet vijnë të papërnbajtun
në andrrat e shoh veten përsëri
në atë humnerë sketërrore
prej kah
zor të dilte kush i gjallë
vitet e bukura të rinisë
mbetën pa u jetue
humbën e u fundosën
në zbrazëtinën e asaj kohë absurde.
si lule të sapo çeluna
u perfshimë nga kosa e pamëshirshme
e ndryshkun
prej gjithë atij gjaku të pafajshëm
prej gjithë atyne lot dëshpërimi
prej gjithë asaj djerse mundimesh
dashunia
si një rreze vetmitare dielli
mes reve të zeza
që mbulonin qiellin e braktisun
nga kaltërsia
ndriti për një çast
një çast bukurie
një çast buzëqeshje
një çast shprese
në atë lemeri vajtimesh
kanga e fundit e mbjellmes
kumboj madherisht
mes telave me gjemba
çeli nje trëndafil i bardhe
një rreze drite
një buzeqeshje
një kangë
nje trëndafil
vëgime të një jete të humbun
në humnerën sketërrore !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Mesazhi i shpresës

Dashunia shkëlqeu mes skëterrës
porsi rreze e artë diellore
mes reve të zeza të stuhisë
porsi një gonxhe trëndafili
mes gjëmbave të ferrave
porsi një pëllumbeshë e bardhë
në kupën e qiellit të errësuem.
dhe unë e grabita atë rreze drite
e në shkimin tim rinor
në zemër
e ruejta
që të më ndriçonte
shtigjet e asaj nate të gjatë
të kobshme
dhe unë e këputa atë trëndafil të bukur
me lotët e dëshpërimit e vadita
që të hijëshonte zymtesinë e burgut
dhe unë e thirra pëllumbeshën e bardhë
që fluturimthi
në duert e mija erdhi
për të më sjellë
mesazhin e shpresës !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Një trashëgim i trishtë

Një vit ma përpara isha i ma i ri
e një vit tjetër
akoma dhe ma i ri
shtatëdhjetëvjet kalue
krejt një fëmijë !
ç'mbeti nga ajo kohë e trishtë
të një gjysmë shekulli mizor
që aq randë peshoi
mbi shpatullat e tua
i pamëshirshëm ?
cilat dhunat e mbrapështitë
që t'i paskëshin sajue
cilat fajet e pakryeme kurrë
cilat akuzat absurde
Të kurdisuna
që të gjykuen fajtorë
dhe e denuen
pafajsine ?
nje vit ma përpara ishe ma i ri
e nje vit tjetër
akoma dhe ma i ri
shtatëdhjetëvjet kalue
krejt një femi
ç'ka mbeti nga ajo rreze dielli
që një çast vëzulloi
dhe u zhduk
nën errësinën e qiellit të vrejtun
nën rrëbeshët e fatit të tërbuem
nën bataret e armëve xhelate
të asaj epoke barbare ?
një skëlet kockash të dërmuemë
një lamsh mendimesh të zymta
mallëngjimi i dashunisë së shueme
dëshpërimi për shokët që humbën
hidherimi për t'afërmit që u zhdukën
asgjësimi i andrrave rinore
një trashëgim i trishtë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Persekutimi

Persekutimi e terrori kishin arritun atë shkallë zbatimi kundrejt popullit, sa që në kulmin e dëshpërimit ky e ndjente veten të katandisun në skllav, kafshë apo vegël pune. Me mprehtësinë e tij ai mundohej të gjente përkufizimin më të përshtatshëm për të paraqitë gjendjen e mjerë që po përjetonte e për të vulosë sa ma vërtetësisht atë sistem dhe atë ideologji absurde që i ishin imponue vendit dhe njerëzve, nën udhëheqjen e një diktatori, fodull, sadist e paranoiak. Kështu populli nxorri këtë thanie kuptimplote: "Sipas Darwinit, janë dashun miliona vjet që majmuni të shëndrrohej në njeri, kurse shokut Enver Hoxha i mjaftuen vetëm 45 vjet për ta shndërrue njeriun në majmun!" Kjo thanie përmblidhte gjithë tragjedinë që po përjetonte dhe pësonte populli shqiptar mbi kurrizin e vet. Mija e mija viktima të pafajshme u përfshinë në një terror e persekutim mizor e barbar, që mohonte e shkelte me kambë të drejtat ma elementare të njeriut, në një kohë kur këto ishin shpallun botnisht si parime të shejta nga Organizata e Kombeve të Bashkueme në Konventën e Gjenevës, për t'u respektue prej qeverive të të gjithë shteteve të botës. Por pushteti komunist në Shqipni nuk donte të ia dinte as të merrte vesh për të tilla parime, sepse kishte si qëllim prioritar, mbajtjen e vendit nën një diktaturë të hekurt e kriminale, nën drejtimin e një diktatori xhelat e të pa skrupuj, që e konsideronte jetën e njeriut ma të pavlefshme se të një fije bari. Prandaj u izolue nga bota, për të mos lejue askënd, as me hy as me dalë, që të mos merrej vesh se ç'po ngjiste brenda atij vendi që lulëzonte me burgje, kampe pune e kampe interrimi, e ishte mbushe me vorret e të pushkatuemve e të vdekënve prej mundimeve e torturave. Kjo gjendje vazhdoi edhe pas përfundimit të ciklit jetësor të diktatorit, nën kujdesin e pasaardhësve partiakë të nxitun nga vejusha e zezë, e mbiquajtun me plot

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

të drejtë nga një gazetar i huej "Lady Makbeth", bashkëpuntore e ngushtë e burrit diktator në kryemjen e krimeve. Zoja në fjalë, si grue, kërkonte të dilte e pastër dhe e lamë nga gjithë ai gjak i pafajshëm që u derdh duke dashtë të mbajtë pushtetin në dorë me çdo kusht (metodë leninistestaliniste). Kushti ma i kollajshëm ishte krimi dhe metoda ma e mirë, terrori. Nanat e foshnjëve që vdiqën në Tepelenë e në kampe të tjera, i drejtojnë gishtat akuzues drejt asaj femne mizore, vetë nanë, që e mishërueme në një grue katile, la pa femijë qindra nana të mjera, pa i luejt fare qerpiku! Ato nana kërkojnë shpagim ! Si mund t'i shmangët Zonja e zezë kësaj akuzë të ligjëshme? Mund t'i shmangët gjyqëve qesharake njerezore por jo kurrë gjyqit të Perëndisë.
!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Podiumi i lavdisë

Profesorët
i mbyllën në tru leksionët
për të hapun katedra të reja
n'errësinën e qëlive
në kthinat e burgjëve
në barakat e kampëve
ku përkulën kokën
mbyllën sytë
në referatin e fundit të tyne
shkrimtarët
ruejtën ndër rrudhat e trunit
e në faqet e kujtesës
romane e poemë të panjohun
të shkruem me fillin e mendimit
me gjakun e plagëve
me lotët e dëshpërimit
me djersën e mundimëve
të pllakosun në burgjet vorre
në heshtjën e frikshme.
ndërsa disa të tjerë
të ngritun në podiumin e lavdisë
të pamerituesshme
hijërandë e me syza të zeza
(ndoshta dhe pa to)
me stilografë pelikanë
e pirgje letrash
shkruenin vepra
neveritëse
për lavdine e xhelatëve
dhe të tynën
të krekosun
mbi eshtnat e kolegëve
të masakruem
mizorisht!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Të mashtruemve

Kush ju mësoi
që simbol të keni kosën
atë vegël mortore
që nuk len një fije bari
të thate apo të njomë
mbi toke ?
kush ju mësoi
që të lani me gjak të pafajshëm
herojsh e martirësh
brigjet e lumejve
dhe të shperndani eshtnat e shejta
të burrave të Shqipnisë
lumejve dhe prroskave
liqejve e detnave
fushave e malëve
si shperndan murlani i terbuem
gjethet e lisave ?

një Jago ishte ai
që shpifjet kishte ajam
e kurdiste e thurte
intriga
ëngjëllin e shpallte djall
e djallin ëngjëll
e ne veshin tuej shprazi
këshilla rënqethëse
të kobshme
anmik ishte ai
përmbi çdo anmik
i urryem !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Rëperte arkeologjike

U shuen andrrat e shpresat rinore
një dimën i madh
acar
qëndron mbi fronin e akullt të urrejtjës
fryen një murlan i egër
me rrënkime vajtuese
nëpër degët e braktisuna
gjethët kanë marrë dhenë
të shpërdame
shtresa shtresa
si dëshirat tona
nën rrëbeshët e shtërgatava
të ideologjive të çthuruna
degët e thata të lisave
shtrihën drejt qiellit lutëse
me dëshpërim e dhimbje
për gjëlberimin e humbun.
kah t'i shtrijmë krahët
kur krahët na i gjymtojnë
kah t'i drejtojmë ankimet ?
kur fjalën na e mohojnë
kah ta drejtojmë shikimin ?
kur sytë na i vërbojnë
kah ta hedhim hapin ?
kur kambët na i shkurtojnë ?
në statuje të thyeme
u shëndrruen qënjet tona
kush do të vijë t'i zbulojë
këto rëperte arkeologjike
e t'i bashkojë
e t'i ngjisë
e t'i drejtojë e t'i endosë
mbi pjedsital

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

në një mueum ?
ndoshta dikush do të ndalet soditës
para të tilla veprash antike
të ngurta
duke vështrue pyetës
a do të kenë pasë zemër
a do të kenë pasë gjak
damarë
a do të kenë pasë
tru
mendje
shikim e fjale ?
po pse kështu u katandisëm vallë
në rrëperte të braktisun arkeologjike ?

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Braktisje

I ndrydhun në vetvete
kruspull i mbledhun
në mendimet e mija
në kujtimet e mija
në mjerimet e mija
i përdjerrun
në shkretinën e mospërfilljes
lëshoj një za të çjerrun
ulurimën e dëshpërimit
britmën e dhimbjes
kushtrimin e pa shpresë
më përgjigjet një heshtje varri
asnjë jehonë nuk ma rikthen thirrjen
"vox clamantis in deserto"
i shtrimë mbi truellin e ngurtë
pres të jap shpirt
të lëshoj grahmën e fundit
e pra
mbi këtë tokë gumëzhijnë
miliarda qenie njerëzore
pse kaq vetmi e madhe
kaq braktisje?

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Mendime të trishta

Në mëshirë
të mendimëve të mija të trishta
shkoj duke kërkue
ndonjë breg mikpritës
dhe përfundoj
gjithonë
në të njejtin port anmik !
te kuqe dallgët
e kuqe toka
i kuq qielli
gjak !
prej plagëve të plumbave të vrasëve
prej plagëve të prangave mizore
prej plagëve të telave me gjëmba
prej plagëve të torturave barbare
prej plageve të zemrave të lëndueme
prej plageve të fëmijëve të flijuem
prej plageve të nanëzezava kërcuna
prej plageve të luftëtarve trima
prej plageve të zemrave të dërmueme
prej plagëve të Krishtave të kryqëzuem.
nisëm përsëri
në mëshirë të mendimëve të trishta
për të mos u kthye ma kurrë
ne ato brigje
mospritës
për fat të keq
rikthehëm
po aty !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Kanga e fundit e mjellmës

Mendime t'errta më përmbytin
mendjen
e shoh veten
në ato katakomba
ku koha mbetet e mbërthyeme
bashkë me shpresat
e dëshirat rinore
vitet ma të bukura
humbën ndër labirintet
e absurditetit
që sundonte i pamëshirshëm
mbi tokën e shkretueme
që sundonte i dhunshëm
mbi pafajsinë
kosa mizore e përlyeme me gjak
me lot
me djersë skllavnie
zbavitej të korrte lulet e porsa çeluna
dhe linte paprekun gëmushët e ferrave
dashunia kënaqej me një buzëqeshje
që shkëlqente e çastit
si rreze dielli vetmitare
ndër të çarat e reve stuhijore
një fije shpresë
në mendjen e përdjerrë
një mjellme e bardhë
fluturoi mbi qiellin e errësuem
n'atë humnerë të lemërishme
plot vajtime
kanga e fundit e mjellmës
kumboi e madhërishme
mes telave me gjemba të ndryshkun

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

çeli një gonxhe trëndafili
shkëlqimi i petaleve të bardha
ndriti terrin e guvave nëntokësore
një buzëqeshje
një rreze dielli
një gonxhe trëndafili
kanga e fundit e mjellmës
ky
trashëgimi
i katakombave kohore!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Tinguj këmbanash


Prej kohës ogurzeze e të mbrapshtë
prej asaj hapsine dyzetepesëvjeçare
dyzetepesë vite
të një heshtje vorri
ringjallet shpirti im
ndër duert me kallo
plagë
shtrëngoj
e njom me lot
kryqin fitimtar
kryqin e fitorës së madhe
të njerëzimit
yjet e kuq të përgjakun
drapijt e përgjakun
çëkanet e përgjakun
të flakun
të rrexuem
të coptuem
shkelën prej turmave njerëzore
prej vërshimit të papërmbajtun
të popujve
milona pishtarë
miliona zemra
miliona shpirtna
se bashku
njëzani
i brohorasin lirisë
tundin këmbanat e lirisë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Rilindje

E randë pesha e kohës
mbi shpatullat e mija
të kërrusuna
mbi flokët e mij
të zbardhun
i raskapitun trupi
por
jo shpirti
jo idealet
të ruejtun
të strehuem
thellë
nëpër shtigjet e mendjës
nëpër labirintët e vetëdijës
e gjatë pritja
të gjata mundimet
në kthetrat e kohës së palëvizshme
në kthetrat e hapsinës së pakalueshme
kur orët dukëshin vite
kur ditët dukëhin shekuj
sundonte terrori
sadizmi
ateizmi
përgjonte gjithmonë shpresa
dhe e patundun
bindja
erdhi dita e lirise !
prej thellësisë së shpirtit
prej thellësisë se mendimëve
rikthehën idealet dëshirat .
Rilindje !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Monumeti i shekullu XX

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Një agimin e ri

N'errësinën e hapësinës
së kohës që ikën
humbet
zhdukët
në hiç
perandoria e gjakut
pushteti i së keqës
len prapa
gjurmën e tij të randë
brazdën macabre
të krimëve
kasapane përbindëshe
mbi të pafajshmit
të panumërt
vorret e zhdukun
zemrart e lëndueme
shpirtnnat e trazuem
pishtarë të ndezun
ngrihën të përflakun
në diellin që po lind
flakadaj të zjarrtë
kryqe triumfues
zhdukën
hijet e tmerrit
ideologjitë absurde
shkrihet
akulli
që mbërthente
kallkan
njerëzimin
nga grohtësia
e dashunisë universale
kryqi i pavdekshëm !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Triumfi i madh

Terr
në këtë ditë pa diell
terr
në këtë natë pa hanë
terr
në këtë tokë pa fè
shpirtnat tanë
mendjet
trupnat e sfilitun
të lodhun
humbasin
në vorbullën e stuhive
pulëbardha
në mëshirë të shtërgatave
zogj në mëshirë të ernave
një dritëz shpresë
e vogël
në thellësi të shpirtit
të trazuem
ruen
në pritje të një mrekullie
dhe prekullia ndodh
të panumërt
vërshojnë
pishtarët e ndezun
ndriçues
në një dritë lavdie
shkelqimtare
më shumë se çdo diell

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

drapnit
çekanët
yjet e përgjakun
simbolët absurde të së keqës
diktatirat ç'njerëzore
zhdukën
në humnerat skëterrore
në hiç
triumfon lavdia e Zotit
në botën e re që rilind
në Besimin
në Dashurinë
në Lirinë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Monumenti i shekullit XX

Trishtim
në shpirtin tim
në mendje
në zemër
në tëzeza veshun
kërkon
Nana Shqipni
bijt e a saj
eshtnat
vorret
tëzhdukun në hiç
kërkon
në male e pyje
në proska e lumej
në gremina shkambore
sa shtresa gjethesh
sa dhè
sa borë
sa ranishte
sa ujë
sa kohë
sa hapësinë
mbi eshtnat e shejta
në kujtim të e tyne
një monument i madh
një kryq
një kryq madhështor
të ngrihët
i përjeshëm !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

duer nanash
duer nusesh
:motrahs
fëmijësh
duer dhimshuriie
duer plagë
t'rudhosme
me kallo
vendosin lule
ndezin qirij
sa shumë qirij flakërues
në Monumentin
e shekullit njëzet
në Monumentin e madh
të Lirisë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Koment nga një Anonim … « Are »

Poezite e Lek Pervizit hyjne ne radhen e veprave epokale te karakterit epiko-tragjik, ne kuptimin se ne ato poezi reflektohet gjithe drama e nje populli i detyruar te rrije nen zgjedhen e rande te nje nga diktaturat me t'egra t'Evropes komuniste. Ne qofte se Dante Alighieri shkrojti per një Ferr fantastik, Lek Pervizi, na jep vjershat e nje Ferri real tokesor qe perjetoi populli shqiptar gjate nje gjysme shekulli. Na vjen keq qe vepra e tij te mos jete evidencuar e vleresuar ne lartesinë e duhur ne Shqiperi, ku poeti hyn patjeter ne figurat me te nderuara te letersise shqiptare, por dhe ne vende te tjera, ku vepra e tij qarkullon ne gjuhe te ndryshme. Aq me teper se ai na ka lene nje sere vizatimesh tronditese te kampit famekeq te Tepelenes qe reflektojne edhe ne poezite e tij, po aq trinditese. Mendojme qe eshte mire qe te lartësojme të tilla figura qe bashke me talentin e frymezuar te tyre, perciellin edhe nje patriotizem te kulluar te demostruar me vepra dinjitoze letrare e artistike. Se fundi, vepra poetike e Lek Pervizit « Gjurmë te Humbura » , që korespondon ne botimet frengjisht « Complainte de Nymphes dhe italisht « Il Grande Lamento », jo vetëm se eshte nje veper monumentale, por edhe universale, qe asnje poet tjeter i vendeve komuniste as i kampeve te nazismit nuk ka arritur te krijoje ne ato kushte dramatike denimesh. Universale sepse aty jepet me vargje tronditese gjithe pathosi tragjik që perfshiu popuj te tere ku sunduan diktaturat. Vepra e Lek Pervizit jo vetem qe meriton çmime, por edhe botime ne shkalle boterore qe popujt ta njohin e ta kuptojne mire se sa kriminele dhe antinjerezore kane qene ato diktatura që përfshine boten ne shekullin 20, dhe qe po orvaten ta perfshijne edhe sot e kesaj dite para indiferences absurde te demokracive perendimore. Ne keto kushte, Lek Pervizi, jo vetem se eshte nje kundershtar i vendosur ndaj çdo diktature, por edhe nje disisdent i madh, sepse poezite e tij u krijuan ne kushte denimesh e vuajtjesh nder burgjet e kampet të një sistemi totalitar.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Vëllimi i dytë

Fragmente poetike

1990-2010

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Largësi

Larg trojëve amtare
si një zog i vetmuem
ndrydhem në mendimet e mia
shpend i përdjerrun
q'andrron për çerdhen ku lindi
k prindët e rritën
ku fuquzoi flatyrat
fluturime të lira me qëndisë
mbi kaltërsinë e qiellit
të Shqipërisë.

Erdh një dimën i ftoftë
një dimën i madh
fryni sufërilme e egër acar
shpërthyen të furishme
stuhi shkatërrimtare
u zbe krej fytyra e diellit
drita u shue
u nisën zogjt shtegtarë
për në dhe të huej
larg
atje ku tjetër diell shëndrit
një diell që s'të ngrof kurrë
ku mendja përdaret
ku shpirti shuhët
ku gjaku bahët uje

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

ku buka dukët gur.

Braktisëm trojët e stërgjyshëve
në shtegtime të pa fund
pa shpresë
ndoshta për fare.

Veç kujtimi i atdheut të shtrejtë
në thellësi të zemrës
s'do të vdesë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Mall i pashuem

Vitet shkojnë
rrjedh lumi i jetës njerëzore
i papërmbajtun
kurdoherë.

Mes tallazëve oqeanikë
përplaset anija jonë e përdjerrë
pa timon
pa vela
pa drejtim
në mëshirëtë dallgëve armiqsore
që përmbytën rruzullin mbar
e përmbytën
truelin e shejt amtar.

Vitet shkojnë
malli mbetët i pashuem
rranjosun thellë
në shpirtin krenar
që s'jepet kurrë.

Kudo që përplasën
kudo që shkapetën
trupi i dërmuem
mendja e çoroditun
dashunia për atdhe

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

nuk shuhët
risgjhohët
shpresa ripërtëritet
ndizet zjarri i fikun përsëri
një Promete i ri do të ngrihët
flakën me risjellë të lirisë
andrra e çdo shqiptari
dëshira e Shqipërisë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Jehonë shekujsh

Më përkëdhel flladi i lehtë
i hapësinës së trojëve të lashta
të ditëve plot rrezatime djellore
të netëve plot hije të qeta
kur në pafundësinë e kupës së qiellit
vëzullojnë yjet e zjarrt.

Humbas
në madhështinë tande tokë bujare
plot male të nalta
pyje shekullore
plot fusha të bëgatshme
ara pjellore
lumej t'argjendë
burime kristallore
që ku!ndërmojnë gjallëri e jetë.

Ndër kullat e ndërtueme me shkamb e gurë
jehojnë rapsoditë të stërgjyshve,
ndrit buzëqeshja e fëmive
në djepat që krijuen kohnat
në djepat që përkundën breza kreshnikësh
në djepat që përkundën heroj e fatosa
të gdhendu nga duert e mjshtrave arbnorë
qysh në agimet e para të njerëzimit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Vargje t'ashpra

Vargjet e mia s'janë të zakonshëm
s'janë vargje që i kushtohën dashunisë
që i thurin himne bukurisë
belhollave lozonjare
jetës plot dëfrime
artgëtimve
qejfëve !

S'janë v argje që përshkruejnë
agime e perëndime
pejzazhe të bukur
që flasji për dierllin hanën e yjet
për flutuirime në qiellin e kaltërt
për shëtitje mes pyjëve shekullore
mes barit e lulëve të lëndinave
mbi malet e nalta shkambore
nuk ndalen të pushojnë
në freskinë e mrizëve
ku rrjedhin të kjarta
burimët kristalore.

Ato shpërthejnë si vrulli i stuhive
si tufanët skatërruese të shkretinave
si ernat që brejnë shkrepat e malëve
si tallazët gjëmuese të detit
si tërbimi i dallgëve të oqeanëve

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

si shkulmet përmbytëse të lumejve
si lava përveluese e vullkanëve
që djeg shkrumon e zhurit
me zjarr të përflakme.
T'ashpra janë poezitë e mia
të renqethëshme !

E tille ishte jeta ime
ku shpirti u kalit me tmerre
e trupi u gremis në humnerat skëterrore
njohu mizoritë
ndërsa i pafuqishëm
përjetonte skllavërimin e n jë populli
martirizimin e pafajsisë
ndër mija mundilme e tortura
ndër mija poshtërsi e mashtrime
ku vlera njeriut
(njeriou kapitali ma i çmuar)
ishte ma e pakët se një fije bari
të njeriut të katandisun në skllav
bujjk-rob
kafshë
vegël pune!

Patjetë se cvargjet e mia janë t'ashpra !
sepse aspërsisht stigmatizojnë të keqën
sepse aspërsisht dënoncojnë krimin
sepse aspërsisht demaskojnë xhelatët
për t'i nxierr para gjyqit të historisë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

lLogari të japin
për mizoritë e tyne gjakatare
e pamëshirshme t'i gjykojë drejtësia
të zbatojë me vendosmëri
forcën e saj ndëshkuese
Ndaj krimëve të llahtarshëm.

Koha ka me kalue
do të rrokullisën vite
ndoshta shekuj
pluhuni i harresës
do të mbulojë gjithçka
por
nën vrullin e papërmbajtun të stuhive
nën hovine e pandalshëm të ernave
nën tërbimin përmbytës të tallazëve
nën rrjedhën)përveluese të llavës
nën shpërthimin e fuqive të natyrës
që përmbajnë vargjet e mia
pluhuni i harresës do të shpërndfahët
si gjehte që përlanë murlani
kur shfryn sufërima dimnore!

E vërteta do të dalë e fuqishme
për të vulos në faqet e historisë
marrëzinë shkatërrimtare të tiranëve
sadizmin gjakatar të diktatorëve
terrorin e llahtarin e lë emëristshëm
që ushtruen mbi popujt
për t'i dënue ata

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

për krimet rënqethëse
për krimet kundër njerëzimit
për t'i damkosun
me vulën e pashlyeshme të turpit
për t'i nxierrë
jashtë historisë së qytetnimit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Mos me harrue

Herojve
do t'u këndojmë
herojve
të pushkës
të penës
të idealit kombëtar
shqiptarizmit
atyre që shpalosën
flamurin e lirisë
guximtarë
kurdoherë.

Martirëve
do t'u këndojmë
atyne
që gjakun e kuq
flamur
derdhën
të pafajsisë
theror kur shpata mizore
e diktaturës
biçnte
mbi ta
epamëshirshme.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

vrastare.
Pafajsisë
do t'i këndojmë
që u nëpërkamb
u prangos
u dhunue
u vra
ndër qeli
burgje
kampe
me tela ma gjëmba
rrethue.

Ua përciellim
breznive
këto kangë të dhimbshme
shpresë rilindëse
për mos me harrue!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Absurditet

Netëve
veshtroj qiellin
plot yje
me dëshirë
Shpresë
mos shof
ndonjë ufo paqësor
që të zbresë
e ta ndryshojë këtë botë
aq të mbrapshtë
aq përverse
të dëgjenerueme
që ka humbë
nocionin e Zotit
ku njeriu
kërkon të ngrihet
vetë
mbi krijuesin e tij hyjnor
për ta shpallë vetën
Zot
Idhull
mbi tokë
absurditeti s'ka kufi
e mjera njerëzi !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Abstrakcion

Koha
kjo kohë
humnerë abstrakte
që na përpin
pa pushim
në vorbullën e saj të padukshme
të pa kotntrollueshme
prej miliarda shekujsh
jetësh
ditësh
çastësh.
Ekziston
apo nuk ekziston
ky dimension i kohës ?

Ndoshta
vetëm një shpikje
e mendjës së njeriut
fantazi
jo reale
abnstrakte
absurde
për me mat kohën
jetësoret e tij

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

por kurrë
universin.
Koha
asht vetë universi
pushteti suprem
i pamatshëm
i padukshëm
i pamëshirshëm
gjithësia
hiçi
e pranishme
vetëm në mendjën tonë.
I shkreti njerëzim
që shtrydh trunin
për me mat kohën
pse ?
a thue me numrue ditët
orët
çastet
deri në grahmën e fundit
të jetës toksore ?
apo ndoshta
kujton se do të jetë
pjesë e kohës
si ajo
abstrakte
e padukshme
pjesë
e hapsinës univesale ?
kënaqësi e kotë
koha s'na përfill fare !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Shiu i natës

Natë
shiu bie në heshtje
mbi pemët
mbi lulet
parfumi i qiellit
zbret në tokë
pjelloria e jetës
ringjallet me lindjen e ditës
nën rrezet jetëpruese
të diellit
në qetësinë e natës
një psherëtime rinore
ngrihet nga shpirti im
kujtime të së kaluemes
rikthehen
ndjej parfumin e fushave
jehonen e zanave të dashun
gjaku lëviz në damarët
i vrullshëm
si ujnat
në gjinin e tokës
e njomun
nga shiu i natës.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Kronofilosofia

Drejt kufinit të fundit
cakut të fundit
të jetës sonë
na ngjallët në mendjen
koha e kalueme
një jetë e tanë
dhe vjen pyetja
sa kemi jetue
në ç'dimesion të kohës ?

Mos vallë
kanë kalue shekuj
vite
muej
ditë
orë
apo vetëm disa çaste
ose asnjë ?

A mund të reduktohën
milarda vjet
të gjithësisë
në një çast ?
kush na siguron
se edhe vete çasti
nuk asht një univers ?

A ekziston koha
apo e kemi shpikur vetë
për me ia përshtatë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

jetës sonë ?

Jo
të dashun miq
asht diçka tjetërë
koha asht pafundësia
e padukshmja
abstrakti
e pamatshme
e pakufishme.

Megjithëse rrotullohën
Universe të shumtë
madhësia universale
nga mikrokozmi në makrokozëm
nga atomët në megalaktikat
nga hiçi në gjithësinë
ose ma mirë
nga hiçi në hiç

Çasti
në të cilin kënaqemi
asht vetëm
një flluskë sapunië
bahemi të vetëdijshëm
në grahmën e fundit
për t'u transformue
në anbstraksionin e kohësë
asht kronofilosofia
që na e pohon
edhe ajo abstrakte
si koha.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Nji herë

Isha një fëmi
një herë
po
nji herë
një çamarrok i vogël
ndër shumë çamarrokë
që e donte jetën
që i donte lojnat
i gëzueshëm
i gjallë
që nuk njihte trishtim
por
jeta
nuk shpërdanë ma dhurata
kopshtët kanë humbun lulet
rruga ka mbete e shkretë
askush
nuk mund të me bajë me qeshë
askush
nuk mund të më baje me kja
kam mbetun vetëm
shokët e mi
vijnë vërdallë
si hije
e kanë humbun
përbamjen e tyne
mbi këtë tok

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Vëllimi i tretë

Petale trëndafili

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Petale trëndafili

Petale trëndafili
petale e bardhë trëndafili
ku do të ketë çue era
që të grabiti
nga gembi i njomë
ku vallë
do të ketë çue era ?

mos vallë
mbi ujin e freskë të një burimi
mos vallë
mbi barin e blertë të një lëndine
mos vallë
mbi ranën përcëlluese të një shkretine
mos vallë
mbi valët lëkundëse të detit
mos vallë
mbi akullnajën e ftohtë të një mali ?
tashma
e bjerrun
e zhdukun
e groposun
ne gjinin e tokës nanë
humus
për me i dhanë jetë
petaleve të reja
petale të bardhë trëndafili.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Engjëj

Lisat ulurijnë
nën vrullin e papërmbajtun të erës
i pergjumshën dielli
çohet mospërfillës
në kërkim aventurash të reja
anijet nisen
mbi detin valëzues
në kërkim tokash të largëta
ndjehem i mbyllun
në zymtësinë e ditës
në mallëngjimin e kangëve të harrueme

megjithëse kangët ndryshojnë
nuk ndryshon trishtimi im
dashunia
si një barkë me vela
niset mbi valët e detit
e nuk dihet
a do të kthehet ma kurrë
deshprimi im nuk asht i kotë
vishet me blerim
i ngjitet përsëri shpresës
mikja ime aq e bukur
më përkëdhel
e ndjej ambëlsinë e buzëve te saja
e ndjej freskinë e gjinit të saj

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

ndigjoj hapat e engjëjve që vallzojnë

me ritmin e zemrave të tona
vijnë rrotull të heshtun
kambë-zbathun
të mbështjellë
ne velot e tyne të bardhë
na shikojnë të buzeqeshun
plot dashuni
të mallëngjyem.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Hyjneshë e andrrave

Prej ujit të detit naltësohën
shtëllunga mjegulle
që mbulojnë qiellin
nga deti i së kaluemes
ngrihen rejet e kujtimeve
që mbulojnë jetën time
andrroj
hyjneshën e andrrrava të mija
miken besnike dhe të bukur
andrroj
shkëlqimin rinor të saj
ambëlsinë e buzëqeshjës
vështrimin plot dashuni
të syve të saj
ajo
më përkëdhel gjithmonë
me bukurinë e saj
dhe i dhuron qënjes sime
kuptimin e jetës
dhe i dhuron shpirtit tim
kuptimin e dashunisë së pakufishme.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Vëgim

Ambëlsia e buzëqeshjes
zani melodioz i yti
më pushtojnë zemrën
porsi fyma e erës
që lëdhaton gjethet e pemëve
lulet e kopshtëve
barin e lëndinave
bardhësia
e gjinit tand
më deh
ndjej dridhjen e trupit tand
ledhatimin e duerve të tua
megjithatë
tepër të largëta në kohë
bukuria jote
dashunia
mbetën
vetëm
një vëgim.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Flet zemra

Bardhësia e fildishtë e gjinin tand
tejduket
nën velon e hollë
që kërkon të mbulojë
trupin tand të natës
ai i ditës

tashma i harruem
mbi trotuarin
ku
trokitja i takave të tua
akoma jehon nën dritën e harrueme
shfaqesh me bukurinë tande
si një vëgim
hesht
fjala mbi buzët
flet vetëm zemra
me ritmin e rrahjeve të pandalshme
me ritmin e çastëve që kalojnë
të shoqnuem
me t'ambla lëdhatime
në thellësi të shpirtit
qëndron
hidhërimi i një kohë të lumtun

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

e zhdukun përgjithmonë
mbetet i pashlyeshëm

kujtimi
i një fytyre engjëllore
shkëlqim i bukurisë
rreze dielli
në errësinën e kohës.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Andërr

Kisha humbun në një andërr
ndoshta
andrroja me sy hapët
u gjeta nuk e di se si
ne një fushë të pafund
të mbulume me lule të bardha
nën rrezen e fundit të diellit të lodhun
lulet merrnin ngjyrë vishnje
si përendimi
petalet e fishkuna
të nxime
të shpërdame nga era
krijonin një mozaik
mbi kupën e errët të qiellit
vizatonin
fytyrën time
të rudhosun
të zbehtë
të mavijosun
një pulëbardhë po merrte vrull
mbi flatra e saj të mëdha
ndjeja
se po ngjtësha në flutrim
drejt të panjohunes
pafundësisë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Mbramje

Çdo krijesë e gjallë
e ndien veten te vetmueme
në madhësinë e tokës
kur dielli
lëshon shigjetat e fundit të tij
që i japin zjarr
qiellit tashma të lodhun
bie mbramja
preludi i natës
në mendjen t'ime endacake
bie harresa
preludi
i pushimit të amshuem.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Lis mbi greminë

Një lis
i sakatuem nga stuhitë
një lis tepër i mplakun
tepër i lodhun
me levozhgë të rudhosun
i kërrusun mbi veten
i vetmuem
atje
mbi buzën e një maje shkambore
përgjon
prej shumë kohës
zhurmën e greminës
mbi degët e lodhuna
disa zogj endacakë
gjajnë strehim
ndigjohen cicirimat e tyne
përplasja e flatrave
qënja ime gjithashtu
kërkon një strehë
larg nga rrëmuja e jetës
të ekzistencës njerëzore
ku
tingulli i zanit
humbet në fund të greminës
atje
ku mbretnon
vetëm heshtja.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Fillim e fund

Stinët përsëritën
në lëvizjet e qiellit
gjithmonë
në mëshirë të ernave
lulet e pranverës
të shpërndame
gjethet
krijojnë
hijen e pemëve
njerëzve
kur ngrihet
monotone
kanga e xhingallave
në afshin e zjarrtë të verës
me ato fushat e grunit
valezuese
të pikturueme
me okër të verdhë
nga një Van Gog
surrealist
vjeshta
i mbush me venë kuqat
me avuj kokat
njeriu bahet andrrimtar

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

andrron tabllotë e Rubensit
Dionizin e Panin
bakantet gjysmë të çveshuna

gjethet bien
te thata
të shpërdame
dashunitë humbin
mbrrin dimni
mbi qiellin e vrejtun
mes degëve të lisave
të çveshuna
të përthamë
t'errëta
duket
hija e kosës
ogurzeze e kobshme
fundi.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Besojuni poetëve

Kërkojmë universin
në hapsinat e pafund
kur universin
e kemi
në vetvete
mundohemi
t'arrijmë
skajet ma të largëta
galagtikat
nebulozat
botnat e paarritshme
te molekulave
te atomëve
pa asnjë shpresë suksesi
madhësia ma e pamatshma
vogëlsia ma e pamatshma
makrokozmi
mikrokozmi
krahasue
me pafundësinë
janë hiç

vlefta e hiçit
me vleftën e gjithësisë
barazohen
në pafundësinë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

asht një poet që e thotë
sepse poezia
mendimi i frymëzuem
asht aftësia ma e naltë
e mendjes njerëzore
e vetmja
që mund të përfshijë universin
nën një çast të vetëm
besujuni poetëve !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Gjeneza

Në zanafillën e zanafilles
ishte fjala
shpirti
mendimi
abstrakti
hiçi
vetmija
hiçi
zeroja
plusi
minusi
e mira
e keqja
kaosi
errësina
dhe fjala
vendosi rregull
zani i saj
ushtoi i fuqishëm
urdhnues
« fiat lux
et lux facta est ! »

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Kuptimi i jetës

Iu drejtova një fluture të bukur
kuptimi e jetës
e pyeta
flutura filloi të pikturojë qiellin
me ngjyra
e u nuk u përgjigj
iu drejtova një blete punëtore
kuptimin e jetës
e pyeta
bleta filloi të numërojë lulet
nji nga nji
e nuk u përgjigj
iu drejtova
një dallëndysheje të palodhun
kuptimin e jetës
e pyeta
dallëndyshja fluturoi
nëpër njëmij çatishë
duke cicerue
e nuk u përgjigj
e kështu me radhë
kuptimin e jetës
kuptimin e jetës
barit të njomë
lisave te fuqishëm
maleve madhështore

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

u bana pyetje
e nuk u përgjigjen
iu drejtova pastaj
tokës
detit
qiellit
e pastaj
diellit
hanës
yjeve
e nuk u përgjigjen
ma në fund
iu drejtova vetvetes
kuptimin e jetës
pyeta
nga thellësia e qenjës sime
ndjeva
që po përfhsihesha në gjithësinë
në fluturën
në bletën
në dallëndyshën
në ngjyrat
në lulet
në gjithësinë
në barin e njomë
në lisat e fuqishëm
në malet madhështore
në gjithësinë
në tokën
në qiellin
në detin

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

në diellin
në hanën
në yjet
në pafundësinë
në amshimin
në gjithësinë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Besoj

Re endacake
në brazdat e ernave
mendime të shpërdame
në brazhdat e kujtimeve
që kurrë ma
kurrë ma
s'do të rijetojmë
mjegull e madhe
zbrazëti e madhe
hapësinë e pafund
e qenja ime që shtyhet
përtej çdo pengese
përtej jete
vdekjes
e qenja ime që shtyhet
përtej çdo arësyeje
kokërr rane
atom
grimcë
e jetës së amshueme
të lëvizjes së amshueme
gjendëm
në intuicionin e ndjte
të pafundësisë
e
besoj !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Përballë oqeanit

Oqeani
dhe madhështia e tij
pushtojnë
shpirtin
mendjen
ndoshta
kemi dalë nga honet detare
kështu po thonë
por
ndërsa me pëlqen
toka e palëvizshme
ku mund të mbështes kambët
çuditnisht
me tërheq
hapësina e ujnave valezuese
tërbimi i stuhive
valët e trazueme
të inatosuna
që përplasën
mbi shkambijtë e thepisun
të brejtun
prej shekujsh të pa numërt
kur kishte vetëm tokë e det
kur kishte vetëm ujë e shkambˌ
as bimë
as peshq

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

as hardhuca
as majmunë
e patjetër
as hominidë leshatorë
ndoshta
kemi qenë bimë
ndoshta peshq
ndoshta hardhuca
ndoshta majmunë
ndoshta hominidë leshatorë
kështu po thonë
oqeani
madhështor
përgjigjet
me gjëmimin e tallazëve
si gjitmonë
ndoshta tregon
historinë e gjatë të tij !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

In excelsis

Gjashtëmijë metra mbi tokë
me trupin aq nalt
edhe mendja naltësohet in excelsis
dhe mendimi bahet pjesë
e pafundësisë
atje poshtë
në ato shtëpiza lilipute
ka mbetun diçka nga vetja
ndonjë kujtim
që sillet nëpër dhomat
te një banesë njerëzore
ndoshta i varun në mur
në nji kornize t'artë
ndoshta një kujtim abstrakt
qe endet
ndër labirintet e trunit
njeriu mundohet të realizohet
sipas shëmbëllturës
se Krijuesit të Madh
në formën
në konceptin
duke e mbajtë veten
si një hyj të gjithpushtetshëm
mbi këtë tokë
sundimtar i padiskutueshëm
aq asht mendjemadhësia

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

e papërmbajtun
per pushtet
makrokozmi
mikrokozmi
si njeni ashtu tjetri
në fund të fundit
janë
pa vlerë
hiç !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Metamorfozë

Ditët duket se po fundosën
në greminën e hiçit
të heshtun
ditët duket se po shpërndahen
në shtigjet e harresës
të heshtun
ditët ikin drejt hapësinave siderale
të heshtun
ditët tashma zhdukën në pafundësinë
të heshtun
mospërfillës ndjekin vrapin e kohës
e kaluemja
e tashmja
e ardhmja
përzihen ndër veti
ne një pështjëllim kaotik
të prangosun
në shkambin prometeik
të gjakosun
nga kthetrat e çelikta të shqipeve
nga sqepat e pa mëshirshëm
i ndiekim të pafuqishëm
këto ndryshime
ditët vazhdojnë
metamorfozën e tyne kronologjike
të heshtun
përbuzës
nuk përfillin kurrë
të na kërkojnë
njì kë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Stuhi

Grumbullohën rejet në qiell
lajmatare stuhishë
të shtyme prej vrullit të erës
rënqethen pyjet
përdredhin degët e tyne të shumta
nga trungjet e lënduem të lisave
ngrihet
një gjëmim i fuqishëm
i ngjashëm
me gjëmimin e tallazëve të detit
nën vrullin e kohës
renqethet e gjithë qenja ime
shpirti i ankthuem
prej thellësisë së zemrës
vjen
një gjëmim dhimbje
mbetëm i tronditun
i çuditun haru
i pazoti
të rrështoi mendimet e mia.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

I gjallë

Yjet shkëlqejnë
buzëqeshje të natës
mbi tokë
buzëqeshtje të Perëndisë
mbi shpirtnat e njerëzve
ndjehem i pushtuem
nga nji heshtje e madhe
ndjej psherëtimën e erës
mbi valët e detit
përgjigjem me psherëtimën time
e thyej heshtjen
jehona e thirrjes
ngrihet drejt qiellit
humbet në natën
ua rikthej buzëqeshjen yjeve
ndjehem i gjallë.

.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Kllapi

Shkëlqimi i syve të tu
i jep ma dritë
velos së tejdukshëm
që mbulon trupin tand hyjnor
sytë e tu më kërkojnë
përmbi shpatullën e fildishtë
bukuria e gjinit tand
ia tejkalon
rrezës së dritës
llanët e krahëve të tu
me magjepsin
përfytyrim
apo pamje e vërtetë
të vështroj
dhe i lëxoj fjalët e heshtuna
mbi buzët e tua
i ndjej
rrrahjet së zemrës
lakmoj
dashuninë tande
nga tellësia e shpirtit
shpërthen vrulli i kohës
ditët e netët kalojnë
mbetet
kujtimi i shikimi tand
i buzëve
i puthjeve të zjarrta

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

i trupit engjëllor
tashma
përfytyrim i largët
kërkoj
me kap të kaluemen
mundim i kotë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Mirëdita!

Sa e bukur ishe
vashëza ime
e bukur si nji zanë mali
a e mban mend atë ditë
plot diell plot ngjyra
plot erëza lulesh
plot kangë zogjësh
a e mban mend ?

Hyjnore
jo ndryshe Afërdita
e tejdukshme
engjëllore
sytë që shkelqenin
ma shume se një yll
me atë trup të derdhun
nga nje artist hyjnor
një Praksitel
nën hijen e ullinjve
erdhe e me takove
e buzëqeshun
sa e bukur ishe
moj vashëza ime
me pershendete
me the vetëm
mirëdita !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Kujtime

Jetojmë me kujtime
megjithatë
ato shpërdahen në hapsinën e kohës
mbi një qiell pa kufi
zogj shtegtarë në rrymat e ernave
duken e zhduken porsi hije
porsi kimera mitesh
të pakapshme
mbetën vetëm gjurmët
në thellësinë e shpirtit
pjesë e qeniës sonë.

Kujtime
kujtime papërfillëse
kujtime tërheqëse
kujtime të trishta
kujtime të harëshme
t'errta
të ndrituna
jeta na qenka veç kujtime
dukuni endacake
nëpër labirintet e trurit
shtegtare të përdartuna.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

New York

Qiell-gërrysët e New Yorkut
grataciellët
ngrihen madhështorë
me kokat e tyne boshe
te mbështjellun
me velot mjegollore
ngrihen
te fuqishëm pare-gerrysët
me kokat e fryme
te mbeshtjella
me velot e arta të dollarëve
te gjithë racat e botës
te gjithë gjuhët
levrijnë
atje poshtë
mes kanionëve
të avenyve e stritëve
nën hijen e kullave të nalta
të Babelit
që kërkojnë të kapin qiellin
tue harrue
se janë kokrriza pluhuni
te pa kurrfarë vlere
të perdjerruna

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

në pafundësinë e universit
prralla e përjetshme
e bretkockës me buellin
i shkreti njerëzim
që mendon e andrron
kulla te nalta
plot ar e diamantë
tue harrue lutjen e thjeshtë
të birit të Njeriut
të shqiptueme
nga miliona të dëshpëruem
anëkand këtij rruzulli :
« Bukën e përditshme
jepna neve sot!»

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Pyetje

Si mundet me çelë nji lule
mbi telat e ndryskun me gjemba ?

Si mundet me mbi nji fije bar
mbi tokën e djegun e të shkelun ?

Si mundet me fluturue nji pellumbeshë
mbi qiellin e errësuem të luftës ?

Si mundet me këndue bilbili
mbi degën e ngrime të një lisi ?

Si mundet me buzëqeshë një femijë
i varun pas gjinit t'përtham të nanës ?

Si mundet me shpresue një njeri
i prangosun në qelinë e një burgu ?

Si mundet me besue një i gjallë në jetën
kur gjendet në kthetrat e vdekjes ?

Si mundet…. ? Si mundet…. ?

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Vjeshtë shpirtnore

Vitet
gjethe që bien
nën vrullin e erës vjeshtore
të kohës
kujtime të çastit
që përdaren
e buzëqeshun ndonjëherë
ndonjëherë e trishtë
zemra
me rrahjet e vazhdueshme
kërkon me numrue
çastet e lumturisë
çaste e dëshpërimit
që humbasin ndër shtigjet
e mendimit për gjithmonë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Mjaft !

Kumbojnë të kobshëm
krismat e armëve mbi tokën
pëllumbat e bardhë
ma nuk fluturojnë
mbi qiellin e shkretuem
t'errët
të ndotun
prej tymnajeve
prej flakëve
prej helmeve
të mbushun
me gjëmimet e luftës
kumbon i kobshëm
vaj i fëmijëve
mbi këtë botë
për nji pikë qumësht
nga gjini shterp i nanave fatzeza
në sytë e tyne te çakarritun
humbet jeta
tela me gjemba të ndryshkun
rrethojnë rruzullin
me miliona vorre
mbushin fushat pjellore
mjaft !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

T'i shtrijmë duert vllaznimit
zemrat dashunisë
mendjet paqës
le të fluturojnë përsëri
pëllumbeshat e bardha
mbi qiellin e kaltërt !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Falëminderit Liri!

Liri
liri
ti meriton nga ana ime
shprehjen ma të naltë të të mirënjohjës
ashtu siç e meriton
nga ana e të gjithë atyne
që vuejtën
që u sakrifikuen
martirë
për ty
që u përsekutuen
që luftuen
heronj
që vdiqen
të pafajshëm
me emnin tand në gojë
Liri !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Mendime

Fshihem
nën hijen e mbramjes
bashkë
me mendimet e mija
kujtime
fluturim shpendësh
mbi ekranin e zjarrtë të perëndimit
përtej horizontit
ankth
frikë
kujtime
që zhdukën
përtej caqeve të mendimit
kujtime
që nuk ngjallen ma kurrë
dëshirë
e pavetëdijës
për t'u rikthye
në kohën e lumturisë
së humbun.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Përfytyrim

E kap lirën time
e lehtas
me ambëlsi
nxierr prej saj
tinguj dashunie
tinguj andrrimtarë
tinguj
që dalin
nga zemra ime rinore
më përfytyrohen
zanat e mia
zanat e bukura
të malëve
të pyjeve
të krojëve
kah hedhin valle
nën dritë e hanës kalimtare
të veshuna me të bardhe
mbi lendina të blerta
mbi fusha me lule
një kangë mallëngjyese
sikur del nga buzët e tyne të bukura
sikur shoqnojnë
tingujt e lirës sime
në këtë kllapi magjike
shijon lumturinë
zemra ime rinore
shpirti im.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Tristitia perpetua

(trishtim i përjetshëm)

Një violinë vetmitare
tregonte historinë e saj
me tinguj t'ankueshëm
që çanin ajrin
ndërsa muzikanti
mundohej të fshihte
fytyrën e rudhosun
me kokën e ulun
mbi telat vajtues
flokët e zbardhun
të shpurpurishun
kërkonin me mëshirue
mjeshtrinë e tij
tashma
hiçe
kalimtarët shpejtonin hapin
papërfillës
dikush ndalohej
hidhte një monedhë tingëlluese
një notë e gëzueshme
mes melodisë së trishtë
që shkonte duke u zgjatë
pa mbarim
tristitia perpetua !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Zgjedhje

Nga naltësia e kishave
kryqet
të skalitun në kupën e qiellit
na vështrojnë
me një shikim metalik
gjakftohtë.

Sa shumë kryqe
mbi shumë njerëz
që'atje poshtë
gumëzhijnë
me raca
me ngjyra
në të gjithë kontinentët
vetëm kryqet mbetën të palëvizshëm
mbi majat e kumbanarëve
asjnë prej tyne nuk lëviz
ndërsa njerëzit
te gjithë qeniet njerëzore
lëvizin
besimtarë
e jo besimtarë
asht zgjedhja
ndoshta gabimi ma i madh i tyne !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Andrrat shuhen

Lisat ulërijnë
nën frymen e vrullshme të erës
tallazet e furishme
përplasen mbi shkrepat e thepisun
dielli
çohet me përtesë
ne ditën e re që lind.

Zgjohëm i tronditun
plot dëshpërim
plot andrra
plot kujtime
që strehohën
në thellësi të mendjës
kujtoj të dashtunit e humbun.

Mundohem të kthehem në të kaluemen
duert e mija prekin vetëm ajrin
format trupore nuk janë ma
veçse pamje abstrakte
të ngulituna në tru
të përdjerra
hijet e natës tashma bien
andrrat shuhën
por nuk shuhet kurrë dhimbja!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

Ditë shiu

Lutës
ngrihen drejt qiellit
krahët e degëzuem të lisave
në këtë vjeshtë me shi
që përlyen me trishtim
qytetin
dëshirat
mbetën të mbylluna
të ngrime
pas xhamave
dhe perdeve
të dritarëve
zhurma e pandalshme
të rrotave të makinave
mbi rrugën e lagun
shoqnon
monotone
mendimet e mia
të varuna
pas atyne degëve
të shtrime
gjithë dëshpërim
drejt atij qielli
të vrejtun
përtej reve
shkëlqen dielli
vëzullojnë yjet
ndrit hana
përtej universi
misteri i pafundësisë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Vëllimi i katërt

Valle Yjësh

Pas 2010

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Shpirt i lirë

Sa i shkretë me dukët vetja
Kur e hedh medjen nga gjithësia
Me zen ankthi
E ndjej se jam një hiç
Mes hiçve të tjerë
Më zen dëshpërimi
Pse u krijuem
Pse lindëm vallë
Kur s'do mbetët gjurmë e jonë
Gjëkundi.
Thonë se shpirt ynë
Do të fluturojë në hapsinë
Në lumturinë e përjetshme
S'hyjnë në punë anijet kozmike
Krejt hekur e çelik
Kur shpirti endët
Qetë qetë
Sipas qejfit
Në pafundësinë e universit
E bredh nga një galaktikë në tjetrën
Nga një planet në tjetrin
Pa pasë nevojë
Për fuqi motorike
As austronautë
As gjaprejgjaje materiale
Shpirt i lirë
Në një univers të lirë ?

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Asgja s'humbet

Njëfar budallaj më duket se jam
Kur them
Gjoja
Se bisedoj me yjet
E kush ?
Një asgja
Një hiç
Që sot asht
E nesër
S'do t'i mbetët fara gjëkundi
As hija
I kthyem në atë dhé
Në atë argjil
Prej të cilit u krijue
Lindi.

Së pakut ta dijmë
Se jemi
Pjesë e pandame
E rruzullit toksor
Të nanës tokë
Të përfshimë në gjinin e saj
Përjetësisht
Sipas teorisë
Asgja s'humbet
Gjithçka transformohet

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Mundet
Që rikrijohëmi
Përsëri
Pa ditur
Se kem ekzistuar
Ndonjiherë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Valle yjësh

U çmendën yjet
E nisën me vallzue
Mbeta i befasuem
I ngrimë
Haru
E lëshova zanin
Britmën
Pse më tradhëtuet
Vallë
A s'isha pjesë e universit
Bashkë me ju ?
Pse më mohuet
U thashë
Pse ju yje
E moret vallet pa mue ?

Eh more i shkretë
Ç'je ti
Një hiç
M'u përgjigjën
Që do të matësh me ne
Rri
Aty ku je
Prit
Deri sa të bahësh shpirt
Të shkëputësh

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Nga kafazi
I atyne kockave
E të fluturosh
në hapësinën e pafund
Atëherë
Mun të hedhish valle me ne.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Heshtje

Si u krijue universi
Bota
Jeta
Shkojnë tue thartue trutë
Filosofët
Shkencëtarët
Kërkojnë t'udhëtojnë me miliona
Miliarda vjet dritë
E s'janë të zot
Të hedhin një hap
Jashtë pragut të derës
E jo ma të shetisin universin e pafund.
Ah more dijetarë të shquar
Mos e lodhni mendjën fort
Se aq e keni rriskun e jetës
Një çast.
Jetoni
Merruni me shpikje e kërkime
Sa me sigurue kafshatën e gojës
Gjithësia e di mirë si asht krijue
S'ka nevojë t'ia tregoni
Që akoma nuk dini
Kush jeni ju
Kush ju ka krijue
Apo
Si mund të jeni krijue
Ju vetë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Mospërfillje

Vallzoni yje vallzoni
Ne u vështrojmë vetëm natën
Kur ndritni e vezulloni
N'ë errësinën kozmike.
Zhytemi në mendime
Bahëmi filozofë
Kërkojmë të zbulojmë misterët
E gjithësisë
E
Nuk jemi të zot
Të zbulojmë
Misterin e vetvetës.

Sot jemi nesër s'jemi
S'dimë nga erdhëm e ku shkojmë
Udhëtarë drejt të panjohunës
Aq asht shtegtimi ynë
Sa hap e mbyll sytë
E ne mburremi
Si t'ishim të pavdekshëm
Të vetëdishëm
Se ekzistojmë
Të pavetëdishëm
Se nga vijmë
E ku shkojmë
Përveç se nga biçi
Në his

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Këtë e dijmë mirë
Fol sa të duesh
Yjet as dënjojnë të përgjigjën
Vazhdojnë të vallzojnë
Mospërfillës
Si gjithmonë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Kandili i Diogjenit

Filosofia
Me thanë të drejtën
Mundohej me trajtue
Misterët e botës
Qysh para shpikjës së shkrimit
Njeriu e shtrydhte mendjën
Pse e kush e kishte krijue.
Me shkrimin
Dolën filosofët
Mbushën pergamena
Papiruse
Libra
Me plot teori :
Platonët
Aristotelët
Demokritët
Taletët
Sokratët
E të tjerë me radhë
Dhe ja
U duk një Diogjen
Me një kandil në dorë
Ç'kërkon Diogjeni
Mes ditës me atë kandil?
Kërkoj njeriun
Përgjigjej ai qetësisht.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Diogjeni nuk shkruejti asgja
Thanjet e tij mbetën të skalituna
Në mendjën e njerëzimit
I vuni kapak filosofisë
Me një kandil në dorë
Tue kërkue njeriun.
Kandili i Diogjenit
Filosofi e pashkrueme
Por e jetueùme.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Depresion

Kur rri e mendon njeriu
Mbi jetën që gumëzhin
Në këtë glob tokësor
E kap dëshpërimi
I shpaloset para
Pafundësia e univresit
Gjithësisë
E ze depresioni
I duket vetja hiç
Asgja
Kotësi.
Pse u krijova
Thotë
Pse linda
Pse jetoj ?
Sikur t'jetonte gjitmonë
E po
Mirë do t'ishte
Dhe jo
T'i pritet rrisku
Të rikthehët në plukurin
Në baltën
Nga ishte përftuar
A do të përftohej dot ma ?

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Marrëzi

S'ka dyshim
Se do t'isha vullnetar i parë
Me udhëtue me një anije kozmike
Speciale
Që t'udhëtonte
Me shpejtësinë e mendimit
Stërkalue asaj të dritës
N'hapësinën e pafund
Mes yllëzimëve
Galaktikave
Nebulozave
Diellëve
Planetëve
T'i vizitoja
Nga afër.
Fantazi e kotë
E paarritshme
Por sëpakut
Perëndia
Ose natyra
(siç thonë disa)
Na e ka dhanë mundësinë
Me andrrue
E me fantazue
Edhe marrëzina.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Sikur

Sikur shpirti
Ajër
Të lundronte
Mbi oqeanin e pafund
Të gjithësisë
Do t'ua kalonte
Filosofëve
Shkencëtarve
Do të zbulonte botë të tjera
Kudo
Që t'ishin
Larg
Me miliarda vjet dritëë
Eh
Të shkretët shkencëtarë
Që kërkojnë të pushtojnë
Universin
Me anijet e tyne kozmike
Gjithë hekur e çelik!
Ka plot të marrë kjo botë
Që andrrojnë
T'ia kalojnë Perëndisë
Të zbulojnë
Të zgjidhin
Misterët e gjithësisë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Mik i yjëve

Lexova një roman
Dashnori i Arushës Madhe
Që s'kishte asnjëfarë lidhje
Me kozmologjinë
Dhe i dhash të drejtë
Autorit.
E paskam nji shok
Thashë
Që lidhet me univesin
Që ndjek yjet
Që flet e shryhët me to
Se me njerëzit
S'merret dot vesh.
S'ka ma e madhe kënaqësi
Se sa me bisedue me yjet
Kur vezullojnë në kupën qiellore
Të pafund
Së pakut e ndjen veten
Se je mik i tyne
S'je vetëm
Ke
Me kë të bisedosh
Të shryhësh
Edhe pse
S'merr përgjigje
Veç heshtje.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Teori fëmijore

Kur isha i vogël
Një vocrrak
(çuditëm dhe sot)
Rrija tue shtrydhe mendjen
Ç'asht bota
Kisha krijue nji teori t'imen
Sikur ne ishim një andrrën e Zotit.
(kisha dëgjue për të)
Pra ne
Jetonim në adnrrën e tij.
Teoria ime ishte fare e brishtë
Pa kuptim
Por ama
Nji teori
Ishte.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Psherëtima e erës

E ndjej frymmarrjën e erës
mbi xhamat e dritarës
kah dëpërton
mes të çarave të kanatave
fërshfërisin perdet
shikoj atje poshtë
pemët
pa kunora jeshile
të mbetuna haru
lakuriqe
të nxime
të braktisuna
shëtitorja
mbetun e vetmueme
e shtrueme
me gjethet që fluturojnë
që shpërndahën
nën vrullin e Eolit
zotit të ernave
(sa e bukur që ishte mitologjia)
gjethet
të vyshkuna
të thata
përhapën
anëmbanë
vjeshtë
muej i ernave

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

e ndjej frymëmarrjën e erës
psherëtin edhe shpirti im
do të dëshiroja t'isha një gjethe
që e merr era
me qenë pjesë e frymëmarrjes së saj
të butë ose të stuhishme
me i dridhë shpirtnat
mendjet
zemrat e njerëzve
me psherëtimën e poezisë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

« Lacrimarum valle »

(luginë lotësh)

Do të doja me ju ba me kja
sepse kam kja
sepse kam jetue
po
kam jetue
në një luginë lotësh
« lacrimarum valle »
ku
dëshpërimi
ia kalonte
dhimbjes
ku
nanat
qanin fëmijët e tyne
të pafajshëm
ku
bijt
e pafajshëm
qanin baballarët
e pafajshëm
ku pafajsia
qante
vetvetën !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Pyetje të tjera

Kur
do të heqësh dorë
mizori njerëzore
nga mbrapshtitë e tua lemëritëse?
kur
do të pushojnë
stuhitë kobzeze
të përbindshme?
kur
raca njerëzore
do të udhëhiqet
drejt veprave fisnike
të përparimit
të qytetnimit?
siç ngrihet
plot gjallëri dhe ngadhjyese
me bukurinë e saj mahnitëse
pranvera
nga acari i natës
së një dimni të gjatë
të pamëshirshëm
dhe e risgjon natyrën
vallë
a do të ngrihet mbi botë
ndonjëherë
një epokë e re
e drejtësisë
e lirisë
e dashurisë universale?

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Kur dora dridhej

(kushtue Profë Guljelm Dedës)

Shoh
shkrimin e një dore që dridhet
e asaj dore
që xhelatët mizorë e coptuen
me danat e skuquna
në prushin e përflakët
të kovaçanës
së skëterrës
një dorë që bahej gati me lëvrue
me mija e mija faqe
brazda të reja ditunie
për breznitë e ardhme
një dorë mjeshtrore
e krijueme për të qëndisë
me xhevairë e margaritarë
vargjesh e kangësh
librash e veprash
gjërdanin e mrekullueshëm
prallor
të kulturës
për të stolisë
shtatin e bukur
të zojës së randë Shqipni
një dorë
që tashma nuk mundet
me rreshtue fjalë e vargje

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

me thuer kangë e vjersha
por
trashëgimi i saj mbetet
në forcën
vullnetin
dijen
talentin
në dashuninë për njerëzit
si pishtar ndriçues
për të ndritë mbi këtë tokë martire
me një driçim llamburitës
për të zhbi njëherë e përgjithmonë
fëlliqsinat e errësinës
lugetnit e vampirët gjakpirës
dora jote shumë e lodhun sot pushon
i gjatë mundimi i saj
e madhe vepra që kreu
monumenti që skaliti
përjetësues
per ty
Lem!

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Lind një fëmi

Lind një fëmi
mbi qiellin e kthjelltë
fluturimi i një engjëlli
mbi qiellin e kaltërt
fluturimi i një pëllumbi të bardhë
një kangë kerubinash
një lutje e ambël
në zemrën e një nane
të lumtun
doçkat e vogla shtrihen drejt dashunisë
drejt atij gjini që ushqen njerëzimin
nga epokat ma të thella të kohnave
n'ato të s'ardhmes së largët
në misterin e mirësisë hyjnore
bekim që zbret mbi tokë
asht foshnja që ndrit shtëpinë
bekim i familjes
bekim i paqës mes njerëzve
bekim i bashkimit të shpirtnave
por
orlat e zi presin mes shkrepave
si shigjeta t'egra e mizore
t'etun për gjak
të uritun
sulmojnë pellumbat e bardhë
capërlojnë pëllumbat e bardhë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

gjakosin pëllumbat e bardhë
mbi fëmijët e qeshun të lumtun
mbi pafajsinë e dashuninë
mbi brishtësinë e jetës
vërsulen egërsitë njerëzore
ma keq se orlat grabitçarë
ma keq se se korbat e kërmave
currila gjaku të pastër
mbi rrugët e qyteteve të shkatërrueme
mbi muret e shtëpive të djeguna
mbë djepët e boshatisun
mbi gjitë e përthamë të nanave
njerëzim
lind një fëmi
lavdia e Zotit të zbresë mbi tokë
lavdia e Zotit të zbresë mbi çdo shtëpi.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Luftë e paqë

Nuk fluturojnë ma
pëllumbe »shat e bardha
në kaltërsinë e qiellit
luftë!
Ré të zeza mbytëse
mbulojnë tokën
flakë ngrihen anëmbanë
shkatërrime
luftë!
Mes reve lajmëtare të stuhive
dëgjohet gjama e avionëve
shurdhuese
në qytetet e pushtueme nga tmerri
përhapet e lemëritshme
ulurima e sirenave
ushton i llahtarshëm
shpërthimi i bombave
gjama e topave
luftë!
Mes shtëpizave të fshatnave
jehojnë
krismat e automatikëve
vrasës
mbi trupat e të pafajshmëve
luftë !
Vajë fëmijësh
lot nanash

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

dëshpërim jetimësh të perdjerrë
të mbetun pa prind
dëshpërim prindësh
të mbetun pa fëmi
prej mizorive të njerëzve
egërsi kafshësh grabitçare
luftë !
Korba e orla të pangopshëm
shpend ogurzez kërmash
vijnë rrotull
mbi atë qiell t'errësuem
të pistë
kundërmim mortor
shkretinë
kudo
mes grumbujve të shtëpive të djeguna
të përfshime nga flakët shkruemese
mes brazdave të arave
ku mbillen kufoma
trupna të sakatuem
të coptuem
të djegun
(të korruna mortore)
ndër shtigjet e ngushta malore
gjindja kërkon shpëtim
nga terbimi i armëve vrastare
nga hordhitë barbare
që si lugetën të dalë nga e kaluemja
çohën
të tmerrshme
duke mbulue me krime e përçudnime

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

ketë tokë të lodhun
të rraskapitun
në prag të këtij tremijvjeçari
në kulmin e qytetnimit
ngrihuni njerëz vullnetmirë
bashkoni duert e jueja të fuqishme
ndaloni këto lufta vllavrasëse
ndaloni bombat e topat
pushoni luftat
shkatërroni armët vrasëse
shtrini duert drej arësyes
shtrini duert drejt miqësisë
shtrini duert drej vllaznimit
paqëja të mbretërojë mbi botë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Kohë moderne

Nuk i hyn ma në punë kosa
vdekjes
as kali shterbaluq
kali i saj skeletik
ma mirë avionët modernë
të shpejt si mendimi
ma mirë armët moderne
armët kositëse moderne
se sa kosa primitive
e ndryshkun
ma mirë armët e fuqishme
shfarosëse
mitralozë
topa
gjyle
gaz
bomba
H
pa u lodhun fare
me një puro
mes dhambëve
të zgërdheshun
shtri rëhat
mbi poltrona të buta
në avionë supersonikë
Gjithçka ndryshon

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

përparon
marrëmedshëm
qytetnim i përsosun
e pse jo
vdekja
pse me u lodh
me kosën e ndryshkun
mbi atë kalin e saj
tahtuq
të stërplakun
kur ka avionë
raketa
armë të tmerrshme
atomike
etjera
mjafton me shtyp
susta
thjesht
tak !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Apokalips

I vrejtun dielli
lëshon
rrezet e tij të përflakta
mbi këtë njerëzim
që përcëllohet nga rrezet e tij
dhe merret
me punë e vepra të neveritshme
kërkon t'endi rrjeta merimagash
mbi çdo plithar të tokës
mbi çdo pëllambë të lendinave
mbi lulet shumëngjyrëshe
mbi pyjet madhështore
mbi oceanët e pakufishëm
mbi akujt e përjetshme
një përgjumësi e drogueme
pllakoset mbi botën
peshon mbi qëpallat e lodhuna
mbi sytë e fikun
mbi fytyrat e zbeta
të njerëzve
të budalljepsun
të degjeneruem
lamshi diellor
duket shumë i largët
tutje reve të tymnajëve
të verdha jeshile

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

të kuqe të zeza
pa ngjyra
të pista
helme
sa fort vrahet
fytyra e diellit
errësina mbulon tokën
bie nata e kobshme
permbytje
diluv universal
apo
kasapane universale
katastrofë
rrafshim
zhdukje qytetnimesh
të vjetra
të reja
prej armëve nukleare
që e kthejnë
rruzullin toksor
në shkretinë
a shpëton a s'shpëton
njeri
kafshë
gjallë
për të ripërtri
jetën përsëri
për të rilnd botën e humbur

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Poezi e harrueme

Isha i ri
Pa mëndime të trishta në kokë
Ku rafsha mos u vrafsha
Çdo gja me dukej e bukur
Çdo gja e shihja të lulëzueme
Jeta me buzëqeshte
Më buzëqeshnin vajzat
Shtojzovallet perri
Gufonte në zemër time
E frymëzueme
Poezia
Rreshtohëshin vargje
Himnizuese
Hyjneshesë së dashunisë
Që aq bukur
Praksiteli antik
Kishte përfytyrue
Skalitun
Me mjeshtri.
Isha fare i ri
Andrrimtar
Për një t'ardhme të kandshme
Midis shkëlqimit të qytetërimit
Të një bote paqësore
Plot liri
Me dyer të hapuna

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

Drejt artit e dijëve
Ku vend mund të zinte
Edhe poezia
Që vinte
Nga thellësia e shpirtit t'im
E papërmbajtun
Me frymëzim rinor
Jeta më buzëqeshte
Gufonte zemra në krahnor.
Befasisht
Shpërtheu një stuhi mortore
Që përlau gjithçka
Diluv pëmbytës
Të çdo vlere njerëzore
Me njerëzit vetë
Të pëfshimë
Andërrimet morën fund
Nisi dëshpërimi
Me thur rrënkime
Zemra ishte ba gur
Mendja e çoroditun
E përdjerrun
Në atë errësinë të kobshme
A thue do të rikthehej
Në zemër frymëzimi
Me thuer poezi
A thue do të vazhdoja
Në andërrimet e mia
A thue
Do të më buzëqeshte jeta
Përsëri?

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Vëllimi i pestë

Tingëllime të vona

Poem

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

Kushtue
t'afërme të mi të dashun
që përjetuen tmerrin e
skëterrës komnuniste
dhe vuejtën e u flijuen
viktima të pafajshme
martirë të lirisë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)


Hyrje

Tingëllimin e parë të jetës sime unë e kisha krijue në moshën 12 vjeçe kur vazhdoja shkollën në Rome në Kolezhin Santa Maria, Viale Manzoni 5. Ia kisha kushtue Gjerj Kastriotit Skënderbeut, ë frymëzuem nga dy romane histiorike që i gjeta në bibliotekën e shkollës. Sigurisht në gjuhën italiane. Rrethanat tragjike që familja jonë kaloi nën diktaturën komuniste ishin të tilla sa vezhgohej edhe frymëmarrja e njerëzve dhe jo ma fjala, mendimi e shkrimi, etjëra. Kur pas 45 vjet fituem lirinë në Mbretninë e Belgjikës, ku u pritën shumë mirë, fituem gjithashtu lirinë e fjalës e mendimit që na ishin ndalue me dhunë e terror. Çudia vjen se, në vend që të shkrueja në prozë e të tregoja për kalvarin e gjatë që kishim pësue, më erdhi frymëzimi poetik, për të shprehun në vargje mbresat e asaj kohë mizore. Mbresa që ishin fiksue në mendje në ato kushte burgjësh e kampësh që kishim përjetue. Kështu me lindi ideja që me i kushtue familjës sime një poem në tingëllime. Pak e çudittshme por që arrita të realizoj. Kjo ma teper si një vepër përsonale e rrethit familjar dhe jo si ktijimtari letrare për botim e përhapje, në kuptim të gjanë. Me këto tingëllime i kam thurun çdo familjari historinë e tij, duke tillue nga gjyshja, e me radhë nana, im atë, gryteja ime e me tre vllaznit. Një kujtesë poetike që të mbetë trashegim në bibliotekën e familjës. Pra nga tingëllimi i parë imi për Gjergj Kastriotin kishin kalue ma se 60 vjet pa e përdorun atë formë poezie. Por i kisha mirë të ngulitun

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

në tru tingëllimet e poetëve të mëdhej italianë si Dante, Petrarka, Karducci, dhe të atyne shqiptarë, si Mjeda, Fishta, Poradeci, etj. I ndaluem gjatë kohës së diktaturës për çdo orvajtje krijilmtarie letrare-artistike, gjihtshka përmblidhej e bluhej në mendje se si do t'i vinim në jetë kur të fitonim lirinë. Dhe lirinë aq të dëshirueme e të çmueme u desh që të kalonte njën gjysmë shekulli që ta fitonim, në një vend të huej, por mik, sepse vendi ynë na kishte mohue. Këto tingëllime të vlejnë për atë që do të ketë rast t'i lëxoje, për të njohun jetën e sëcilit pjestar të familjës sonë, ku pak a shumë jepët edhe nje pamje reale edhe mbi rrethanat historike që ka kalue Atdheu ynë, të gërshetueme me ato të familjës sonë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Gjyshja, Mrika Pervizi
Bulgër 1860 -Tepelenë 1950.
5 vjet internim
(Vizatim i autorit)

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

GJYSHËS

I

Të trishta janë kto vargje që rreshtohen,
të trishta historitë që aty fliten,
të trishta po janë kohnat që kujtohen,
kur trupi bashkë me shpirtin u sfiliten.
Gjyshja më del para porsi vegim,
ajo qe « nanë vogla » thirrnim të tanë.
Ma pushton zemrën fort një mallengjim,
përjetoi mundime n' moshë të randë.
Fisnike dhe krenare kurdoherë,
vocrrake me trup, dive për qëndresë,
n'at mjerim nuk u ligshtue asnjëherë,
E urtë e dashun, shum e dhanë pas fesë,
« Zoti e ban mirë » përsëriste përherë :
në mendje t'internuemve mbet kujtesë.

II

Grue me cilësi t'rralla dhe me vlerë,
u përfshi në ngjarjet e historisë
përkrah trimave qëndroi ma se 'i herë,
n'ato lufta për fitorën e Lirisë.
Kur në Milot u grit flamuri kombtar,
pranë Gjin Pjetrit rrinte një djal' i ri,
ishte bir' i saj ai që fort krenar,
po përjetonte t'dishruemen pavar'si.
Nuk u mburr kurr për këto përjetime,
gjithmonë qëndroi si një femën zojnore.
Edhe në kushte t'mjerueshme e internime,
tregoi një forcë të madhe shpirtnore.
Jetën e humbi ndër ato mundime
emni saj ka me u përmend përore.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

III

Mbas viteve të para të stuhishme,
në luftë kundër turkut dhe Serbisë,
përjetoi Atdheu kohna t'lavdishme,
me shpalljen e vendosjen e mbretnisë.
Djali yt ish ndër ata burrat e dheut,
që i dolën zot kombit me t'madh guxim,
ishin ata ndërtimtarë t'Atdheut,
katër trima të lidhun në bashkim.
Kuadriumvirat prej tyne u krijue,
Ahmet Zogu në krye sundonte vendin:
Ish bir' i yt n'atë kohë që shum u shque,
Në tanë Shqipninë ata vendosen rendin,
prej tyne dhe mbretnia shum u forcue,
n'faqet e historisë do t'i përmendi.

IV

Ishe ti nje tregimtare e madhe
ngjarjesh të kalueme t'historisë
bashkë me legjenda t'lashta me radhë:
një thesar i vërtetë i mençurisë.
Flisje për Gjin Pjetrin e për Kurbinin,
për Lidhjen e Prizrenit, për burrat e dheut,
për Abdyl Frashërin, Isa Buletinin,
për trimat e kohës s'Skanderbeut.
Ahmet Zogun Mbret prite sa herë,
me burrat që po ndërtonin Shqipninë
Gjergj Fishtën e madh, poetin Homer,
që me lahutën perjetësoi traminine,
e Shqiptarve , që luftonin me nder,
për trojet e tyne, atdheun e tirinë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

V

Re të zeza qiejt e botës mbuluen,
për Shqipninë e mjerë një kob i ri ;
hordhitë fashiste vendin e sulmuen :
ishte dita e atij shtat prilli të zi.
Re pas reshë dhe shpërthejti stuhia,
rruzulli u përfshi n'përleshje viganash,
shkatërrime pësoi mbar njerëzia,
n' lufta t'përgjakshme mbetën sa djem nanash.
E kur dita e lirisë agoi mbi botën,
e popujt po shpresonin për shpëtim,
mbi vendin tonë djalli lëshoi shqotën,
ra mbi shqiptarët një ma i madh mallkim
Historia mbrapa po e kthente rrotën,
Pesonte Atdheu ma t'egërin pushtim.

VI

U vërsulen t'egra brigatat partizane,
zjarrin duke u kallë kullave kreshnike,
që kishin pas djegun hordhitë osmane:
ti dëshmitare ngjarjesh historike
Cilësitë e tuja aq të shqueme
për të cilat të njihnin krahinat mbarë
e gjithë vendi, si një grue t'nderueme
nuk i përfillte hiç regjimi barbar.
Në Laç e në Skuarj, u ngrit flaka,
mbi ato kulla kala, çerdhe shqiptarizmi
bashkë me to t'u pre dhe ty nafaka,
re n'kthetrat e pushtetit të sadizmit,
që burgoste e internonte pleq e plaka,
dhe i pllakoste n'kampet e komunizmit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

VII

Vendin, sllavo – komunizmi e zaptoi,
me hekur e zjarr e krime mizore,
mbi kullat heroike flakën lëshoi,
e mbushi trojet me burgje e me vorre.
Ku ishin burrat ma të mirë të Shqipnisë,
i lidhi n'hekra, i çoi në pushkatim,
të përfshiu edhe ty vala e barbarisë,
të moren, larg të tretën n'internim.
Atje t' përplasën n'Tepelen'n gurore :
me mija ndër kapanone u stivosën,
ku sillej vërdallë veç vdekja mizore,
mbi t'pafajshmet viktima sillte kosën,
s'kurseu as pleqërinë as moshën fëmijore
Aty, gjyshe e dashun, vitet t'u sosën !

VIII

Lot kan me u derdhë për ata që s'janë,
për atë gjak të pafajshmish që rodhi gurrë
Mos u përsëristë ma ajo kasaphanë,
ajo kohë mizore mos u ktheftë kurrë.
Një vend aq i bukur, parajzë toksore,
krejt u shndrrue në burgje e kampe t' punës,
që për shum kënd u kthyen n'të zeza vorre.
vdisnin njerëzit prej mundimi e dhunës
E atdheut të tanë elita e mençurisë,
u zhduk nga faqja e dheu e u shue fare:
mbaroi pafajsija n'kthetrat t'lemërisë,
nuk u kursyen as mosha ma mitare:
nanat u veshën me mobat e zisë,
i humbën foshnjet e tyne ndër llahtare.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

IX

Hije lugetnish xhelatët vinin vërdallë,
viktima tuj kërkue n'fshatna e qytete
tmerrin përjetonin njerëzit për s'gjallë:
shpëtuen ata që u ndan prej kësaj jete.
Vdekje mbillnin çdo çast armët vrastare,
brigjeve tëlumejve t'llahtarisun:
kositëshin veç jetat djaloshare,
ndër gropa të përbashkëta gremisun.
N'prehnin e nanës përpëlitej fëmija,
për një pikë qumësht i etun i sëmurë:
kërthiqet e gjora i zinte veç uria
gjini i nanës ishte kthye në murë.
Kënaqëshin sadizmi e ligësia, :
shpirt katilët, xhelatët zemër gurë !

X

N'se vdekja të shpetoi nga ato mjerime,
ku viktimat vuenin për një kotherë,
pushteti gjakatar sajonte krime,
mos me t'lan me pushue n'vorr asnjëherë.
Eshtnat e tua, tri herë ndërruen vend
bashkë me qindra t' tjerë të çvarrosun,
diktatura barbare veç ish çmend,
tmerret e saja nuk kishin të sosun.
Edhe sot nuk dihet vorri yt ku gjëndet
A thue vjen një kohë që ka me u zbulue ?
emni yt përsëri do të përmendet,
në pllaka të mermerta ka me u shkrue
dhe përjetësisht atyt do të gdhendet,
Heroinë të pafajsisë me të ndërrue.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

XI

Tani që vjetët mbi supet randohen,
e flokët e zbardhun flasin për pleqni,
çastet e fëminisë më kujtohen,
kur ti më llastoje me plot dashni.
Aq shum pas nipave jepëshe me shpirt,
e mbi të gjithë mua fort ti me doje,
e kishe zemrën të bardhë aq të dlirtë,
s'ta bante kur zemra të na qortoje.
E urtë, e përvujtun e grue zojnore,
të gjithë të nderonin të vjetër e të ri,
ishe me t'vërtetë një grue arbnore,
stolisë me virtyte e jo me flori,
nga jeta na ndau humnera mizore,
për me u takue vetëm n'përjetësi

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

NANËS

I

Ç'të them për ty fort e dashuna nanë,
kur koha që kaloi ishte krejt mundime,
që në kujtesën tmerre na ka lanë,
plot me tortura, vuejtje dhe mundime ?
Qëndrove n'ato rrethana sokoleshë,
porsi shembull mbete ti e krenarisë,
me njerëz katilë çdo ditë t'u ndeshë,
që donin t'mposhtnin nderin e Shqipnisë.
Zonjë ishe dikur, një zonjë fort e randë,
bashkshorte e një oficeri shtatmadhor,
që gjurmë në histori po kishte lanë,
kur po formohej shteti i ri arbnor :
prandaj t'denuen ty aq egërsisht, nanë,
e t'pllakosën përsgjalli si në vorrë

II

Që në foshnjëri mbete ti jetime,
prindin ta kishin vra në pabesi,
pate asokohë të pakta gëzime,
të përjetueme e vetmueme në vogli.
Në Rrëshen ti linde n'shtëpi fisnore,
e u rrite me një nanë vërtet burrneshë,
ishe fejue që në moshë mitore,
me trimin tand ti kurr nuk ishe ndeshë.
Në Vien t'Austrisë në shkolla të larta,
oficer u kthye n'Atdhe per me punue,
i pari n'mësime me dekorata t'artaë
Lufta e Madhe Botnore sa ishte mbarue,
vlonin n'shpirtin e tij hove të zjarrta,
për kombin shqiptar vepra me ndërtue.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)



Prena (Ana) Pervizi (1900-1977)
Nana në moshën kur u internua
32 vjet internim

)

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

III

Dasme e madhe u ba n'at shpi kreshnike,
që kishte njoh beteja dhe lavdi,
shpesh u dogjën ato kulla historike,
prej hordhive t'pushtuesit osmanlli.
Grueja e një ushtaraku shum të lavdishëm,
që mënjëherë iu imponue kombit shqiptar,
jetove midis njerëzve të dijshëm,
qytetnimin njohe t'Evropës mbar.
Kur erdhi koha të lindësh fëmijë,
atje në mal të Skurajt burri të nisi,
tradita duhej t'ruhej n'at shtëpi,
ku lind kishin stërgjyshët e atij fisi,
duhet të lindnin edhe djemt e tij,
si degë t'forta n'trungun e një lisi

IV

Atdheu po kalonte vështirësi,
çakej të tërbuem sulëshin nga çdo anë,
anmiqt shekullor në Jug e Veri,
e përtej detit italianët breshkamanë.
Kërkonte Sllavi që të zgjaste dorën,
për me gllabërue trojet e Shqipnisë,
hesapet pa hanxhinë ata ndermorën,
shqiptarët i dolën zot historisë.
Heroin e Kombit, Bajram Currin trim,
bashkë me Prenk Jakun, dhe miq të tjerë
prite e përcolle me të madh nderim.
Planet ata duke hartue përherë,
serbët me i përzanë me force e luftin,
trojet tona mos me shkel kurrnjëherë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

V

Ishte një kohë heroizmi e burrnie,
kur vinte shpesh Muharrem Bajraktari,
me miq të tjerë, fort u kishte hije,
si Fiqri Dinja dh'Hysni Demë luftari.
Të tillë burra nderonte shum Shqipnia,
patriote të shquem, kapidana me namë,
për ata do të shkruente historia,
shtetin e ri me forcë kishin rimkambë.
Ahmet Zogun prite n'at banesë ti vetë,
kur Preng Pervizin vinte me takue,
rrethanave t'randa zgjidhje me u gjetë,
anmiqt e kombit për me përballue.
Me Nanë Mbretneshën shpesh kish bisedue,
se si me ua hequn grave ferexhetë.

VI

Përparonte Shqipnia plot mbarësi,
tue ça detin e historise krenare,
e njohun në gjithë botën si mbretni,
me në fron Mbretin Zog të parë.
Nga politika u ba lamsh njerëzimi,
shtetet e vogla viktima të para ranë :
plane demoniake po thurte Mussolini,
për me gllabërue Ballkanin të tanë.
Me krijue donte madhshti përandorake,
si në kohë t'romakve e sulmoi nga deti,
si baloz i zi, me forcat ushtarake,
në Durrës u duk se kishte ra tërmeti.
N'at shtat prillin e zi të pa nafakë,
Për Shqipninë e mjerë ndodhi kjameti.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

VII

Gjëmoi deti dhe qielli i krejt Shqipnisë,
nxi me luftanije dhe plot balona,
kishte sulmue fashizmi i Italisë :
prej radiove ushëtiu n' botë jehona.
Tre dit ma përpara vlonte hareja,
lindun na kishte princi trashgimtar ;
lajmi i pushtimit ra porsi rrufeja,
u largue mbreti me disa oborrtarë.
Mbeti vendi pa udhëheqje e ushtri,
dy orë zgjati në Durrësin qëndresa,
luftoi si luani një kapter i ri,
dhe ra si deshmor prej armve të pabesa :
Mujo Ulqinaku mbeti n'histori,
E lartë ishte trimnija e tij edhe besa.

VIII

Përjetove nanë këtë tragjedi,
me gjithë popullin patriot korçar,
mbi ballkon valoi flamuri kuq e zi,
dy muej mbeti aty një simbol krenar !
« Autoritetet » erdhen me të thanë :
« Zonjë e nderueme, duhet heq flamuri ! »
« Hiqnje po t'guxoni » - u gjegje nanë,
« me dorë të vet e ka vendosun burri ! »
Nuk ja mbajti kujt flamurin me prekë,
deri sa u kthye komandanti trim,
përciell kishte Mbretin n'shtetin grek ;
urdhën kishte marrë prej tij për kthim.
Ora e Shqipnisë tashma kishte vdekë !
Atdheu nën fashizmin ra në pushtim.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

IX

Agoi dita e lirisë u çuen shqiptarët,
Bashkimin Kombtar n'Mukje me vendos.
N'shtëpinë tande mblidheshin atdhetarët,
për ktë çeshtje të shenjtë me ba çmos :
At Anton Harapi, Mehdi Frashër Beu,
Fiqri Dine dhe Gjeneral Permeti,
me Hysni Demën dhe Cen Elez Ndreu,
Muharrem Bajraktari etjerë pas veti.
Aty Lef Nosi, e frati Pater Leka,
dh'oficera tjerë të gjithë madhorë,
për ta duke shtrue si darka dhe dreka,
tregove grue burrneshë e zojnore.
Por Shqinisë besa i kishte ardhun deka :
kurdiseshin për të plane tradhtore !

X

U tradhtue Shqipnia n'Teheran e Jaltë,
« Aleatët » të pabesë si gjithmonë,
e braktisën krejt e lanë në baltë,
komunistët përkrahen për t'keqen tonë.
Nuk mjaftonin bombardimet gjermane,
mbi shtëpit' tona sa gjyle u lëshuen ;
barbare veç erdhen forcat partizane,
kullat i grabiten, dogjën e shkrumuen.
N'malet e Kurbinit gjete strehim,
bashkë me vjehrrën e dy djemt e ri,
prej bishës komuniste me pasë shpëtim :
Populli ju mbrojti me besnik ni.
Ma vonë ju deshti me kërkue dorzim :
ne burg ju pllakosen, në kamp të zi.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

XI

Me radhë i more kampet e Shqipnisë
prej Lezhe në Berat der n'Tepelenë
me vjehrrën tande në moshën e pleqnisë,
me shumë familje tjera mbyllun mbrendë.
Gjomarkaj, Bajraktari, Dema, Dine,
Marashi, Sokoli, Kolaj dhe Ndreu,
prej çdo vendi verior prej çdo krahine :
një krim të tillë nuk e kisht pa dheu !
Uria, sëmundjet, t'ftohtit dhe mundimet,
ju katandisë në viktima t'shkreta,
vit mbas viti pllakosën internimet,
vdiqen n'ato kampe mija veta.
Mbi ty ranë vazhdimisht shqetsimet,
në të randa vuejtje t'kaloi jeta.

XII

N' Portopalermo t' mbyllen në kala,
n'atë shpellë e sketerrë ty të pllakosën,
me shumë viktima, pleq fëmijë e gra.
Një ditë disa oficera të llafosën :
« Zonjë e gjeneralit, burrin vall pret,
t' vij me nëndetse ? Do t'turrëshe si era,
që t'ikje me atë anije nëpër det… ! »
« Gaboheni fort, zotnij oficera ! »
« Nuk i braktis askurr unë djem e mij,
n'dorë tuej me i lanë me u torturue,
nuk mund t'ketë për mue tjetër lumtuni ! »
Mbetën ushtarakët krejt të hutue :
« Hak na dha pergjigjeë Se ka n' Shqipni,
grue si kjo krenare s'kemi besue ! »

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

XIII

Në kampet të thrrisnin, zojë e gjeneralit,
dikush të drejtojej edhe zoja Prenë,
Të thrrisnin t'internuemit n'emën t'djalit,
Nanë e Valentinit, n'Berat e Tepelenë,
Valentinin e kishe fëmijën e parë
me të ti kalove atë jetë të mjerë :
akademik edhe oficer krenar,
burgjet dhe kampet përballoi me nderë
Nanë e Gencit të kan quejtë ma vonë,
tridhjetvjet burgje e kampe Genci i mjerë,
për aviator kishte mbarue në Rome.
Pastaj, nanë e Lekës, t'thirrnin ngaherë,
ky ma i vogli, me ty pat mbetun gjithmonë,
me pikturë e shkrime merrej përherë.

XIV

Tridhjetëtre vjet kalove n'internim,
bashkshorte e Gjeneralit e fajsueme :
njohe vetëm vuejtje e të madh mjerim,
urdhën kishte dhanë partia e mallkueme !
Gratë edhe vajzat e nuset e reja,
tek ti gjenin një mbrojtje veç nga dhuna,
shumë prej tyne kishin mbetun të veja,
shumë pa fëmijë, të mjera e kërcuna !
Ishte një ditë prilli, e një prilli të zi,
kur prej nesh u ndave ti për përherë,
erdhën t'internuemit të gjithë për ty,
për të përciellun plot respekt e nderë
Simbol ishe për qëndresë në Shqipni,
do t'kujtojnë bashkvuejtësit kurdoherë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

XV

Tani pas kaq vitësh larg në mërgim,
mendimi shkon tek ti, moj nanë e shtrenjtë,
si një andërr e bukur, si një vëgim,
për gjithë jetën time mbetesh ti e shenjtë.
N'ato kohna të kobshme të dënimit,
ishe ti kurajo e forca shpirtnore :
gjithmonë e pamposhtun, një grue e guximit,
që s'përfillje fare shtypjen mizore.
Para teje xhelatët ulnin sytë,
t'mposhtun prej asaj sjellje fort krenare :
e ndienin veten keq edhe të ndytë,
aq spikastey krenaria shqiptare,
që rrezatonte porsi një rreze e yjtë
n'ato të mynxyrta kampe llahtare.

XVI

Me pluhun mbulon koha gjithë kujtimet,
fytyren tande asgja s'mund ta mbulojë,
ripërtërihen në mendje gjithë mundimet,
që me vite të tana përballoje.
Ditët e f'minisë çfaqen tash e parë,
kur lumtunia n'mesin tonë qëndronte ;
ishin dit të bukura, kur e pandarë,
mirëdashsia amore veç me llastonte.
Peshoi randë mbi ne padrejtësia,
jetën na mohuen, na mohuen lirinë,
u dënue nga terrori pafajsia,
dashnia jote e përballoi lemërinë,
u thyen prangat mizore, u mposh flliqësia
e ruejte t' pa cenueme krenarinë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)



Nana, një vjet para vdekjës, Pluk 1976.
32 vjet internime.
(foto 1976

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

XVII

Atje në një vorr të vetmuem po pushon,
larg atij bashkëshortit aq të vyeshëm,
në gishtin tand një unazë arit ndriçon,
simbol i atij bashkimi të pathyeshëm.
Do t' vij një kohë t'bashkohi përsëri,
atje në ato vorreza ku pushojnë t' parët,
do mblidhen eshtnat anëmbanë n'Shqipni,
tretun qëllimisht nga xhelat barbarët.
Gjyshja e degdisun larg në Tepelenë,
ndoshta vorri saj humbi e nuk u gjet ;
eshtnat e djemve t'tu kanë marrë dhenë,
njëni n'Myzeqe, tjetri në kurbet :
miset e burrit ne Belgjikë po flenë,
presin që të kthehen n' Atdhe të vet.

XVIII

Paska qenë shkrue për ne një fat mizor,
me fije të padukshme duke u tjerrë,
përjetuem llahtar, përjetuem terror,
përdhunisht na pllakosën në skëterrë.
Ishe shpresë n'at ferr, ishe shpëtim,
guximtare, e pamposhtun shum fisnike,
me shpirt sakrifice e me durim,
s'u trembe kurr, s'u ligshtove prej frike.
Na jepshe ti kurajo për me qëndrue,
n'at vend ku qëndresa kishte humb fare :
« Do t'vijë dita, që kemi me shpëtue,
drejtsia – thoje - do dali ngadhnjimtare,
mbi t'keqen e mira ka me fitue,
ka me triumfue për'sri mbi botën mbarë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER (2018)

XIX

Shkelqeu dita e fitorës të së mirës,
lumenj njerëzish me pishtarë t'lirisë,
shemben ato muret e prapështirës,
rivendosën themelet qytetnisë.
Nuk je e pranishme në mjedisin tonë,
për me shijue simfoninë e ngadhnjimit,
që madhërisht mbi botën ban jehonë,
n'zemrat dhe në mendjet e njerëzimit.
Nuk je ma krijesë ti, thjesht tokësore :
shpirt n'hapësinën e pafundësisë,
na veshtron e na ruen nga lart, qiellore,
me dashuninë e nanës ndaj fëmisë.
Je ma e madhja mirësi njerëzore,
je veç shprehja e përkryeme e dashunisë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Gjuliana Pervizi (Beba)
Vërmosh, 1948
Ajo mori emrin Beba ne Kampin e Tepelenës
si fëmijë që i shpëtoi vdekjës
42 vjet internim – dëbim

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

BEBA

I

Nga mendja nuk më hiqet ajo ditë
kur m'dole para porsi një zanë mali,
engjëll ngjaje ti prej qiellit zbritë,
aq krijesë të bukur Zoti t' fali.
Ishte një dit' maji, qeshte pranvera,
m'erdhe pranë e hirëshme si përri,
flokët e zi valëzues t'i shprishte era ;
shtangun kisha mbetun dhe gjuha mpi.
T'vezullonin sytë si yjet e qiellit,
e mahnitun dukej vetë natyra :
anderr ishe ti a thjeshtë një vëgimë
Aq të ndriste e bukur ajo fytyra
sa venitej fare dhe drita e diellit :
e zemra ime shkrihej në mallëngjim.

II

Nga shkumba e detit thonë se kishte dalë,
Afërdita, perëndesha e dashunisë,
bija e Zeusit n'Olimpin zot i parë,
në kohnat legjendare të njerëzisë.
Ti nga ajo shkumbë nuk u përftove
veç bukuria jote shqelqeu si rreze dielli,
dhe nëse jetë të trishtë ti përjetove,
ngjaje sikur ishe pikë prej qiellitë
Ndrite si ylli i mëngjesit në jetën time,
porsi Afërdita, që në shqiperi thuhej,
ose Venusi në atë gjuhën latine,
që e skalitun nga Praksiteli n'sbekuj ruhej.
N'se jeten kalove n'vuejtje e mjerime,
bukuria jote askurrë s'do shuhej.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

III

Kur më kishte pllakos fati mizor,
Në mes asaj të tmerrëshme skëterrë,
M'u shfaqe para si vëgim hyjnorë
Në zemër time ai çast mbetët përherë.
Cilido njeri ty rrugën ta lëshonte,
Kur si engjëll kaloje plot hijëshi,
Kush të shihte, i mahnitun t'admironte,
Për ato sy t' ndritun, e bukur, perri.
I heshtun rrija aty fare pranë teje :
Fort me rrihte mue zemra pa pushim,
As një fjalë nuk mundja për me thanë,
Thue më kishte godit shkrepje rrufeje.
Aq fort në ty dashnia më kishte zanë,
Nuk dija n'se i çuet isha apo n'andrrim.

IV

Do kalonin vitet por jo dashunia,
që per ty ushqeva gjithë një jetë,
bota mund të shuhej dhe njerëzia,
por jo kurrë ajo ndjenjë e vërtetë.
N'zemër time mbetësh ti përore,
si n'at' ditë maji kur per her' të parë
ti u duke aty porsi krijesë hyjnore,
prej atij çasti mbetëm të pandarë.
Jeta të përplasi ndër mundime,
njohe ti ç'ishte ajo sketërra,
ku kërthiqe e njom' kapun pas gjinit
përfundove ti ndër gjemba e ferra,
e u rrite nëpër kampe dhe mjerime,
ku veç endëshin përbuzat e vërtinit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

V

U nxi qielli i botës dhe i Historisë
nder lufta t'kobshme popujt kacafytë.
U nxi dhe qielli i të gjithë Shqipnisë
kob e mizori na panë veç sytë.
Të llahtarshme u sulën diktaturat,
mbi të pafajshmit duke ba kërdi.
Çfarosën popujt, gratë, fëmijët e burrat,
thëror tuj ua flijue idhujve te rij.
Idhuj gjakatar, Stalina, Hitlera,
diktatura t'egra plot me parime,
naziste, komuniste, krejt antinjerëzore.
Dolen Pot Pota, Çausheska edhe Envera,
mbi popujt e shkretë duke ba krime,
tepër të përbindshme dhe mizore.

VI

U rrite ndër kto kobe, vajzë heroinë,
krenare, e pamposhtun, guximtare,
e ruejte t'pa cenueme bukurinë,
prej bishave me huqe grabitqare.
Si trëndafil që mbin n'gëmush të ferrës,
dhe nëpër gjembat rritet, del në dritë,
ashtu veç dole ti përmes skëterrës
me hijëshinë tande njerëzit tue habitë.
Me dhimbje thurën këto vargje t'vona,
pas kaq vitësh heshtje, frike e tmerri,
ty të kushtohën moj vajzë legjendare,
Ka me u përhapë e tyne vepër jehona.
Si engjëll shpëtove prej atij ferri,
tue ruejtë hyjnore të bukurat tipare.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

VII

Me ankth, me brengë, me dert e lot,
mbushën mbresat tona ndër kujtimet,
për një jetë të humbun që shkoi kot,
kur na u grabitën përdhunisht gëzimet.
Ish një kosë katile, kosë mortore,
ajo që me bar t'thatë kosiste lulet :
sa e sa lulet t'bukura, lule bore !
Një kujtim i trishtë që kurr nuk shkulet.
Moshatarët e tu, si kerubina,
ndër kthetrat mizore mortja rrëmbeu ;
kumboi e sa nan'zezave lemëria !
U rënqethën male dhe lugina,
vorre, vorre u gërmue mbar dheu :
përpëlitej n' bark të nanës fëmia !

VIII

Prej stuhive t'prap'sive njerëzore,
ishe përfshi në moshën e pafajsisë ;
të rrembyen ato kthetra mizore,
që nuk kursenin as jetën e fëminisë.
Telat të rrethonin, ferra çeliku,
varun për pas gjinit t'nanës s're,
t' quenin edhe ty këlyshe anmiku
fajtore se prej 'i babe kishe le.
U rrite tue mos njohun ç'asht liria,
bashkë me pafajsisnë ajo vorrosë ;
fort e llahtarshme ra mbi ty egërsia,
moshatarët t' tu, tuj pre në kosë.
Ndër këto tmerre u denue pafajsia,
diktatura kështu kishte vendosë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

IX

Një skllave ishe mes skllavëve mizëri,
në fushat balturina tue punue :
në një grop ‘ me gjarpnin ujin tue pi,
flaka e diellit l’kurën tuj të përcllue.
Qysh kur lindte dita dhe binte nata
kërrusun për mbi bel tue hap hëndeqe,
rrije n’ato lluca me gra të ngrata :
urdhën kishte dhanë partia përdreqe.
Nanë u bane shpejt, një nanë krenare :
djemt i rrite ti, të fortë si azgana,
edh’ e pamposhtun kurrë, nuk pyete fare,
se mbërthye të kishte si ndër dana,
diktaturë mizoreë Fort guximtare,
ball i bane asaj për vite të tana.

X

Bukuria jote kishte marrë dhenë,
rrotull të vinin disa lakmitare,
xhelatët ty mir ta kishin ba benë,
për qëllimin e tyne grabitqare.
Porsi Zanë e malit fort inatosun,
këto katila t’ eger i shitove,
mbeten ata veç si te perdhosun :
me qendrimin krenar krejt i dermove.
Me zemër fisnike, besë e nder,
grue ti burrneshë; si shpatë vringlluese.
Fjala jote ra si rrufé përherë
Tue përmbysun ato jena gllabruese.
Nuse e re shkue kishe ti n’atë derë,
Që s’kishte njohun kurr sjellje poshtruese.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

XI

Mes një dimni të madh, kallkan mbërthye,
qëndronte krejt pa shpresë jeta shqiptare:
si nje shpatë vrastare për mbi krye,
regjimi kish vendos ligje barbare.
Të drejtat e njeriut, universale,
ishin mohue krejt, shkelun mizorisht.
O Zot, këta përbidsha pse s'i ndale,
që i mundonin t'pafajshmit porsi Krisht !
Në k'të skëterrë që mbillte lemerinë,
me pranga na kish lidhun diktatura.
Jetën na rrëmbeu, na rrëmbeu rininë :
kockat kishin mbetun edhe lëkura.
Terrori i kuq po bante batërdinë,
tue mos kursye as gra, as fëmijë, as burra.

XII

Porsi ajo anije mes detit tallazor,
me ato vela të shkyeme shkon, përplaset,
por drejtimin e mban ajo peror
shkrepave u largohet e nuk u qaset,
ashtu dhe ne u shkapetem nëpër motët,
timonin tue mos e lëshgue kurr prej dore,
ç'ka se gjaku rridhte, rridhnin lotët:
veç për me i shpëtue dhunës mizore !
dh'erdhi koha që t'agonte liria:
u shëmben idhujt, përbindëshat mizorë!
Prej tyne qe e denueme pafajsia,
t'mallkuem në historinë mbetën peroi.
Llahtarue prej sish ishte njerëzia,
Për një gjysmë shekulli t'gjatë kohor.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

XIII

Vitet e llahtarit lanë plot mbresa,
n'zemër e në mendje t'çdo njeriu,
por mbi t'gjitha fitoi nderi e besa,
dhe per ata që vdekja na i perfshiu.
Me bukurinë tande fort krenare,
moj trimneshë e re kurr nuk u ligshtove,
gjithmon' mbete e vendosme, luftetare,
stuhitë e njëpasnjëshme perballove.
Dhe kur mbi ty kanosej egërsia,
për me të gllabrue me kthetrat mizore,
e patundshme rrinte vendosmënia,
nuk pyesje ti per bishat aq gjaksore :
e pa prekëshme mbetej bukuria,
që Zoti vet' kishte qëndis' me dorë.

XIV

Emni yt « Beba » do t'mbetet lëgjendar,
me u përmend gjithmon sa të jetë jeta,
qysh n' Tepelen', ku f'mijët moshatarë,
si miza vdiqen e lan' nanat e shkreta.
Me at' emën përmblidhej nje histori,
që përjetëson t'rënqethshme mendime
, do t'kalonte koha dh' emni përsëri,
do t' përmendej për me ringjall kujtime.
I bukur tingëllonte kur shqiptohej,
sepse përmblidhte mosh'n e pafajsisë,
ashtu do t'mbetej, kurr nuk do t'harrohej.
Dhe kur jeta t'merrte rrug'n e pleqnisë,
emni do të jehonte plot me shpresë,
si mbresë e paharrueme e fëmijnisë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

XV

Atje në Tepelenë, n'at kamp tmerri,
pa dal drita mirë, çanga kërciste,
« Apeli ! » si lugat Selfo kapteri,
emnat duke lexue, çirrej, bertiste.
« Beba » ty të thrriste një kamp i tanë,
por n' listen e zezë ndryshe ishte shkrue,
aty emni i vertetë dilte « Julianë » :
e egra diktaturë nuk t'kish harrue !
N'krah të nanës gjorë strukun përherë,
duhej paraqit te kapter xhelati
« këtu ! » përgjigjej nana, « këtu ! » dy herë,
sepse e denueme dhe ti ishe nga fati,
e degdisun keq n'at kamp skëterrë,
ku të kishte pllakos shtet malukati.

XVI

Si kafshë grabitqare rrinte partia,
mbi çdo përson gati me sulmue :
trishtohej burri, grueja dhe fêmija,
kush radhën e kishte me u denue.
Në një natë të kobshme ty të thirren
« Beba, para popullit ti me dalë,
llogari me dhan' ! » të shanë, t'u çirren,
« ai emën Julianë, prej nga doli valë ? »
Anmike ty të quejtë,n t'demaskuen,
bij e një far tradhtari n'arrati,
me shpifje e gënjeshtra të mbuluen,
fer s'ta bani syni, gjithë kjonari,
shpifjet i hodhe posht' që kin kurdisun,
me guxim të madh, plot fisnikëri.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

XVII

Mbetën njerëzit krejt të lemerisun,
ç'ishte ky lloj teatri, kjo komedi,
Beba me mendjen krejt të çakërdisun,
kishte friken mos kthehej n' tragjedi.
Emni i ri « Juliana » ish në çdo gojë,
populli nuk po merrte vesh asgja,
ah ! moj Beba e shkretë, me ty u ba lojë,
që t'ulish kryet e të mos bajsh me za.
Por qe besa si femën vërtet trime,
s'deshte të ia dish për demaskim,
dhe me kokën lart s' pyete për mashtrime,
kurdoherë trimnisht mbajte qendrim,
djemt e burrin pranë në kto shqetsime,
ti jetën përballove me guxim.

XVIII

Nuk merrte fund jo kurr përsekutimi,
që si shpatë mizore varej mbi krye,
i tërbuem vërdallë vjen sigurimi,
çdo qëndresë t'vendosun për me thye.
Femijën nandëvjeçar ta torturojnë
me mjete ma mizore tue e mundue,
familjen mir po duen të shkatërrojnë,
për çdo ditë e natë duke e kërcnue.
Sikur shqipe mali që çerdhen mbron,
ashtu Beba e kampëve mbron shtëpinë,
me ia prek fëmijët kush nuk guxon,
si një shqiponjë ajo e shpreh trimninë,
fjala e saj e flakët të përvëlon,
s'pyet për Sigurimin as për partinë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

XIX

Përse u krijuen kto kampe kaq mizore,
e kush ishte ai me mendje aq sadiste,
si bagëti me ndry qenie njer'zore ?
Bota kishte marrë të tatëpjetën,
qysh në Teheran dhe n' Jaltë ma vonë,
ku « Përenditë e Luftës » ujdinë gjetën,
me e nda rruzullin mbarë në dy zonë.
Stalini mustakosh dhe i madh xhelat
Zeus atje në Kremlin – Olimp i ri -
mirë e kish mashtrue Rusveltin sakat,
Evropës për me i vu n'Berlin kuii'
Mesdheun donte Stalini e s'pati fat:
Çurçilli nuk e la me prek Greqinë,
Ku menjëherë çoi anglezën ushtri.

XX

Nuk pyeti kush për t'bukuren Shqipni !
Si skllave n'treg e qitën për ta shitë :
komunizmi mizor erdhi në fuqi,
errësinën mbolli aty ku kish dritë.
Krime u kryen të rënqethshme gjakatare,
kosa e partisë nuk kursej dhe lule,
pamëshirë, njerëzit qiti fare,
e ktheu vendi në vorr, n'kufomë kërbule.
Porsi lubi t'mbërtheu dhe ty kërthiqe,
të përplasi në kamp, n'at fetr të zi :
shpëtove kot nga gjith' ato rrëzigje,
viktima le mbrapa, qindra fëmi.
mrekulli ishte ajo q'aty nuk vdiqe :
në qiell për ty mendonte 'i Përendi.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

XXI

Sot, mbas kaq vite, atje ku mbretnon liria,
Madamë Gjuliana t'thrasin me nderë,
akoma nuk asht zhdukun lëmeria
që n'zemër t'kish hy qysh fëmijë aherë.
Emnin e bukur Beba kudo ndigjon,
i përket ai një femne fort krenare,
gjithkund ku paraqitesh të nderon,
dhe n'rrethet ma të mira qytetare.
Mbas kaq vjet, të vona kto tingëllime,
në medje bluejtun, tani veç gjejnë shkrimë
të pa ndamë ne ishim ndër sa mjerime,
për me u kuptue mjaftonte një shikim :
dashunia na shoqnoi, patëm gëzime,
Zoti, tre djem na fali, si dhurim.

XXII

Një dhuratë, unazë a gjerdan florinit,
dhuratë të çmueshme, s'munda me t'dhanë,
një varëse arit, me t'zbukurue gjinin,
nuk t'bleva gjatë një jete të tanë !
Një lule, gonxhe trendafili të kuqe,
nuk t'solla njëherë në jetën time,
sikur të vogël fare, një burbuqe,
që të buzëqeshje ti me plot gëzime.
Si nji tufë lulesh, t'kushtoj kto poezi,
mes tyne ndonje varg me shum shkelqim,
i mblodha gjat' kohës me dashuni,
qe t'mbeten n'zemrën tande si kujtim,
si një dhuratë e çmuar, ma se flori :
me ato të kam dhurue gjith shpirtin tim.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Gjeneral Prenk Pervizi
Skuraj 1897- Jolimont 1977
(Foto, Tiranë, 1943)

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

GJENERALI

I

Atje ndër ato malet e Kurbinit,
ku ende jehon kushtrimi i Skënderbeut,
ku luftonin çetat e njatij Gjinit,
kundër pushtuesve, për liri t'Atdheut,
n'at' Skuraj të lavdishëm plot legjenda,
mes zjarrit të kryengritjes patriotike,
linde n'ato kulla krenare, brenda,
ku farkëtoheshin ngjarje historike.
Orët e zanat të qëndronin pranë,
me ty mor vogëlush duke lodrue,
fatin të caktonin, jetën të tanë,
që ndër vite do t'shkonte tue u zhvillue ;
fort emni yt do t'shquhej anëmbanë :
Atdheut jetën do i kishe përkushtue.

II

Akoma në shpërgaj, foshnje kërthiqe,
n'kurriz t'nanës more shtigjet e malit,
mes pyjeve e shkrepave plot rreziqe,
për me i shpëtue anadollak vandalit.
Dh'erdhi dita kur vet Gjin Pjetri u çue,
Synin ta vuni mes f'mijëve të tjerë :
« Frrok – i tha prindit tand – kam mendue,
n'shkollë m'e nis Prenkën menjëherë ! »
I rrebt ishte prindi yt e trim dragua :
« Mos me pyet or Gjin t'tjerërherë,
n'daç hidhe n'zjarr, n'daç n'ujë m'e lshue,
Zot je i shtëpisë, ti vendos n'kë dere ! »
N'shkollë Gjin Pjetri vetë të ka shoqnue :
për ty një vogëlush ishte i madh nder !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

III

Fort po gjimonin malet e Kurbinit,
thue një stuhi e madhe kishte shpërthye,
s'ishte e motit gjama, veç çetat e Gjinit,
fyt për fyt me turkun duke u mbërthye.
Gryk's Urdhazës topi idhshëm po kriste,
e frikshme hapej malevet ushtima,
krejt i tmerruem pashaj turkisë bërtiste :
« Topa vallë do të jenë a bubullima ? »
Shkreptinin armët shqiptare si rrufeja,
rridhte uj' Urdhazës kuq me gjak nizami,
gjak nizami rridhte poshtë rrekëja.
Mbi hordhitë osmane po bahej nami,
aq e zezë për ta ish kthye beteja :
s'u kish mbetun as nam e as nishani !

IV

Kur agoi madhshtore dita e lirisë,
burrat e Kurbinit, luftarë të shquem,
mbas Gjin Pjetrit lshue, si vrull' i stuhisë,
në Milot flamurin kuq e zi naltsuen.
Shpërthej fjala e kryetrimit porsi flakë,
ndezi zemrat e Kurbin'sve patriotë :
« Burra t'Arbënisë, në Vlonën plakë,
shpallet Pavarësia jonë në botë !
« Rroftë Shqipnia ! » – thirri – dhe gjashtë here
qiti me rëvol', ty t'kish për bri,
Treqind pushkë kan krisun përnjëherë :
pesëmbëdhjet' vjeçar ishe, krejt i ri.
Ma i madh dukej Gjini se kurdoherë,
bashkë me të trohyne o' histori.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

V

Në Shkodrën krenare shkollën vazhdove,
n'mësime duke u shque si kurrnjëtjetër,
me Gjergj Fishten dhe Mjeden ti mësove,
Gurakuqin, Kamsin, Mosin e vjetër.
Por një kob i zi ra mbi tan Kurbinin,
Gjin Pjetri luftëtar e plak i parë,
ndërroi jetë, shumë ia nderuen kujtimin,
i madh dhe i vogël mbetën duke qarë.
Aty u gjende ti dy lot me lshue,
për axhën që t'pat nis në rruge t'arsimit.
Atdhetarët rreth tij ishin tubue,
përshendetjen e fundit me i ba Gjinit.
Vajtoret ma të mira duke e vajtue,
lavditë duke përmendun të kryetrimit.

VI

E kobshme n'Sarajevo revolja krisi,
flakën ia dha barotit të Ballkanit :
lufta e madhe botnore shpejt ia nisi,
tmerr duke i kallun, të madh, evropianit.
Kufijt krejt u mbyllen, mbaroi dhe shkolla,
n'pritje atje në Skuraj ti po qëndroje.
Fati i tirrte fijet tepër të holla,
Atij, për me i shpëtue nuk mund t'guxoje.
N'kasapane u hodhën ushtritë anmike,
në t'pergjakshme beteja kacafytë,
faqe t'zeza shkruheshin historike,
me miliona njerëzit duke u mbytë,
popujt t'llahtarisun krejt prej frike :
vazhdoi për katër vjet kjo luftë e ndytë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

VII

Trimni tregove shpejt të pakundshoqe,
për në Vienë t'Austrisë për m'u nisë :
shum u rrezikove e shum veç hoqe,
për me mbajtun besën e miqsisë.
Tre të huej, austriakë, t'kerkuen shpëtim,
n'dorën tande ranë, tue t'njoftë fisnik,
për n'Austri me u kthye me shumë nxitim,
në një rrugë t'veshtirë e plot rrezik.
Fatit para i dole shum guximtar,
dhe të shoqnuem me burra t'armatosun,
kaluet t'gjitha pëngesat ju për mbarë,
ne vend te dëshiruem duke sosun :
për tre miqt austriakë, ti shpetimtarë
N'Vienë ata të çuen siç ish vendosun.

VIII

Në kryeqytet t'madhes përandori,
n'Akademinë ushtarake u pranove :
ndoqe studimet me vëndosmëni,
medalje e lavdërime aty fitove.
Lidhe miqsi edhe me shumë shqiptarë,
studentë dhe burra shteti t'pranishëm :
Ahmet Zogun zune mik të pandarë,
ndër gjithë të tjerët ai ma i lavdishëmë.
Një miqsi që rritej e do t'forcohej
e shum e vlefshme do ishte për Shqipninë.
Atdheu për këta njerëz do t'krenohej,
e do t'u a shkruente të bukur historinë.
Përandoria austro – hungare asgjesohej
në at' vit kur ti mbarove Akademinë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

IX

U ktheve në Shqipni plot hove t'reja,
me Ahmet Zogun n' Durrës u përshëndete.
Në Skuraj u ndez dasma dhe hareja,
nusja po të priste pas katër vjete.
Prena, quhej ajo një vajzë e re vendi:
në Rrëshen t'kishte fejue prindi trim,
besnik i kishe ndej atij kuvendi,
martesë në Vienë s'pranove propozim.
Nanë Mrika nuk e përmbante gzimin,
Djali saj tashti ishte burrnue e rritun :
n'Austri kishte mbarue të naltë shkollimin.
Në Skuraj ai qëndronte duke pritun,
vëndimin që do t'i vinte për emnimin,
rreth komandant në Krujë e kishin qitun

X

Ora e Shqipnisë po zgjohej përsëri,
nga koma e pesëqinvjetëve osmanë,
ku lëngoi e pafuqishme nën robni :
shqiptarët u çuen të bashkuem të tanë.
Në Vlonë së pari shpallën Pavarësinë :
valoi flamuri kuq e zi krenar !
në Lushnje patriotët krijuen Shqipninë
u nisën shqiptarët n'rrugën e mbar
Ishe n'atë kohë një oficer i ri,
gati me i shërbye Kombit tand a'bnor,
atje ku të thirrën u gjete me ushtri,
me mbrojt vendin nga çdo sulm armiqsor.
Me çetat shqiptare luftove në veri
me i dëbue serbët prej tuellit atror.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

XI

Legjendare mbetën ato beteja,
me Prenk Jakun dhe Bajram Curr luftarin,
binit ju mbi serbët porsi rrufeja,
duke e dëbue prej trojëve barbarin.
Me bataljon shetitës nëpër male,
vëndoset ju rregullin e qet'sinë,
i zhduket gjithë bandat kriminale,
q'egërsisht plaçkitnin popullsinë.
E kur sulmuen rebelat në Tiranë,
me pushtue qytet'n, me rr'xue qeverinë,
te një pus i vjetër pritën kish zanë,
me do mitroloza u a preve fuqinë,
me trima që çelik brenin me dhambë.
Guximtar ! e shpëtove ti Shqipninë.

XII

E kur me pabesi sulmojti opozita,
me të bukura fjalë e punë të këqija,
dolët ju në mal porsi komita,
n'Beligrad ju pranoi Jugosllavia.
Ish viti njëzetekatër muej qërshor,
mbas Ahmet Zogut shkuet n'arrati,
ti ndër oficerët, shtatmadhor –
shkelqeje mbi tjerët si nj'yll i ri.
Erdhe në mal të Skurajt me pak veta,
lëshove ti kushtrim, ish muej dhjetor,
u mblodhën rreth tejet kurbinas veleta,
drejt Tiranës marshimi u ndermor,
ia mbathën kundërshtar't – kambët e lehta –
u rivendos përsëri shteti ligjor.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

XIII

Katër burra aher kish pasë Shqipnia,
që kurr ma nana nuk përkund në djep,
Ahmet Zogu i çmonte nga zotsia,
detyra të randsishme shpejt u jep.
N'katër zona krejt vendi ishte caktue,
katër kapidana formuen kuadrumvirat,
guvernatorë ushtarakë ishin emnue :
për Shqipninë ishte shum i madh fat.
Prenk Pervizi me qendër në Tiranë,
për përgatitje e rrjedhë të lartë fisnore :
Presidentit Zog veç i rrinte pranë.
Krizat i zgjidhi ai tepër vendimtare,
që të rrezikshme mbi vendin tonë ranë,
me veprime të shpejta fitimtare.

XIV

Katër komandantët e Shqipnisë
vendosën rend kudo, shtetin forcuen,
po përgatitnin ardhjen e mbretnisë :
Ahmet Zogun ata në fron e çuenë
Muharrem Bajraktari n'Lumë i parë,
me Fiqri Dinen edhe Hysni Demen,
miq të tu të ngushtë me fis krenar,
së bashku ju të katër fituet emen.
Kapidana të shquem, trima me fletë,
n'dorë Shqipninë e patët për do vite,
Ahmet Zogu ua dha ktë detyrë vetë,
Shtetin e ri për me qitun në drítë :
s'ishte kjo një punë aq fort e lehtë,
me shokët e pandame në kuvend ia mbritë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

XV

Befasisht në malet e Dukagjinit,
kryengritje e madhe plasi me tradhti,
(rob e zun' komandën e Fiqri Dinit)
me u bashkue Malsia me Malin e Zi !
Kurthën kishte ngrehun mirë Serbia,
me njerëz të pabesë edhe tradhtarë,
me u coptue përfarët gjithë Shqipnia,
krejtas për me u zhduk kombi Shqiptar !
Presidenti Zog, n'mesnatë dimnore,
Po thrret me telefon Prenk kapidanin,
« Ja sot ja kurr ! Vendi po del dore :
patjetër me shpëtue na sot vatanin ! »
Fjalën ia ke dhanë, me krenari burrmore.

XVI

Si një trup i vetëm Kurbini u çue,
te Shtegu i Dhenve arritën vullnetarët,
burrat ti ma trima kishe bashkue,
shkambit përpjetë u ngjitën me litarët.
Krejt armatimet atje lart arritën,
ku kalue nuk kish kurr një malësor,
kryengritesit të rrethuem u topitën,
kur krisma e mitrolozit gjmoi kobnor.
U dorëzue pa luftë e krejt paria,
krenët e rebelimit, para asaj mrekullie :
« Si kish dalë nga ajo humnerë ushtria,
ku nuk guxon të shkeli thundër dhie ? »
Në pallat shkoj përgjigja me pak vija :
« Prenk Pervizi në krye t'asaj ushtrie ! »

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

XVII

Ceno Beg Kryeziu fort revoltue,
midis parlamentit fjalën ka thanë :
« Pren Pervizin n'krye t'ushtrisë me vu
dhe gradën e gjeneralit me ia dhanë ! »
T'tronditun intrigantët nga këto fjalë :
« I ri asht, President, mendja mos i rritet,
gradat le t'ia japim ma ngadalë,
kur të piqet koha e të kalojnë vitet ! »
U mjaftue Zogu me disa levdata,
me falenderime e fjalë të mira,
i dha disa medalje e dekorata,
aq ishin të forta zilia edhe smira,
q'ushqenin oborrtarët tru sakata.
Ti nuk i perfillje ato fundërrina !

XVIII

Kur me bujë u shpall Mbretnia Shqiptare,
dh'anëmbanë botës shkruen shumë gazeta,
katër kapidanat zon'komandarë,
u shkarkuen prej detyrave të veta.
Tashma Mbreti kishte fuqinë në dorë,
lypëshin servile t'i vinin rrotull,
largojti oficerët shtatmadhorë,
për të bredh pas qejfit e ndonni kotull.
Kur Ahmet Zogu i preu kështu në fjalë,
komandantët trima kërkuen takim :
« Që besa Ahmet ti fjalës na i ke dalë,
për reformat që patëm marrë vendim.
Dakord nuk jemi, ti veç mos na fal
që po të shprehim haptas këtë mendim ! »

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

XIX

U tërbuen oborrtarët intriganta,
dhe n'vesh i frynin Mbretit për komplot :
« Kujdes, Madhni, se mbajn' në brez naganta,
e për trima çerpiku nuk u lot ! »
Arratinë morën burrat në dhe t'huej,
për me u largue sherreve oborrtare,
atje ku besa gjaku bahet ujë,
prej mallëngjimit të trojeve amtare.
Nana Mbretneshë fort e mençun zojë,
djalit Ahmet dy fjalë t'urta ia thotë :
« Si kish guxue ato trima të largojë
që ma besnikë nuk i gjen në botë ?
Ndigjo mor bir se nuk asht jeta lojë,
E mos u beso kurr njerëzve të kotë ! »

XX

Prenk Pervizi mori vendim me mend,
shkollën e Luftës në Torino me krye,
me gradën major vazhdojti student,
Atdheut shum ma mirë për me i shërbye.
Kolonel ma vonë u kthyen n'Shqipni,
me detyra të randsishme u caktue :
n'Komisionin Nderkombtar n'Abisini,
vëzhgues për atë luftën që u zhvillue.
Pranë shtabëve t'Badoljos e t'Gracianit,
qëndroi gjashtë muej e mori njoftime,
të Musolinit mori vesh, hartues i planit,
që për Shqipninë kish të kqija qëllime :
do të versulej Duçja kundër Ballkanit,
për të vazhdue marrëzinë t'vet pushtime.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

XXI

Manovra të mëdha mban Italia,
me armatime fort Duçja kërcnohet,
asht e pranishme aty edhe Shqipnia,
e parë ndër delegacionet prezentohet.
« Jeni popull trim ! » - thotë Musolini.
« Por i vogël fort ! » - ia pret shqiptari :
« Të madh ne do ta bajm ! Ju mirë ta dini »
« Ne na mjafton siç asht ! » - Gjegj komandari.
Dy herë te Mbreti Zog hyn oficeri :
« Ahmet, mbrojtjen ma jep t'Atdheut tonë ! »
Mbreti po e vështron si fort për seri :
« Me Italinë miqsi kem përgjithmonë.
Prej italianve nuk na vjen kurr sherri ! »
« Mbret, mendohu mirë sa nuk asht vonë ! »

XXII

Me shtatë Prill u nxi qiell'i Shqipnisë,
si prej termetit gjithë vendi u trondit :
fronin braktisi Zogu të Mbretnisë,
në Qafë Thanën me vetura u ngjit.
Tre dit Leka i vogël qante për gji,
nanë Gjeraldina pranë tuj e pajtue.
Kaloi familja atje n'Jugosllavi,
Mbet Mbreti vetëm, veç tuj u menduë
« Hakut, Prenk Pervizi, m'paska dalë ;
oborrtarët e mi më kanë tradhtuë !
Burrë besik e komandant i rallë :
Qysh për ktë punë mos me i besuë !
Në Korçë Kolonelit me i çue fjalë,
Veç ai mundet tashti me na ndihmuë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

XXIII

Korça peshë ish ngritun, qyteti i tanë,
« Armë ! » duke kërkue, dh'armë nuk ka,
radiot po buçasin t'huejat nga çdo anë,
prej Tirane s'ndigjohet as një za.
Komandanti trim fort asht ngushtue,
ushtri s'po ka dhe pa armatime mbetë,
me popullin qëndresë me organizue,
secili me armët e veta e me fishekë.
Tre dit pa lajme mbeti Korça e shkretë,
para postës të mbledhun duke pritë,
Prenk Pervizi aty qëndronte vetë,
don me fillue qëndresën si komitë.
Po na i vjen lajmi : « Mbreti po të pret ! »
Veç ka mbet pa mend, fort asht dhe çuditë.

XXIV

Në Zemblak kish zanun Mbreti vend,
te shpija e Gani Kullës plak i parë,
i njohun për burrni edhe për mend,
një fis fort atdhetar dhe shum bujarë
Përball u gjetën të dy miqt e vjetër,
Mbreti e Prenk Pervizi i madh besnik :
u përqafuen aty si asnjëherë tjetër,
gjendja ishte e randë e plot rrezik.
« Mbret, sa ma shpejt kushtrimin me lëshue,
luftën lart nëpër malet na me ndihmë,
ty të kemi kryetar me komandue,
në ball për me i qëndrue të sot Shqipnisë ! »
« Jo ! se një t'keqe vendit ia kam pranë,
s'due me i sjellë dëmtime popullsisë ! »

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

XXV

Komandanti Prenk fort ish zemrue :
« Oborrtarë t'pabesë dhe intriganta,
a e shihni ju, ku vendin keni çue ?
mbi ju duhet të kriste sot naganta !
T'gjithë ktu meritoni me ju varë,
porsi cironkat'thata, si tradhtorë !
Po t'ju pikasi populli korçar,
ka me u versul mbi ju tepër mizor ! »
« Ahmet Zog vendos, në luftë me pri,
ja sa ma vrik këndejti me u largue,
se populli i tërbuem vjen me na gri,
Ose italianët vijnë me na rrethue ! »
Tronditun foli Mbreti : « Në Greqi !
Komandën merre shpejt me na drejtue ! »

XXVI

Me mija e pasuen Mbretin në Greqi,
atje në Folorinën zuni vend,
pa fron e pa kunorë e pa mbretni,
si peshku n'ranë kish mbetun përnjëmendë
Shurdhët i bani veshët bota mbarë,
mohit i ra Evropa keqas Shqipnisë :
protestat e Mbret Zogut s'patën farë,
humbisnin sikur zani mes shkretisë
Urdhën ty të dha për m'u kthye n'Atdhe
dhe gradat mirë t'i njohu gjeneral :
lamtumirë e trishtë, shkon loti rrëke,
përmallimin e fundit kush s'e ndalë
Mbaroi kështu Mbretnia porsa kish le,
Prej Duçes Musolinit koke bata'l !

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARTIN BARLETI" SHKODËR (2018)

XXVII

Nën zgjedhë fashiste kishte ra Shqipnia,
Atdheun e kish përfshi, i madh, trishtimi.
Në shesh po dilte e poshtër tradhëtia :
shitun disa shqiptarë të Musolini.
Kunorën e Skënderbeut ia çuen Viktorit,
me një turp të madh ata veç u damkosën,
flamurit i vunë shenjat e liktorit :
vetën e tyne përjetsisht përdhosën.
Por e papërlyeme mbetej tanë ushtria :
komandantët shqiptarë morën vendim,
kur plasi lufta andejti nga Greqia,
bataljonet mos me marrë pjesë n'luftim.
Kur iu kërkue Badoljos llogaria :
« Prej shqiptarve e pësuem këtë deshtim ! »

XXVIII

Atje në Berlin u inatos Hitleri :
« Ç' asht or Duçe kjo disfatë n' Greqi ? »
Musolini kur foli rrebtë Fyhreri :
« Shqiptarët na tradhtuen : » tha, surrat nxi.
Në malet e Pukës t'çuen për denim,
me pjesë t'ushtrisë e bataljonët tjerë,
italianët i kish kap i madh friksim,
mos shkatohej prej jush ndonjë poterë.
Parianit ia kishe ba fare t'qartë,
se ushtria shqiptare e pavarun qendronte
me një krenari t'pashoqe të lartë.
Italia me i cenue nuk guxonte,
i kish dalun me shqiptarët fort thartë,
kur në njëzetën n'Vlonë keq e pësonte !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

XXIX

Fatet e luftës u rrok'llisën shpejt,
Musolini na e theu qafën nga fiku,
në Mukje Shqiptarët u mblodhën krejt,
për Bashkimin Kombtar n'ktë çast rreziku.
Tetë shtatori solli kapitullimin,
në krye t'ushtrisë, gjeneral shqiptar,
Dalmacos ia imponove dorëzimin :
Valoi përsëri flamuri ynë kombtarë
Asambleja kushtëtuese na u formue,
me i dalun zot fatëve të Shqipnisë,
prej Kosove n'Cameri atdheu u bashkue,
ty të vendosën n'krye të gjithë ushtrisë :
kufijt etnikë kurr ma mos me i lëshue,
me ia pre krejt turrin lakmiqar Serbisë !

XXX

Në Shqipni gjermanët kishin qëndrue,
vendin tonë neutral veç duke e shpallë,
rrugë kërkonin vetëm për me kalue,
në Gjermani tashma po kthenin dalëë
Konferenca ish mbajtun në Teheran,
mes Curçillit, Rusveltit dhe Stalinit,
botës këta të tre me i gjet derman,
mbas dorzimit pa kushte të Berlinit.
U tradhtue gjithë çeshtja e Shqipnisë,
Aleatët, shqiptarët, i lanë në baltë,
veç shpetuen territoret e Greqisë,
për Evropën lindore u tha në faltë,
t'invadohej prej ushtrive t'Rusisë.
« Zoti ato tradhtarë kurr mos i falrë ! »

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

XXXI

Shpresa të medha lindën për shqiptarët,
me u bashkue në një shtet t'vetëm etnik,
por t'asaj mendje nuk ishin sllav – barbarët,
që politikën n'Shqipni sillnin vërtik !
Partinë komuniste ata kishin formue,
Gjoja në luftë kundër okupatorit !
Komunistët shqiptarë kishin gabue,
Duke u lidhun pas qerres sllav mizorit.
Qeveria kombëtare nga ana tjetër,
me një Këshill të Naltë në krye të shtetit,
prej katër burrash t'urtë patriotë të vjetër,
Kosovën kërkonte të mbante pas vetit,
me fakte konkrete e jo me fjalë në letër.
Shqiptarët po gjendëshin mes sikletit.

XXXII

Prenk Pervizi, në krye të gjithë ushtrisë,
Gjermanëve u doli në kundërshtim :
Trupat SS ata donin me kurdisë,
« Jo , kjo s'bahet ! » tha komandanti trim.
T' zemruem teuton't u prishën me shqiptarët.
Kta në mal shpejt dolën me qeveri,
atje të bashkuem të gjithë atdhetarët,
kërkonin me shpëtue t'mjerën Shqipni.
Hesapët po i banin kta pa hanxhinë,
sepse aleatët me anglezët diplomatë,
i mashtruen ma së miri dhe i përzinë,
vendosmëninë e tyne tue lukatë.
Anglez't donin me shpërblye Jugosllavinë,
Me ia rikthye Kosovën sinjë dhuratë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

XXXIII

Krenar qëndrove n'malet e Kurbinit,
bashkë me anglezët n'orvatje për shpëtim,
i propozove gjeneral Mek Linit,
planin ushtarak për organizim.
Nga ai vesh anglezët fare nuk ndigjonin,
e ma tepër mendonin për kuzhinën,
si ma mirë me ngranje ta kalonin :
shqiptarëve tashma ua kishin kthye shpinën.
I shoqnove n'Skuraj e t'Velës male,
duke i mbrojtun nga sulme e pabësi,
n'kala të Lezhës me ta ti u përfale,
kur vendosën t'largohën n'Itali.
Fisnik burrë njaty hapin e ndale,
edhe u ktheve trimnisht n'tandin Kurbi.

XXXIV

Mbetën atdhetarët si peshqit n' zallë,
t'braktisun nga aleatët n'mëshirë të fatit ;
dikush me ta sikur deshi me u tallë,
duke i lanun në dorë të malukatit.
Ishte ky malukat veç komunizmi,
që duke mohue atdheun dhe Shqipninë,
po çfaqej si regjim kanibalizmi,
mbi vllaznit e vet duke ba kërdinë.
Njëni pas tjetrit u vranë gjithë patriotët,
duke luftue në mal me pushkë në dorë,
rrëke kullonte gjaku, kullonin lotët,
krime po kryheshin nga ma mizore.
Do t'rridhnin ditët, do t'kalonin motët,
E s' do t'pushonin vajtimet mortore.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR (2018)

XXXV

Vriste dhe priste ky shteti xhelat,
Llesh Marashin, Prek Calin, Marka Gjonin
E pësonin të tjerë të njejtin fat :
Jup Kazazi, Lef Nosi me At Antonin.
Nga Gjyqet Speciale pat fillue kërdia,
denime me vdekje, batare ekzekutime,
në vorre po kthehej e tanë Shqipnia,
në burgje mizore, kampe, internime.
Diktatori katil quhej Enver,
sikur e kish krijue djalli vetë,
i denjë për me sundue atje në ferr,
e jo përmbi Shqipni në këtë jetë.
Populli po ia shihte mirë atë sherr :
Shëndrrohej gjaku i krimeve në detë !

XXXVI

Të Skurajve ju male lavdiplotë,
në shekujt kala e pamposhtun qëndrese,
e treguet dhe njëherë ju në botë,
se ruenit tradita burrnie dhe bese.
Ndër juve u strehue gjenerali komit,
me forcat e ndjekjes ai duke u tallë,
që orvatëshin m'e rrethue natë e ditë :
si kuajt në lamë veçse vinin vërdallë.
Hoqën njerëzit tortura e mundime,
pati t'pushkatuem etjerë t'burgosun,
edhe kalamajt pësuen këtonime,
besnikë qëndruen të gjithë e të verdosun.
Shefat e mbrojtjes pësonin deshtime,
të zhgënjyem, të mposhtun e të dregosun !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

XXXVII

Skuraj një fshat malor fshat historik,
që në shekujt përmendet për lavdi,
Gjergj Kastrioti e zgjodhi vend strategjik,
për me sulmue t'anadollakut ushtri.
Vend i Kok Malçit, plakut shum mentar,
që u miqsue me njat Skenderbeg kruetanin :
aty luftoi Pervizi Skura, k'shtjellar,
kur u rrethue prej hordhive të Sulltanit.
Te kisha e Shna Prenës u grit shkolla,
shqip për me lëxue e për me shkrue,
kur Turkia na kish lidhun porsi bolla,
s'donte me lanë Shqipninë me përparue.
Nxore ti Gjin Pjetrin me ato sokola,
që në Milot flamurin patën çue.

XXXVIII

Në pyjet e Skurajt gjete strehimin,
te fisi i N'koll Llesh Gjokës ke zatet,
vërdallë e solle ti gjithë Sigurimin,
kurr n'e kurrës nuk mundën me të gjet.
Nipat e tu trima mbajte veç pranë,
njat Nikoll Pal Gjinin, trimin velet,
trim drague me brejt hekur me dhambë,
njeri pa fjalë por pushka mirë po i flet.
Vellain e tij Ndue Palin burrë besnik,
dhe Ndue Gjergjin të parin ndër luftarë,
që i këndon pushka dhe zani si poet,
me nip Preng Lleshin t'fortin nishantar,
që s' pyet për Sigurim as për anmik :
në kangët do t'kemdohën legjendar.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

XXXIX

Ndër ato malet e Shqipnisë veriore,
kishin mbetun veç katër komandarë,
oficerët ma t'shquem t'ushtrisë arbnore,
burra t'jashtzakonshëm, trima e luftarë.
Në Lumë gjithmonë Muharrem Bajraktari,
n'Dibër Fiqriu e Hysni Dema qëndrojnë,
n'malet e Kurbinit rrin gjenerali,
njena pas tjetrës brigatat vërshojnë.
Vërshojnë brigatat veçse tuj ba krime,
tuj kërcnue njerzit e tuj pushkatue,
ti qëndroje i sigurt n'ato strehime :
vërdallë komunistët si qen t'tërbue,
koha kishte ardhun me marrun vendime,
miqve u çove fjalë n'Greqi me shkue.

XL

Me veprime guximtare e me çeta,
tre shok't e tu kaluen n'Maqedoni,
Në luftime t'ashpra humbën sa veta,
deri sa dolën n'kufi në Greqië
Ti një ushtarak me të madhe përvojë,
me krye vendose aksion me befasi,
ia punove shtetit një taralojë,
Sigurimin të tanë e ke përzi.
Fillikat e vetëm zbrite n' Tiranë,
mes qytetit tuj shkue nëpër pazar,
u takove me disa miq Tiptanë,
Dhe me djemt e tu trima dhe shkollarë.
Ndue dhe Llesh Gziqin miq i kishe zanë,
burra besnikë e Mirditor bujarë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

XLI

Dhjet dit ndejte aty si një mik i rrallë,
kafe, duhan, raki tuj pi me Lleshin.
Në Skuraj komunistët vijnë vërdallë,
ndërsa të dy miqt bisedojnë e qeshinë .
Ishte Genci djali yt fort guximtar,
Llazi Sterjon, shoferin, vrik ta gjeti,
Llazi Sterjo, një trim e besnik korçar :
me makinën atje n'kufi t'zateti.
Pak dit kaluen, flet radioja e Greqisë,
Prenk Pervizi shqiptarët përshendet,
Enver Hoxha me grusht bie skrivanisë,
Prej marazit zen çirret dhe bërtet
Koçi Xoxës edhe gjithë Ministrisë,
llogari u kërkon, shum keq u flet.

XLII

Fillojti jeta jote n'arrati,
me Bajraktar, Fiqri, Hysni bashkue ,
plane duke thur me u kthye n'Shqipni,
regjimin komunist për me rrëxue.
Tani me anglezët miqt e juej të vjetër,
Gjeneral Meklin dh'Amery Julianin,
Përsëri ia niset edhe një herë tjetër,
Si me shpëtue Shqipninë e tanë Ballkanin.
Por politika lozte role t'kuija,
Dh'Aleatët vetë e sabotuen atë plan,
Nuk e lanë Zogun t'vinte nga Greqia ,
Organizimi mbeti pa taban.
Me spiun Filbin nalu sajoe tradhëtia,
Resitenca n'Shqipni shkoi fare dam.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

XLIII

Disa vjet i kalove në Greqi,
një mik të ngushtë atje kishe pas zanë,
i ndodhi atij ma e madhja fatkeq'si,
prandaj t'u desht atë vend veç për me lanë.
Belgjikën zgjodhe për me kalue jetën,
ku Muharremi e Fiqriu kishin shkue.
Por n'Italinë oferta ty të gjetën,
Gjeneral italian ti me vazhdue…
S'pranove kurr të tilla propozime !
Ndërkaq ti, John Kenedit President,
I drejtove mesazh me t'shumta shkrime,
Me Shqiptarë me formue një detashment,
me shqiptarët me krijue një ushtri trime,
Në luftën e Vietnamit për me u gjend.

XLIV

Me mbretin Zog dhe patriotët e tjerë,
u takuet n'biseda zgjidhje me gjet,
por hasët n'kundërshtime ma se 'i herë,
e nuk u arrit marrëveshje e t'vërtetë.
Shqiptarët i kishte zanë amullia,
përçarjet nuk i linin kurr rehat,
u krijuen organizata e partia,
bashkimi i shqiptarve aq e pat !
Me Bajraktarin e me miq tuej besnikë
me biseda kalon koha e mërgimit.
Fjalime mbajte n' festat në Belgjikë,
Që të mblidhën shqiptarët rreth bashkimit,
t'mos coptohën n'shoqata e parti
veç në bashkim gjendët rruga e shpëtimit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MANIN BARLETI" SHKODËR (2018)

XLV

Prind i dashun, mes stuhive të jetës,
kalove si një shqipe fort krenareë
Me flakën e pishtarit të s'vërtetës,
veprat e tua ndriçojnë si lëgjendare,
të shkrueme n'histori me gërma t'arta,
se Zot i dole Atdheut n' koh t'vështirë,
i pajisun me dije e ideale t'larta,
për Shqipninë ti punove gjithmonë mirë.
Atje pushon i vetëm në Belgjikë,
në një vorr të thjeshtë herojsh, përkohor
Patjetër ka me ardhun ajo ditë,
që të ngrihet një i bukur përmerndor,
për ty, nanën e gruen edhe fëmijtë,
burrat e fisit, heroj dhe dëshmorë !

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)



Tre vllaznit
Lek, Valentin e Genc Pervizi,
40-47-42, vjet burgje e kampe internimi.
(foto, Gradishtë, 1970)

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

TRE VLLAZNIT

I

U shtjellue historia e tanë njerëzimit,
me qytetnime t'lashta shekullore,
me popuj ndërtues, përhapës zhvillimi,
siç ishin Pellasgët e rracës arbnore.
Por mbi të gjitha luftat shkatrrimtare,
përmbysen miradinat e krijueme
e korrnin vdekjen nëpër botën mbarë,
me krime të hatashme e të shemtueme.
Zhdukëshin popujt si t'ishin bubrreca,
më kasaphane, të përbindshme, llahtare :
hordhitë barbare si re me karkaleca,
kudo që shkelnin, s'binte bari fare.
Përpëlitej njerëzimi në ngatrresa,
N'genocide e holokauste gjakatare.

II

Faraonë, tiranë, mbretën e diktatorë :
njeni kalue tjetrit, katil e xhelat,
q'e shkruenin historinë me gjak njerzor,
duke zhdukun n'hiç viktimat pa fat.
Ma i tmerrëshmi nder ta veç ish Neroni,
që Koloseun e kthej në një skëterrë,
kërdinë mbi t'krishtenë ban i patënzoni,
ushqim egërsinash hidhte ato të mjerë.
i mbeti emni atij, simbol gjakatari :
histeria vazhdonte me Neronë tjerë
që u ngritën mbi botë me hutqe barbari,
t'pafajshëm tuj vra, tuj djeg e tuj therë.
Ndër do te shquhej një pjellë shqiptari,
kalue Neronit e nazistit Hitler.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

III

Gjëmimi i luftës jehonte mbi botën,
përfshinte mbarë rruzullin tonë toksor :
diktatorët u ngritën porsi Zotën,
duke mbjellun veç mizori e terror.
Kombet u sulën n' lufta viganore,
u kacafytën për vdekje ushtritë anmike,
duke i harrue t'gjitha lidhjet vllaznore :
përjetonte njeriu çaste kritike.
Teutonët gjermanikë për rreth Hitlerit,
kërkonin për me sundue botën mbarë,
prej Afrike deri ne skaj të verit,
prej Aglisë dhe përtej maleve Urale.
Dridhëshin popujt e mjeruem prej tmerrit,
Me miliona viktima mbetën t'vrarë.

IV

Nga ana tjetër njaj Stalini, muzhiku,
duke i dredhun musteqet me sadizëm,
orvatej me parime karabediku,
botën për me përmbyt me komunizëm.
Duçe Musolini mendje flureci,
për me krijue romakën perandori
andrronte, deri sa në Ballkan ngeci,
n'Shqipni së pari e mandej në Greci.
i varun për kambësh përfundoi i shkreti.
Ashtu dhe miku i tij, Hitler gjermani,
veten ky vrau dhe në bunkerin treti.
Përfundimisht u mposht allamani,
Por Evropën rrezik tjetër e gjeti.
U nda në dyshë nga Jalta e Teherani.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARLIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

V

N' Teheran u kry s'pari tradhtia,
nga Stalini, Rusvelti dhe Curcilli.
Rusvelti i semunë nga psikopatia,
ra në kurthën e një Stalin bandilli.
Fati i Evropës u përcaktue në Jaltë,
Ku ndër viktimat ishte dhe Shqipnia,
Aleatët e dashun e lanë në baltë,
Gjithë Evropën lindore e përpiu Rusia.
N' vorbullën e k'tyne ngjarjeve t'vështira,
u gjetëm ne tre vllaznit të pllakosun,
e morën fund për ne kohnat e mira :
filluen stërmundimet e pa të sosun,
gjithë jetesën tonë e patëm të nxirë,
gjithë kohën ndër kampet e të burgosun.

VI

Tre vllazen ishim, si deget e nje lisit,
lindun atje n'ato kulla kreshnike,
nen hijen e rande te kalase Pervizit
te Skurajve, komandar me veti fisnike.
Ndoqem ne shkollat qe ne moshe foshnjore,
n'Itali : Torino, Modena e Roma,
per me i sherbye tokes sone arbnore,
me t'nalta dije dhe t'arta diploma.
Valentini e Genci, vllaznit ma t'moshuem,
moren drejtim ne shkollat ushtarake,
me detyra te ndryshme u caktuen,
i madhi ne kalorsi, tjetri n'armen futurake
perjashtim une bana, krejt i fryme zuem,
nga arti e poezia, te dyja dege binjake.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

VII

Ne krye te vendit na kish hyp Enveri,
nje shpirt katil edhe xhelat mizor,
e katandisi vendin ne shpell' ferri
me krime te llahtarshme e me terror.
Zakon e kish pasun qe n'femini,
zogjt e klloçkes ne muret me i pllakose,
mbi shqiptaret e vet bani kerdi,
i mbylli ne burgje, i korri me kose.
Ato masa ekstreme nuk na kursyen,
dhe ne tre vllaznit, bashke me te tjere,
si jeten dhe lirine na i rrembyen,
na katandisen ne nje gjendje t' mjere,
na ulen dinjitetit edhe na fyen,
edhe donin te na zhduknin çdo vlerë.

VIII

Nder burgje e internime na shkoi jeta,
thelle t'izoluem ne skutat malore,
ne kampe çfarosje, moçale e keneta,
keshtu ia kish qejfi qeverise mizore.
Valentini, ma i madhi, e pesoi i pari,
ne dhjetor dyzetekater ne burg u pllakos,
nga grueja e ndau Mehmet Sheh barbari,
dyzeteshtatevjet n'denime u rropos.
Krye shkollat e nalta ushtarake,
ish kthye n'atdhe me i sherbye Shqipnise,
po ashtu s'mendonte partia zhabulake,
u arrestue me urdhen te qeverise
me disa akuza absurde teper dasharake:
kryhej vertet denimi i pafajsise.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR (2018)

IX

Kur u gremis statuja e diktatorit,
dhe flladi i lirise po fryente mbi Shqipni,
ai mori udhetimin n'ate muej te frorit,
per ne qytetin Bologna n'Itali,
ku, prej dyzeteshtate vjet e shoqja e priste,
kjo Penelope e shekullit njezet,
keshtu e deshi partia komuniste,
duke e nda dhunisht prej burrit t'vet.
Valentini, Uliks i kaluem Uliksit,
pas i gjysme shekulli me gruen bashkohet,
njeni tjetrin s'e njohen, aq kishin ndryshue,
kur mendon njeriu, shpirti trishtohet,
si kto gjendje absurde me u krijue !
Aq ma teper diktatura denohet.

X

I dyti, Genci, po ashtu e kish pesue,
me burgje, tortura te tmerrshme, çnjerezore,
krenar e i pamposhtun, kurre s'u dorezue,
i qendroi sypatrembun dhunes mizore.
Perjetoi terrorin e t'hatashme tmerre,
si mbyteshin njerezit me t'egra tortura:
shkrumoheshin ne zjarrin e asaj sketerre,
intelektuale te nalte e patriote burra.
Me vite te tana, kanale tuj germue,
ne fushat moçalore te bujqesise.
Ne ato kushte te randa u martue,
me nje vajze kampi, te shoqrise.
Me femi Zoti e kishte gezue,
por jeta iu pre ne pragun e lirise.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

XI

Pishtaret e lirise mbi boten u ngriten,
duke u versulun si lumej te perflakun,
diktatoret mbeten te lebetitun,
mbi qafen e tyne e ndienin lakun.
Trupi yt nga torturat i dermuem,
nuk mundi me durue, keq u degdis:
prej shoqnise u ndave, shum i nderuem,
nuk e shijove fitoren e lirise.
Atje ne nje koder te fshatit Spalat,
pushon dhe ti ne nje vorr vetmitar,
pret pa durim qe te vije ai fat,
me u bashkue me te tjeret familjar,
atje ne Skuraj, n'at mal e n'at shpat,
ku kshtjelli i Pervizit ngrihet krenar.

XII

I treti, jam une, qe vargjet po shkruej,
tmerret kalova me shume te tjere,
tash gjendem larg ne vend te huej,
ato kohna te trishta kujtoj perhere.
N'se artin ushtarak vllaznit pervetsuen,
une, i perveçem, tjeter drejtim mora,
me artin e piktures e te poezise i dashnuem,
mendja me punojti per to edhe dora.
Nuk vlenin kto aftesi per diktaturen,
nder kampe mizore ne u groposem,
xhelatet kriminele kishin zanat torturen,
egersisht na persekutuen e na rrahposen,
na dermuen trupin, ne ropen lekuren,
persegjalli ne burgjet na vorrosen.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

©DORIAN
Rue de la Victoire, 18
1060 Bruxelles
==========
D/2017/141ë451/14
ISBN 978-2-930531-15-1

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER (2018)

ANTOLOGJI NE VARGJE



Autoportret nga kampi i Kuçit të Vlorës, 1958.

Në këtë Antologji përfshihët gjithë krijimtaria poetike e Lek Pervizit e ndarë në disa faza. Faza më e rendësishme është ajo e poezive të krtjuara në kushte kampësh, veçanersht ato të krijuara në kampin e Tepelenës. Siç dihët, prej vizatimlëve të tij u bë i njohur kampi mizor i Tepelenës,krijesë e përbindshme e diktaturës koumniste që gllaberonte viktima të pafajshme, kryesisht pleq e fëmijë. Por krahas vizatimëve, Lek Pervizi kishte krijuar edhe vjersha me përmbajtje denoncuese të krimëve të diktaturës, duke i regjistruar në kujtesë e tij të çeliktë. Poezi të karakerit epik, që një komentues percaktoi si një poem epokal, sepse përmban pathosin tragjik të shekullit njëzet.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARK BARLETI" SHKODËR (2018)

I kam lexuar me emocion poezitë e juaja. I admiroj dhe mendoj, me respekt të rradh, se ato kanë cilësinë e poezive të Aragonit të kohës së luftës.

Lord Amery